

1 E enjte, 13 janar 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.30

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita dhe  
6 mirë se erdhët të gjithë.

7 Zonja Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar  
9 Gjykatës, kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-07, Prokurori i  
10 Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 A nuk ka ndryshuar pjesëmarrja e ekipeve sot?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, për Prokurorinë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

15 Mbrojtja?

16 Z. CADMAN: [Përkthim] Avokati Bernabeu, avokati Cadman.

17 Do të na bashkohet edhe më pas gjatë ditës sot -- na bashkohet  
18 për herë të parë një anëtar i ri i ekipit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjithashtu vë  
20 re se zoti Nilsson përfaqëson Zyrën Administrative. Është në  
21 sallë sot.

22 Vë re se zoti Gucati dhe zoti Haradinaj janë të dy në  
23 Gjykatë. Gjykatësi Mettraux na bashkohet përmes videolidhjes.

24 Zoti Cadman, morëm emalin lidhur me përgjigjen e  
25 dëshmitarit. Arsyet e tij kanë të bëjnë në thelb me vështirësi

1 të udhëtimit. Ne dhamë një vendim tjetër dhe për ekspertin  
2 tjetër. Arsye të tilla duhet që të vendosen në drejtpeshim me  
3 masat që duhen marrë për videolodidhjen. Ka parashtrime të  
4 tjera për këtë?

5 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, nuk është  
6 vetëm çështje e vështirësisë në udhëtim. Sigurisht është kjo,  
7 por është se ai duhet të bëjë vaksinën shtesë më datë 28. Nëse  
8 duhet të udhëtojë këtu duhet që të bëjë karantinë. Besoj se  
9 është hotel në karantinë për 14 ditë.

10 Ne e kuptojmë që Zyra Administrative do të jetë në  
11 gjendje që të ketë përjashtime nga rregullat për qëllim të  
12 udhëtimit. Ai nuk i përmbush kushtet për këto lloj  
13 përjashtime, pra nuk janë thjesht vështirësi të udhëtimit. Ai  
14 është i përgatitur gjithsesi që të dëshmojë për videolidhjen.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Nilsson,  
16 ç'mund të na thoni tani që e dimë si është situata?

17 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës. Sa i  
18 takon këtij dëshmitari, mund t'i informojë të nderuarit  
19 Gjykatës se një kërkesë zyrtare u është bërë dy shteteve në  
20 fjalë, menjëherë pasi u morr vendimi i Gjykatës së Apelit  
21 ditën e premtë.

22 Ne e dimë që kjo kërkesë është marrë, por është duke u  
23 përpunuar nga autoritete dhe -- po këto gjëra duan kohë. Një  
24 pjesë e marrëveshjes që kërkojmë të bëjmë me këto vende është  
25 që jo vetëm të shkojë personeli i Zyrës Administrative se kjo

1 nuk është realiste dhe e mundshme. Por kjo kërkon marrjen e  
2 masave të tjera dhe ndërmjetësimin me personelit teknik në  
3 vend.

4 Pasi të kemi marrë një përgjigje zyrtare dhe unë e thashë  
5 në seancën e fundit, ne parashikojmë pesë ditë pune që të jemi  
6 në gjendje që të organizojmë gjithçka. Mendoj se vetëm kaq  
7 mund të them më për më.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Autoritetet  
9 në fjalë a janë në dijeni të urgjencës që kemi? Të mungesës së  
10 kohës?

11 Z. NILSSON: [Përkthim] Po, jemi në kontakte zyrtare me  
12 ta. Janë në dijeni, por po ecim me procedurën normale.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Halling,  
14 a keni një parashtrim?

15 Z. HALLING: [Përkthim] Qëndrimi i Prokurorisë ishte i  
16 njëjtë me videolidhjet. Për sa kohë që marrja e masave nuk  
17 shkakton vonesa, nuk kemi kundërshtim. Ne mendojmë se arsyeja  
18 që ka dhënë dëshmitari për videolidhje është arsye që do të  
19 jetë e përbashkët për çdo dëshmitar që ka ardhur apo do të  
20 vijë në të ardhmen, por përgjigja e Zyrës Administrative duket  
21 se mund të jetë e mundshme që të akomodohen edhe këto kufizime  
22 logjistike.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse ky  
24 dëshmitar do të dëshmojë, a do të ketë nevojë për seanca  
25 private?

1           Z. HALLING: [Përkthim] Ne mund të përpiqemi që të kemi  
2 një plan që jo medoemos kërkon seanca private por ky premtim  
3 bëhet në teori, pra në abstrakt, sepse varet gjatë -- disa  
4 prej kundër pyetjeve të këtij dëshmitari mund të kenë të bëjnë  
5 me çështje private.

6           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E njëjta edhe  
7 për zotin Cadman. Besoj se ju nuk do të bëni seancë private.

8           Z. CADMAN: [Përkthim] Absolutisht jo. Në tërësi dëshmia e  
9 tij do të jetë në seancë publike. Mund të ketë disa çështje të  
10 cilat mund t'i shikojmë me të shumë shkurt. Mund të kalojmë në  
11 seancë private por sigurisht do të kujdesemi të sigurojmë që  
12 pyetjet që t'ia bëjmë të mund të diskutohen në seancë publike.  
13 Unë nuk mund të parashikoj se çfarë mund të dalë gjatë  
14 dëshmisë së tij dhe sigurisht nuk mund të parashikoj se çfarë  
15 pyetjesh mund të bëjë Prokuroria.

16           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ma merr  
17 mendja se ju e dini se për çfarë do të dëshmojë ai dhe se ju e  
18 dini nëse ka -- a do të dalë diçka që kërkon apo jo seancë  
19 private.

20           Z. CADMAN: [Përkthim] Ajo që mund të them është që unë  
21 nuk parashikoj seancë private aspak gjatë dëshmisë së tij.

22           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni që  
23 ju bëj këtë pyetje edhe juve. Por edhe ju një ide e keni se  
24 për çfarë do të dëshmojë. Ju nuk mendoni se do të ketë seancë  
25 private por mund të jetë e mundshme. Por besoj se e kuptoni se

1 nëse bëjmë diçka që nuk është videolidhje e sigurt, nëse do të  
2 bënim, të themi, ajo që bëjmë me gjykatësin Mettraux, pra që  
3 lidhemi me Zoom, atëherë seanca private nuk do të ishte e  
4 mundshme. Shpresoj se mund të flisni me njëri-tjetrin gjatë  
5 kësaj periudhe në mënyrë që të arrini në një marrëveshje.

6 Z. HALLING: [Përkthim] E kuptova dhe do përpiqemi.

7 Një pikë në të cilën mund të fokusohemi është që mund të  
8 na duhet t'i tregojmë këtij dëshmitari dokumente  
9 konfidenciale. Këtu në sallë ne këtë mund ta bëjmë se mund t'i  
10 tregojmë këto dokumente në mënyrë të mbrojtur dhe Gjykatësi në  
11 videolidhje mund t'i shikojë por mund të mos jemi në gjendje  
12 ta bëjmë këtë për dëshmitarin ekspert. Prandaj edhe e kam këtë  
13 ngurrim.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thjesht po  
15 kërkojmë zgjidhje, prandaj edhe po i bëj këto pyetje.

16 Zotëri, ju keni gjë?

17 Z. BOWDEN: [Përkthim] Jo në veçanti ndonjë gjë. Thjesht  
18 dua të theksoj edhe ndryshimin në orë. Ndryshon shumë ora nga  
19 vendi ku ndodhet dëshmitari me ne këtu dhe kjo mund të ndikojë  
20 edhe në dëshmi. Nuk e di se si mund të merren masat.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është  
22 problem. Do të duhet që ta bëjnë nëse edhe sikur në mes të  
23 natës t'i duhet ta bëjë, nuk e ndihmojmë dot.

24 Z. CADMAN: [Përkthim] Absolutisht. I vetmi problem është  
25 vendi ku duhet ta japë dëshminë, nëse do të jetë sallë gjyqi

1 atje, kjo mund të shkaktojë një problem.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Por më duket  
3 se nuk është kriter ky, apo jo?

4 Z. NILSSON: [Përkthim] Nuk mendoj se është kriter por ka  
5 disa kritere të caktuara për vendet për një mjedis të qetë e  
6 kështu me radhë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sigurisht.  
8 Zoti Nilsson, dua që të na mbani të informuar përditë, sidomos  
9 sot sepse na duhet të marrim një vendim shumë shpejt.

10 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirë në rregull. Do të shikojmë më  
11 pas se si do të bëhet.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të  
13 vazhdojmë me kundrapyetjet, dua të them diçka palëve.  
14 Paragrafi 81 i urdhrit për zhvillimin e procesit parashikon  
15 që:

16 "Çdo palë që dëshiron të kundërshtojë një pyetje gjatë  
17 dëshmisë, dëshmitari duhet të ngrihet në këmbë dhe në mënyrë  
18 koncize të bëjë kundërshtimin, kështu që ju lutem që të mos  
19 bëni kundërshtime të cilat mund të ndikojnë apo t'i orientojnë  
20 dëshmitarët se cila mund të jetë përgjigje".

21 Edhe një gjë tjetër, zoti Halling. Edhe a mendoni sa kohë  
22 mund të vazhdojnë kundrapyetjet. Nuk dua t'ju kufizoj, thjesht  
23 dua të di. Besoj se edhe ekipet e tjera duan ta dinë.

24 Z. HALLING: [Përkthim] E prisja këtë pyetje. Mendoj se  
25 përdorimi i tre sesioneve sot mund të jetë e ngjashme. Kemi

1 folur më përpara që do ta mbarojm sot por tani kam më pak  
2 besim se mund ta mbarojmë sot, duke pasur parasysh edhe  
3 shpejtësinë e bërjes së pyetjeve nga pala thirrëse. Por ju  
4 garantoj se do të mbetemi brenda 10 orëve që kemi -- pra  
5 vlerësimit prej dhjetë orëve.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
7 Mirë, zoti Halling, mund të vazhdoni me kundra pyetjet.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

9 DËSHMITARI: NASIM HARADINAJ [Vijon]

10 Pyetje të palës tjetër nga Z. Halling:

11 [Vazhdim]

12 Py. Mirëdita, zoti Haradinaj.

13 Pë. Mirëdita.

14 Py. Zoti Haradinaj, dëshiroj që të kalojmë tani në ngjarjet e  
15 22 shtatorit të vitit 2020. Sa i takon paketës së materialeve  
16 që ju ka ardhur më 7 shtator të vitit 2020, ZPS-ja erdhi në  
17 OVL dhe i mori të nesërmen, apo jo?

18 Pë. Këto veçëm i di prej tjetër kujt. Unë s'kam qenë aty.

19 Py. Por ju e dinit se kur erdhi ZPS-ja atë ditë, një prej  
20 dokumenteve që iu dha Faton Klinakut ishte autorizimi për  
21 sekuestrim. A është kështu?

22 Pë. Jo, unë nuk di send. Unë di vetëm një fletë, ma ka  
23 treguar çfarë është -- e pa pame përpara për mua ka qenë. Unë  
24 s'di çka i ka dhënë, as çfarë ka marrë. Nuk kam qenë aty.

25 Py. Kjo copa e letrës që ju treguam më përpara a ishte

1 autorizimi për sekuestrim?

2 Pë. Unë s'kam parë as s'kam nënshkru vetë ndonjë autorizim.

3 Q'atë e kam nënshkruar që po i merr. Na ka thënë dëshmitari,

4 ne na ka thënë "kjo është vërtetim që po i marrim këto

5 materiale prej ju". Kurrgjë tjetër. Kështu na u ka sqaru shqip

6 dhe na u ka sqaru shqip.

7 Py. Zoti Haradinaj, dua që të shohim tani dëshminë tuaj.

8 Është prova me numër 2D1. Është paragrafi 87. Mund të pres një

9 moment deri sa të dalë në ekran.

10 Py. Kjo faqe ka informacion konfidencial, kështu që nuk duhet

11 nxjerrë në publik, por mund ta lexoj në atë mënyrë që të

12 përdorim numrat nga fleta e cila ju është dhënë më përpara.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë

14 kundërshtim për këtë proces?

15 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 Mund të vazhdoni.

18 Z. HALLING: [Përkthim]

19 Py. Kjo është pjesa e deklaratës në të cilën desha t'ju sjell

20 në vëmendje. Personi 1, që ne e quajmë personi 1, tha se "e

21 kishim dëgjuar se disa materiale të ndjeshme kishin arritur në

22 OVL UÇK. I thashë se kishim ardhur më herët për t'i marrë disa

23 të tjera, por nuk kthyet kurrë përgjigje se ato ishin material

24 i ndjeshëm". Personi 1 "më tregoi se i kishin treguar Fatonit.

25 Fatoni e kundërshtoi këtë duke i treguar vetëm dy letra: një



1 autorizim i personave për sekuestrim dhe një fletë për dëshmi  
2 për pranim dorëzimi".

3 Zoti Haradinaj, nga kjo pjesë e deklaratës suaj duket se  
4 ju ishit në dijeni që ju dha këtyre një autorizim për  
5 sekuestrim, kur u sekuestrua paketa e parë. A nuk është  
6 kështu?

7 Pë. Unë isha i informuar nga Fatoni, unë nuk isha në dijeni  
8 se s'kam qenë aty. Unë këtu kam përshtuar çka kam dëgju aty  
9 çka ka bisedu. Unë s'kam qenë aty dhe s'kam mujt me qenë në  
10 dijeni. Kjo është -- i jam referuar Fatonit, çka ai tha. Edhe  
11 për ta ju kam referuar Fatonit çka i tha atij. Unë s'kam parë  
12 -- as s'ka pasur letra në dorë Fatoni, vetëm i ka thënë  
13 kështu. Por unë kur kam nënshkruar, kam nënshkruar vetëm një  
14 letër.

15 E kam fjalën për herën kur kam nënshkruar se këtu është  
16 fjala për herën e parë. Për herën e parë unë vetëm mund t'i  
17 referohem çka kanë thënë të tjerët. Qoftë drejtë, qoftë e  
18 gabuar, unë kam thënë çka unë kam ndi që u tha aty.

19 Py. Në këtë pjesë, pra Fatoni -- është Faton Klinaku, apo jo?

20 Pë. Po, sekretari i organizatës, Faton Klinaku.

21 Py. Pra ai e perëndi autorizimin për sekuestrim por ju nuk e  
22 keni parë asnjë herë. Këtë doni të thoni?

23 Pë. Unë s'e kam parë asnjëherë, por unë s'e kam parë as kur -  
24 - herën kur m'u ka dorëzuar mua me nënshkru, nuk kam parë dy  
25 letra. Unë kam parë vetëm një letër. Mua konkretisht vetëm një

1 letër më është dhënë atëherë dhe një letër kam nënshkruar. Në  
2 fakt kam kërkuar të ma japin, a bon me nënshkru unë? Po Hysniut  
3 i ka ofruar vetëm një letër, radhën kur kam qenë unë aty.

4 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretares që të nxjerrë  
5 dokumentin P83. Është një postim në Facebook, nuk është video,  
6 me numër ERN SPOE00222202 deri në 00222288. Duhet të jetë  
7 faqja e parë.

8 Py. Zoti Haradinaj, a e shihni emrin tuaj në të djathtë të  
9 kësaj fotografie, ekrani kompjuteri përpara jush?

10 Pë. Po, në të djathtë e shoh emrin tim, që është Facebooku.

11 Py. Po është një postim i Facebookut nga ju i datës 9 shtator  
12 2020, apo jo?

13 Pë. Nuk është e vërtetë që unë e kam postuar këtë. Unë këtë  
14 vetëm e kam shpërndarë, domethënë unë këtu kam qenë në  
15 Shqipëri. Domethënë e ka çuar ai dhe kjo ka qenë si dëshmi që  
16 i dorëzua materialit. Kurrgjë tjetër. Unë s'e kam shpërndarë,  
17 as e kam fotografuar këtë. Ky është postim i Fatonit, që  
18 pastaj unë e kam postu.

19 Py. E ripostuat, apo jo?

20 Pë. Unë e kam shpërndarë. Nuk është foto as që e kam bërë  
21 unë, as që e kam parë në këtë letër, as që e kam fotografuar  
22 unë, as që e kam qitur unë më së pari.

23 Py. Pra, ripostuat këtë dokument, po pa e parë se çfarë  
24 ishte?

25 Pë. Po, jo more, s'e kam këqyrë. Veç e kam parë atë, s'e kam

1 këqyrë. Mua kur më është dhënë me nënshkru, unë s'kam pasur  
2 kësoj letre. Mua s'më ka ardhur kësoj letre. Vetëm një letër  
3 tjetër ku kam nënshkruar unë. Unë as e kam këqyrë, kjo çka  
4 është. Unë kam menduar që është dëshmi që i kanë marrë letrat.  
5 Dhe edhe tash s'e di çka asht, në fakt.

6 Py. A ke parë ndonjë herë ndonjë autorizim ligjor për  
7 sekuestrimin e paketës së dytë të materialeve më 16 shtator?

8 Pë. Si duket ai, se unë nuk po e di. Nëse duket q'ashtu,  
9 s'kam parë. Kurrë. As këtë s'e kam parë në -- fizikisht.  
10 Asnjëherë.

11 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretares, është një  
12 video tjetër nga e cila ju kisha njoftuar. Është P17, nga  
13 13:13 deri në 13:46.

14 Py. Zoti Haradinaj, ERN për këtë është 08197905. Në faqen 6  
15 të transkriptimit anglisht P17-ETRED dhe është një pjesë që  
16 fillon me fjalën anglisht "Yes, yes, feel free" domethënë "Po,  
17 po, lirisht" dhe mbaron me fjalën "Publish it or not", pra  
18 "publikojeni ose jo".

19 Zoti Haradinaj, do ta shkojmë këtë video, pastaj do ju  
20 bëj disa pyetje për këtë.

21 Pë. Ju lutemi, ma qitni edhe shqip.

22 Py. Një moment, po besoj se sekretarja do ta nxjerrë në  
23 shqip.

24 [Luhet videoincizimi]

25 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, zonja Sekretare.

1 Py. Zoti Haradinaj, çfarë mendoni se është dokumenti që ju  
2 keni në duar në këtë video?

3 Pë. Ky dokument është -- më është servirur prej Fatonit. Kur  
4 e kanë lyp këta me dokumentu, unë kam qenë duke dhënë një  
5 intervistë për këtë televizion dhe e shihni fort mirë ku them  
6 "çdo gjë e kemi në transparencë çka ka ardh". Dhe Fatoni erdhi  
7 e shpjegoi këtu dhe m'i dha. Unë meqenëse isha në intervistë  
8 unë ja tregova që dokumenti që pruri Fatoni. Këtë dokument unë  
9 s'e kam pasur asnjëherë. Përpos këtu ku e ka dhënë ky edhe ky  
10 dokument në fakt për mua vetëm Fatoni është duke ma shpjeguar  
11 se nuk ka qenë interesant për mua. Unë çdo gjë që ka ardhur  
12 ose çfarë kam parë në zyrë, unë e kam bërë transparent. Bile  
13 ajo më thotë këtu "me i publiku". I themi ne -- dhe i  
14 përgjigjemi ne, nëse dëgjoni mirë, unë i përgjigjem "ne nuk e  
15 publikojmë. Ne e kemi qit. Ata që duan ta publikojnë le ta  
16 publikojnë. Ky këtu nuk është dokument që unë" -- atë ditë në  
17 intervistë e ka prurë Fatoni, kemi qenë duke biseduar, e ka  
18 prurë Fatoni. Dhe meqenëse unë po jepja një intervistë, e kam  
19 shfletu se ajo ishte e vetëm dhe ja kam qitë. Kaq. Por mua  
20 kurrë s'më është dhënë [e pakuptueshme] për shembull. Unë  
21 kurrë s'kam parë kësisoj që i është dhënë shoqërisë atë ditë.  
22 Ndoshta i është dhënë dhe unë s'e kam parë.

23 Py. Kur thoni që nuk ja kanë dhënë, e keni fjalën për  
24 dokumentin që po e mbani në duar në këtë video?

25 Pë. Po qe si dokumenti s'kam parë shumë faqe, ku kam

1 qenë unë që i është dhënë dikujt. Thashë, për Hysniun, ndoshta  
2 edhe ja ka dhënë, unë nuk e di, por për mua e di ka qenë një  
3 fletë dhe në fakt i drejtohej Hysniut në këtë formë. S'ka  
4 mundur Hysniu ta marrë se ishte larg. I thashë "A ban me e  
5 nënshkru unë". Më ka thënë "Po" dhe është ai dokument që e  
6 keni ju me nënshkrimin tim.

7 Py. Të përqendrohemi te videoja. Ju thoni se "është në  
8 anglisht, detyrimi që na thonë se kemi". Çfarë doni të thoni  
9 me këtë? "Ka rreshta në anglisht dhe detyrimet që na i thonë  
10 se i kemi".

11 Pë. Unë së pari nuk e kuptoj anglishten kaq shumë sa të mund  
12 të kuptoj këtë. Thjesht po të them. E dyta, kam qenë duke  
13 dhënë një intervistë, ka ardhur prej andej, tha "na e kanë  
14 lënë ata një dokument". I kam thënë "kanë lënë dokument". Këtë  
15 ma ka servu Fatoni në dorë. Edhe duke folur Fatoni andej, duke  
16 folur unë. Duke ardhur Fatoni për t'i pru, atëherë e kanë  
17 incizuar. Sepse ajo këtu e ka redaktu filmimet se gazetarja e  
18 ka qitë sipas qejfit të vet. Nuk është krejt këtu krejt  
19 filmimi. Në fakt këtu, jo përpos që e keni këput ju, po është  
20 i redaktuar edhe prej vetë gazetares. Se këtu ka fjalë të  
21 tjera, ku i kam thënë që unë as kam parë kurrë. Dhe Fatoni ka  
22 thënë "Po, po, na kanë lënë do letra".

23 Py. A e dinit që një prej detyrimeve që jepte ai dokument  
24 ishte të mos t'i publikonit këto lloj dokumentesh?

25 Pë. Po ne nuk i kishim ato dokumente më. Këto i kishin marrë,

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 14

1 veç.

2 Py. Zoti Haradinaj, nuk ishte kjo pyetje. Do ta bëj edhe një  
3 herë. A e dinit që një prej detyrimeve në atë dokument që ju  
4 po mbani në dorë në video, është që të mos publikoni dokumente  
5 të tilla?

6 Pë. Unë e thashë, ky dokument është që e ka lënë -- që tha  
7 Fatoni që e ka lënë, kur ka qenë i ka marrë të parat dhe këtu  
8 ne s'kemi pasur më kësoj letrash për t'i publikuar dhe e dyta,  
9 le të dihet një herë për çdo herë: ne s'kemi publiku. Ndërsa  
10 unë personalisht hiç s'kam fotografuar kurrë. Ne vetëm i kemi  
11 marrë çka na ka ardhur. I kemi qitur edhe i kemi servu çka na  
12 ka ardhur. S'i kemi prekur. Kanë qenë në dorën e të tjerëve a  
13 donin, sa donin t'i publikonin dhe sa donin të merrnin. Sipas  
14 qejfit të tyre.

15 Pë. Zoti Haradinaj, ju lutem, me "po" ose me "jo", a e dinit  
16 se një prej detyrimeve që ky dokument vendoste ishte që të mos  
17 publikonit këto lloj dokumentesh?

18 Pë. Për mu s'ka qenë e qartë dhe mund të përgjigjem meqenëse  
19 s'ka qenë e qartë "Jo". S'e kemi ditur. Unë personalisht nuk e  
20 kam ditur.

21 Py. Po Organizata e Veteranëve të Luftës a e dinte këtë?

22 Pë. Po shpresoj që s'e ka ditur as ajo. Tash Organizata është  
23 objekt.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni zoti  
25 Cadman.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Faleminderit. Në fakt zoti  
2 Haradinaj u përgjigj pyetjes por unë do të thosha që zoti  
3 Halling të bëjë pyetjen se për kë e ka fjalën, se zoti  
4 Haradinaj nuk mund të përgjigjet për të gjithë Organizatën.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet  
6 kundërshtimi.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Mund ta bëj më individuale tani, i  
8 nderuar Gjykatës.

9 Ju lutem nxirrni videon P4. Vula kohore përkatëse është  
10 16:25 deri në 17:19, me numër ERN 08134701. Pjesa është  
11 publike, është faqja 8 në transkriptimin në gjuhën angleze dhe  
12 është një pjesë që fillon me fjalët në anglisht "Mr. Gucati,  
13 if I am not mistaken," pra "Z. Gucati, nëse nuk e kam gabim",  
14 dhe mbaron me fjalët "It cannot be done", "s'mund të bëhet".

15 [Luhet videoincizimi]

16 Z. HALLING: [Përkthim] A mund t'i kërkoj Sekretares tani  
17 që ta nxjerrë, që ta zmadhojë këtë fotografi të videos për një  
18 moment.

19 Py. Zoti Haradinaj, a ju kujtohet kjo konferencë për shtyp?

20 Pë. Zoti Prokuror, të falënderoj, është e para herë që punove  
21 për mua që bash tuj e mendu [e pakuptueshme]. E sheh këtë  
22 fotografi? Qysh ka me m'u kujtu diku ku unë s'kam qenë? Ky  
23 është ai momenti ku kam thënë që jam ngritur në gjysmë të  
24 mbledhjes dhe kam dalë. Unë as nuk kam qenë këtu, se është e  
25 pamundur po të ishte bërë një konferencë këtu, me detyrat që i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 16

1 kam si zëdhënës, që unë të mos isha. Shumë faleminderit për  
2 foton, shumë faleminderit për ri kujtesën dhe për dëshminë  
3 tuaj për mua. Faleminderit shumë.

4 Z. CADMAN: [Përkthim] Vetëm një shënim për  
5 transkriptimin. Përkthimi që është dhënë ndryshon nga  
6 transkriptimi në anglisht. Atëherë ose transkriptimi në  
7 anglisht ka gabime apo përkthimi që është bërë është përkthim  
8 i gabuar.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Me sa e kuptoj unë përkthyesit e  
11 përkthejnë në kohë reale këtë që dëgjohet në video. Besoj që  
12 çdo ndryshim i mundshëm do të përmirësohet.

13 Z. CADMAN: [Përkthim] Unë e çmoj përpjekjen e përkthyesve  
14 që të përkthejnë një gjë që flitet shumë shpejt, mirëpo për  
15 hir të proces verbalit, kjo duhet të korrigjohet.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 Z. HALLING: [Përkthim]

18 Py. Zoti Haradinaj, kur zoti Gucati thotë "Jo, na kanë thënë  
19 qartë se këto dokumente nuk mund të shumëzohen, shpërndahen  
20 dhe as emrat e dëshmitarëve të publikohen, siç ka thënë edhe  
21 avokati", a është ky një mesazh që e keni marrë edhe ju vetë?

22 Pë. Si ka mujt me e marr unë këtë mesazh kur s'kam qenë?

23 Py. Ju jeni anëtar i kryesisë së ngushtë të Organizatës së  
24 Veteranëve të Luftës apo jo?

25 Pë. Jo vetëm anëtar, por jam nënkryetar dhe zëdhënës i



1 Organizatës së Veteranëve.

2 Py. Atëherë është dëshmia juaj se avokati që është Tomë Gashi  
3 në këtë fotografi, ja ka thënë këtë informacion vetëm Gucatit  
4 dhe jo juve?

5 Pë. Nëse më pyet se çka është thënë këtu, këtu zoti Prokuror,  
6 s'di si e keni të përkthyer. Këtu u tha "na kanë thënë mos me  
7 i shtyp, mos me i shumëzuar, mos me i shpërnda" dhe këtu  
8 asnjërin s'e kemi bërë asnjëherë. Kështu po e shoh që e paska  
9 kuptuar zoti Gucati. Dhe asnjëri prej tyre që tha zoti Gucati  
10 nuk e ka bërë, as Gucati, as na. Shqip është q'ashtu që po  
11 dëgjoj tash. Deklarata e zotit Gucati. Ndërsa këtë intervistë  
12 unë s'e kam ndi. Janë qindra intervista. Nuk -- unë s'kam pas  
13 kohë ne -- s'kemi pasur kohë as shoqi shoqin me ja dëgjuar  
14 intervistat. Se s'kemi pasur kohë se jemi thirrur në  
15 intervista të tjera. Dhe ju zoti Prokuror ose ju kolektivi  
16 juaj, ju keni bërë gjithçka që po bëhet për [e pakuptueshme]  
17 aktuale. Gjithçka keni bërë procedoni që s'na keni lënë as të  
18 qetë.

19 Py. Zoti Haradinaj, ju e keni ditur se ZPS-ja nuk ka dashur  
20 që ju ta shpërndani këtë informacion. A është kjo e saktë?

21 Pë. Ti po konstaton se çka kam ditur unë, apo jo?

22 Py. Po, është pyetje për ju. Ju e keni ditur që ZPS-ja nuk ka  
23 dashur që ju ta ndani këtë informacion.

24 Pë. Tash unë po e tregoj për Gjykatën se çka unë kam ditur  
25 dhe di edhe sot dhe çka kam kuptuar. Ne e kemi kuptuar se ne

1 nuk do të ketë material me e shumu, me e shpërnda, me e  
2 publiku, dhe asnjë nga këto nuk i kemi bërë. Këtë e kam ditur  
3 unë, dhe këtë e di edhe sot.

4 Py. Dhe ZPS-ja, faktikisht hetuesi i ZPS-së , Personi nr. 1  
5 në listë, ju ka thënë që këto materiale janë ndjeshme. A është  
6 kjo e saktë?

7 Pë. Personi nr. 1 ka thënë "mund të jenë të ndjeshme" dhe  
8 kurrë s'na ka thënë përgjigje që ekzakt, a ishin me të vërtetë  
9 ato të ndjeshme apo jo. E keni rastin ku unë i kundërshtoj, i  
10 them "ju s'na keni tregu as për ato të parat a janë të  
11 ndjeshme". Domethënë ka thënë "mund të jenë të ndjeshme dhe  
12 mund të jenë interesante për ne". De facto, asnjëherë s'e ka  
13 pranuar para nesh as me gojë dhe s'po dua -- të jem i  
14 singertë, as me gojë që janë të tyre. Na ka thënë "mos i  
15 shumoni". Ka thënë "S'bën me i shumu". Ka thënë "S'bën ju me i  
16 reklamu". Në rregull është. S'e kemi bërë asnjëherë nga këto.

17 Py. Incizimi që do ta luajmë tani, është pjesë e provës P6,  
18 vula e kohës prej minutës 58:21 deri në 58:48. Është faqja 35,  
19 në transkriptimin e videos në anglisht dhe numri është  
20 08135502 dhe fragmenti fillon me fjalët "atë ta kanë thënë"  
21 dhe përfundon me fjalët "materialet që i kemi marrë".

22 [Luhet videoincizimi]

23 Z. HALLING: [Përkthim]

24 Py. Zoti Haradinaj, a ju ka thënë të ZPS-së se materialet  
25 janë të ndjeshme?

1 Pë. Më fal, zoti Prokuror, veç ta këqyr krejt listën, a është  
2 emri i Zekirjas këtu, që ja guxoj me -- me i përmend, po  
3 guxoj. Se thash mos e keni të mbyllur. Ky është, zoti Prokuror  
4 dhe u bë mirë që e qite, ky është ai të cilin ju --

5 Py. Transkripti është në mes të ekranit tuaj.

6 Pë. Jo, jo, e këqyra listën, e këqyra listën e këtyre  
7 njerëzve që i kam të koduar. Thashë a është Zekirja këtu. Zoti  
8 Prokuror, mua më vjen keq, atë ditë kur kam parë Halil  
9 Berishën në fakt, ky është dashur të vinte por ai ka qenë  
10 viktimë e tij, sepse ky i ka bërë këto. Tash po bindem që ky e  
11 ka shti me i marr komplet dosjet sepse i vetmi gazetar i tij,  
12 nuk na ka ndodhur në tre seanca me marr kush -- me kërkim me  
13 marr komplet dosjen. Domethënë ky është që ka ardhur e ka  
14 marrë komplet dosjen me direktivë të tij, ju ka thirrur juve  
15 dhe më ka provokuar dhe ky -- dhe po të tregoj drejt, më  
16 hetues ka qenë ky atë natë se të gjithë inspektorët tuaj që  
17 keni pru. Kështu që ky ka bërë një punë shumë të mirë për ju  
18 dhe në të njëjtën anë mundohet me u shit tjetër, kështu që ky  
19 i di çka ka bërë këtu. Ky është ai një prej atyre gazetarëve  
20 që, zoti Gjykatës ju thashë, na kanë provokuar, janë munduar  
21 me na qitë para aktit të kryer.

22 Dhe e dyta, e sheh që po ju them. Ndoshta ju kanë thënë  
23 ju se ne nuk na kanë thënë. Dhe këtu e sqaroj, se ndoshta ju  
24 kanë thënë ju. Pastaj ky e sheh, e mohon. E ne s'na u ka  
25 thënë, i them. ndoshta ju ka thënë ju se ne nuk na ka thënë.

1 Py. Kur Gazeta inFokus i ktheu dokumentet që i diskutojmë, ju  
2 deshët që ata të vuajnë për këtë vendim të tyrin, apo jo?

3 Pë. Shumë e pavërtetë është që i ka kthyer dokumentet. I ka  
4 kthyer mbasi i ka publiku. Unë atë ditë kam parë dokumente të  
5 tyre të publikuara. Edhe pse unë me dashtë më vuajt këta, nuk  
6 kam përcaktuar unë që të vuajnë. Zekerja Shabani, ky ka dasht  
7 me e sakrifiku gazetarin e vet, e të fshihet vet mbrapa. Unë  
8 jo. Ça kanë me të bëj. Unë s'jam autoritet në gazeta. Me  
9 dëshirën e tyre, vullnetin e tyre të plotë ka qenë kjo. S'ka  
10 imponim. Pse me vuajt këta për mua?

11 Py. Ju thatë që donit që të vuajnë pasojat por ju nuk thoni  
12 asgjë. Tani do ta luajmë videon prej minutës 36:51 deri në  
13 37:07, pra të njëjtin incizim.

14 Ndërkohë që ta vendosin këtë video në ekran, ne flasim  
15 për inFokusin tash, sepse ky është gazetari i inFokusit për të  
16 cilin jeni duke folur në videolink. A është kjo e saktë? E  
17 shoh që bëni po me kokë por nëse mund me fjalë.

18 Pë. Halili, ky është shefi i Fokusit. Ky është urdhërdhënësi.

19 Py. Faleminderit, dhe kur sekretarja të jetë e gatshme, t'a  
20 lëmë videon.

21 [Luhet videoincizim]

22 Z. HALLING: [Përkthim]

23 Py. Zoti Haradinaj, dua që të përqendrohemi te ajo e fundit,  
24 që e thatë që: "E ka kryer detyrën e vet. Tani le të vuajë ai  
25 për këtë punë se si po sulmon si një grup".

1 Për cilin e keni fjalën në këtë fjali?

2 Pë. E kam për Zekirjan, se ky e ka kryer detyrën e vet,  
3 porosinë tuaj. Se vetëm ky ka ardhur e ka marrë një komplet  
4 dhe fill ju ka lajmëruar. S'ka lajmëruar kush tjetër që ka  
5 thënë "ju kam lajmëruar ju". Domethënë, e dëgjuat atë ditë  
6 atë. Ka ardhur dhe tani po e shoh që e ka marrë me qëllim se  
7 vetëm gazetari i tij ka kërkuar me i marr komplet dosjet. Nuk  
8 ka ndodh asnjëherë. Në tre herët e tjera, asnjë gazetar kurrë  
9 që ka lyp me marrë dosjet. Ka shfletuar ndonjë fletë, ka marrë  
10 ndonjë fletë, secili për vete. Ndërsa ky e tregoi, e ka kryer  
11 detyrën e vet. Domethënë, e keni porositë të vijë të marrë  
12 dosjen, ka marrë dosjen, lajmëroi që mbas 20 minutave ju kanë  
13 lajmëruar ju, e ka parë tash -- se tash po flas në bazë të  
14 dëshmisë, e kanë që e kanë bërë gabim dhe u munduan me na  
15 kthyer ne vuajtjet e tyre. Le të përgjigjen ata. Këtu është  
16 fjala për vuajtje. Është fjala -- nënkupton përgjegjësinë. Ata  
17 e kanë shpërndarë, le ta mbajnë përgjegjësinë.

18 Këtu është. Kjo është esenca, pse unë këtë djalë e [e  
19 pakuptueshme]. Sepse ky tash mundohet të kthehet sikur unë jam  
20 fajtor -- sikur unë jam fajtor pse di që kam qit aty. Unë s'e  
21 kam shti atë me i shpërnda dhe nëse e sheh reporteri, ai  
22 moderatori i thotë edhe këta e kanë shpërndarë. Është çështja  
23 e tyre tash. Po i kanë shpërnda edhe më së shumti i kanë  
24 shpërndarë.

25 E tash kush e ka mësuar Zeqen me seleksionuar? A ju? A

1 ndonjë shok i juaji, unë nuk e di. Po ky tamam e ka kryer  
2 detyrën tuaj.

3 Py. Zoti Haradinaj, në dëshminë që dhatë para pesë minutash  
4 ju thatë:

5 "Edhe pse kam dashur që ata të vuajnë, nuk thash asgjë".

6 Por ju faktikisht thatë diçka, apo jo? E keni thënë këtë?

7 Pë. Unë jam me vujt, nëse me vujt ai që i ka bërë. Unë nuk  
8 kam nevojë të vuaj një punë të tjetrit. Nëse unë duhet të vuaj  
9 dhe është për vuajtje dhe është për dënim, ose sidoqoftë, në  
10 përgjithësi, unë e marr përgjegjësinë që një dokument që më ka  
11 ardhur e kam marrë prej katit të parë, brenda zyrës time dhe e  
12 kam qit në një tavolinë tjetër në zyrën tjetër. Të gjitha  
13 fjalëve që na janë dhënë me gojë nga D1, dëshmitari 1, mos me  
14 shpërnda, mos me i shumu -- mos me i shpërnda ne e kuptojmë  
15 fjalën edhe shumim. Mos me i shumu, mos me i kopju. Ne të  
16 gjitha këto i kemi zbatuar edhe pse në fakt kemi edhe pasur  
17 mundësi edhe hiç me [e pakuptueshme], po s'ka qenë qëllimi  
18 jonë asnjë as t'i bëjmë këto.

19 As e kemi pasur qëllim, ai na e ka thënë. Tamam na është  
20 përputhur me ato idetë tona që ne as qëllim s'kemi pasur dhe  
21 ashtu kemi vepruar. Ndërsa për pjesën e shpërndarjes, unë  
22 mendoj se duhet të marri përgjegjësinë ai që i ka shpërndarë.  
23 Edhe nëse është me vujt për ata, le të vuajë ai. Po ai është i  
24 mbrojtur. Në rregull.

25 Py. Zoti Haradinaj, fundi i fundit, ju nuk pajtoheni me atë

1 që ky informacion duhet të konsiderohet i ndjeshëm. A është  
2 kështu?

3 Pë. Aq sa jam pajtuar, aq kam vepruar. Unë jam pajtuar për  
4 hir të transparencës dhe interesit publik dhe fjalës së lirë  
5 të qytetarëve dhe për transparencë më së shumti, ne kemi pasur  
6 me tregu çka na ka ardhur dhe ka përfunduar detyra jonë.  
7 Detyra jonë ka qenë 16 metra brenda lokalit që i kemi mbajtur  
8 ato. Asnjë send më. Nga një dhomë, në një dhomë tjetër, por që  
9 është një kat më lartë. Kjo është përgjegjësia ime. Këtë e  
10 pranoj se e kam bërë. Pa marrë parasysh kush i ka mbajtur ato,  
11 se deri i kam [e pakuptueshme] me dal me fol për to, sepse  
12 është përshkrimi i detyrave të mia, këto i kam bërë unë. Këtu  
13 përfundon veprimi im. Marrja kur kanë ardhur, qitja në  
14 tavolinë, informimi publik, transparenca. Përfundon. S'ka më  
15 tjetër gjë. Për këtë marr përgjegjësi.

16 Py. Ka pasur edhe materiale që nuk kanë qenë publike në  
17 dokumentet që ju janë sjellë. A është kështu?

18 Pë. Unë nuk e di as kush ka qenë publike, a s'ka qenë  
19 publike. Në fakt, çka kam lexuar unë aty, kanë qenë gjëra që i  
20 kam ditur dhe i kam dëgjuar për [shumë] vjet. Ka pasur gjykatë  
21 të Kosovës, ka pasur -- që ndërkombëtarët i kanë bërë, kanë  
22 kryer gjykime. Kam parë dokumente -- edhe vetë punëtori juaj,  
23 D1 ka thënë që s'janë me rëndësi. Pastaj u hamendësua dhe  
24 hajt, tha, po i marr. Nuk kam parë unë diçka unë aty, nuk kam  
25 parë edhe sikur t'i them të gjitha ça kam parë, edhe po t'i

1 them të gjitha që mund të mbaj mend, se është kaherë, nuk  
2 është diçka që ne s'e kemi dëgjuar katër vjet, minimumi, më  
3 përpara.

4 Py. Zoti Haradinaj, materialet kanë pasur shenjë në to, që i  
5 kanë bërë të qarta që janë top sekrete apo që ndryshe, jo  
6 publike. Kjo është e saktë, apo jo?

7 Pë. Unë kam lexuar shumë materiale që kanë shkruar "Top  
8 Secret". Për shembull prej vetë të CIA-s amerikane dhe kanë  
9 qenë publike nëpër televizor, sepse për mua nuk e kam ditur se  
10 për cilën kohë ajo, a nuk e kam marrë mundimin të mendohem për  
11 atë punë. Se përderisa kanë mbërritur, kanë mundur të  
12 mbërrijnë në zyrën tonë, për mua edhe -- në fakt, unë s'di pse  
13 edhe janë sekrete. Sekretet nuk dalin e nuk vijnë në zyrat  
14 tona. As unë as nuk muj ta paramendoj as sot. Dhe s'e keni  
15 vërtetuar as ju. Edhe ju jeni duke bërë sikur dëshmitari juaj  
16 herë po, herë jo. Janë tonat, herë s'janë tonat. Ne s'na është  
17 konfirmuar që është sekrete që ne ta dinim që është sekrete.  
18 Ndërsa ça po thua ti, shkruan "Sekret", unë lexoj përditë, e  
19 ke lexuar edhe ti që nëpër revista qesin dokumente të  
20 mëparshme që ka pasur zbulimet, dhe shkruan atje "Sekret", po  
21 e qet. Kështu e kam kuptuar. Unë nuk e kam kuptuar se është  
22 sekret. Mua nuk më është sqaruar që është sekret. Jo mua, por  
23 kurrkujt s'i është sqaruar. Si mund të jetë sekret diçka që  
24 rri publikisht në zyrat tona? Të lutem. Kjo është marre me e  
25 ndi dikush.



1 Py. Zoti Haradinaj, atëherë ta shohim një fragment tjetër të  
2 të njëjtit incizim që e kemi diskutuar edhe më herët.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Është dokumenti, apo prova P6,  
4 vula kohore prej minutës 39:07 deri në 39:23.

5 [Luhet videoincizimi]

6 Z. HALLING: [Përkthim] Duke marrë parasysh shpejtësinë e  
7 këtij fragmenti, do ta lexoj, për hir të procesverbalit.

8 Py. Ju thoni që:

9 "Nuk do të kishit publikuar fare në qoftë se nuk do ju  
10 kisha thirrur dhe nuk do i kishit publikuar asnjëherë dhe  
11 Gjykata nuk do t'ju kishte treguar" dhe zoti Shabani thotë:

12 "Nëse s'i keni bërë publike, në qoftë se nuk i keni  
13 treguar në pres konferencë atëherë nuk do të kishte se si t'i  
14 marrim".

15 Zoti Haradinaj, atëherë pyetja ime është përsëri-

16 Z. CADMAN: [Përkthim] Përpara se t'i kërkohej të  
17 përgjigjej, ndoshta është mirë që të dëgjojë edhe njëherë këtë  
18 video.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë ta  
20 luajmë edhe një herë videon për zotin Haradinaj.

21 [Luhet videoincizimi]

22 Z. HALLING: [Përkthim]

23 Py. Zoti Haradinaj, po buzëqeshni. Pse?

24 Pë. Po buzëqesh se tash s'po di a të përgjigjem [e  
25 pakuptueshme] ty, se janë e njëjta pyetja, si e jotja dhe si e

1 [e pakuptueshme]. Për Gjykatën dua të sqaroj, kjo bisedë është  
2 mbasi është marrë vesh me ju ai dhe tash vjen këtu me pastru  
3 ai veten, me lënë fajin. A e shihni që mundohet të na bëjë  
4 fajtorë? Unë po e pranoj edhe sot, edhe këtu po e them, edhe  
5 prapë mendoj që kam bërë mirë për hir të transparencës dhe  
6 interesit publik që kam tregua diçka që më ka ardhur. E ky  
7 këtu tash po mundohet të më ngarkojë për përgjegjësinë që e ka  
8 shumuar ai. Dhe po i them "unë t'i kam pru. Ti të mos i  
9 merrje, s'kishe pasur askënd me thirr". Po tash ja pash hairin  
10 vetë. Kjo është zoti Prokuror. Ky, zoti Prokuror, këtu ka  
11 ardhur mbasi ka biseduar me ju. Këqyre mirë orën, këqyre mirë  
12 datën, këqyre mirë dëshminë. Kështu që ky tash e ka kryer  
13 punën tënde këtu. E ka përgatitur ty materialet.

14 Po unë nuk mund të marr një -- unë këtë përgjegjësi që po  
15 e marr te ky, po e marr edhe këtu. Po them, po zoti Prokuror,  
16 i kam marrë materialet që m'i keni sjellë ose kush m'i ka  
17 sjellë. I kam qit dhe i kam treguar për hir të transparencës  
18 dhe interesit publik se çka na ka mbërritur. Aty pastaj, këta  
19 kishin pasur mundësi të mos merrnin asnjë send. Pse ky i vetmi  
20 tash -- po tash jam duke e realizu. Pse është ky tani i vetmi  
21 gazetar, punëtor i tij, se ai është viktimë e atij, lypi të  
22 merrte komplet. Është shumë interesante për mu. Tash është  
23 interesante. [e pakuptueshme] jam kujtuar. Është [e  
24 pakuptueshme] se kështu është, se ky tani -- ky tani është në  
25 hall. Është në hall që të bëjë punën e vet.

1 Py. Zoti Haradinaj, përmendët interesin publik dy herë në  
2 përgjigjen e fundit. Për mendim tuaj, cila është arsyeja që  
3 kjo të ishte në interes publik. Sepse kjo nuk dihej publikisht  
4 përpara. A nuk është kështu?

5 Edhe njëherë, për hir të procesverbalit, me fjalë të  
6 përgjigjeni ju lutem.

7 Pë. Shiko, ishte në interes publik se e kam cek më përpara.  
8 Ne kemi qenë shumë të sulmuar. Kritikkat ndaj kësaj prokurorie  
9 nuk kanë filluar me ardhjen e dokumenteve, të lutem. Kritika  
10 kemi pasur katër vjet a pesë vjet përpara dhe gjithmonë të  
11 bazuara -- të bazuara në thëniet e koordinatorit tuaj, pra  
12 numrit 2 këtu, që është. Ai ka folur vetë publikisht. Të  
13 gjitha këto gjëra. Dhe pastaj të disa dëshmitarëve këtu që i  
14 keni. Këtu ju keni -- që këtu i keni ju dy dëshmitarë, tre  
15 dëshmitarë që privatisht kanë thirrur konferenca -- konferenca  
16 privatisht i kanë thirrur. Se këta dëshmitarët që i ke ti këtu  
17 kanë thirrur konferenca në mes të qytetit, dhe lajmërojnë --  
18 shkruajnë vullnetarisht.

19 Kështu që ne këtë kundërshtim me ju nuk e kemi bërë prej  
20 asaj dite që kanë ardhur dokumentet. Ne këto kundërshtime me  
21 ju i kemi pasur tuj i ndëgjju dëshmitarët që i ke ti këtu, që  
22 në publik kanë folur. Dhe këto dokumente tash për ne kanë qenë  
23 të dyshimta. E kam thënë edhe atëherë. Ne nuk e kemi ditur të  
24 saktë, as nëse ishin tuajat, as se na i ka montuar dikush, as  
25 na i ka prurë dikush me qëllim, as na i ka prurë dikur me na

1 marrë e me na bërë diçka. Prandaj ka qenë interes publik, që  
2 të dihet çka na ka ardhur. Po të kishim dashur t'i  
3 shpërndanim, zoti Prokuror, i kisha shpërndarë dhe kisha marrë  
4 përgjegjësi edhe këtu, sikur po e marr përgjegjësinë dhe nuk  
5 jam kah i iki përgjegjësisë, atë punë që e kam bërë, e kam  
6 bërë dhe zoti Prokuror, po të them ty edhe Gjykatës. Për këtë  
7 punë që e kam bërë, që e kam marrë prej aty dhe i kam qitë  
8 andej dhe e kam treguar çka na ka ardh, nuk pendohemi as tash.  
9 Py. Domethënë dokumentet nuk kanë qenë publike kur kanë  
10 mbërritur në zyrën tuaj. Ju i po i bënit publike?

11 Pë. Jo, dokumentet që s'janë publike nuk mund të mbërrijnë në  
12 zyrën tonë. Unë kam letra të mia sot që nuk janë publike, që  
13 m'i ka çuar gruaja, i kam çuar gruas gjatë shërbimit ushtarak.  
14 Kam letra personale që s'i kam publike. Në momentin që ata i  
15 shkojnë dikujt, po s'mund t'i them kurrkujt "kanë qenë të  
16 fshehta, kanë qenë sekrete". S'ka qenë përgjegjësia ime. Unë  
17 s'besoj edhe sot e mendoj, nuk mund të jetë material publik ku  
18 dikush çohet e ta sjell me makinë e me thes. Qysh është  
19 sekrete ajo?

20 Ti një letër, qitap po e mban sekret po e mban sekret  
21 këtu. Pse s'po i qet? Qe këtu e kuptoj se është sekret, se m'u  
22 tha. Po e fsheh edhe ti, edhe s'erdhi te unë deri dasht te ti.

23 Ato kanë ardhur te ne. Pse sekret? Me këtë logjikë unë  
24 kam rezon. Atëherë dhe po rezonoj edhe tash. Po të kishit  
25 dashur të ishin sekrete, nëse janë tuajat, edhe një herë po

1 jua them, ju nuk e keni vërtetuar as s'po e thoni, por nëse  
2 janë tuajat, meqenëse po e bëni tonë këtë gjë, mbani  
3 përgjegjësinë. Çfarë sekreti? Pse na i prutë? Tash po e shoh  
4 që ju paskeni pas qejf që na edhe me dal me to -- shyqyr që  
5 s'e kemi bërë. Jo për diçka, por vetëm për artë arsye që kjo  
6 ka qenë kurth. Unë tash po e shikoj kurthin. Ju i paskeni  
7 prurë. Për me i bo -- na qit punë që ju po na doni me na montu  
8 që i kemi bërë ne.

9 Py. Zoti Haradinaj, vetëm me "po" ose "jo", a i bëtë publike  
10 dokumentet që erdhën në zyrën tuaj?

11 Pë. Jo. S'e kemi publikuar ne.

12 Py. Unë nuk ju pyeta nëse i keni publikuar. Ju pyeta në qoftë  
13 se bërë publike ato dokumente.

14 Pë. Unë e sqarova fjalës që e kuptoj "me i publiku" dhe po  
15 them "jo" prapë. Ta dhashë sqarimin pse po them jo. Kështu e  
16 kuptoj. Jo.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Edhe një videoincizim. Është prova  
18 P30, vula kohore 7:24 deri në 08:22. Në transkriptimin në  
19 anglisht me numër P30-ET është faqja 7 deri në faqen 8 dhe  
20 fillon me fjalët "Në rregull, zoti Haradinaj, ua kanë sjellë  
21 këto dosje" dhe përfundon me fjalët "Atje, po ju nuk do ta  
22 bëni".

23 Z. HALLING: [Përkthim] Për Trupin Gjykses dua që të  
24 informoj se shpejtësia është shumë e lartë në këtë video,  
25 kështu që unë do ta lexoj pjesën më thelbësore, për

1 procesverbalin më pas, nëse do të jetë nevoja.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

3 [Luhet videoincizimi]

4 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Për të përfunduar  
5 fjalinë e fundit: "OK, në rregull, jemi ne të padhembshmit  
6 atëherë, ne që duhet me i qit, po ju jo".

7 Py. Zoti Haradinaj, dua që të fokusohemi në fillim të videos  
8 që pamë tani, he për he. Ju pyesin drejtpërdrejtë "a po  
9 publikoni apo jo" dhe ju thoni "po". Si përputhet kjo me  
10 përgjigjen që sapo na dhatë?

11 Pë. Për të gjithë ata që e dinë shqipen vetëm 60 për qind në  
12 këtë dialog shihet që këtu është një debat i nxehtë  
13 provokativ. Në kuptimin "po publikoni" e kam nënkuptuar atë  
14 pjesën që po ja u qesim në tavolinë. Pastaj them unë këtë fort  
15 mirë "Ju po i publikoni" dhe edhe i them "Ju po i publikoni.  
16 Jo ne". Dhe ai thotë "Ne po i publikomë se po na i jepni ju"  
17 dhe më pyet mua "A është marre mos me mbajt një dosje", do të  
18 thotë ky këtu pretendon që jemi duke i bërë ne vetë e me rujt  
19 ne dosje.

20 I thashë "Jo, është marre për ju që i keni marrë. Ne --  
21 s'është marre". Prandaj kupto dialogun, kështu është në gjuhën  
22 shqipe. Kjo do të thotë "I ka..." - nuk jam duke ja ndërruar  
23 domethënien. Jepja kujt të dojë, le ta sqarojë mirë që e  
24 kupton bisedën. Këtu ai është duke më provokuar mua, pse unë  
25 s'mbaj kopje ende, domethënë pse s'kam bërë kopje, në këtë

1 kuptim e ka kur më drejtohet mua. Dhe ky më thotë mua, pse unë  
2 s'i kam publikuar. Dhe ky do të më fajësojë mua pse unë i kam  
3 qitur në tavolinë. Nëse është publikim që i kam qitur në  
4 tavolinë, atëherë në rregull. Po unë i kam qitur në tavolinë,  
5 thashë, për ju. Dhe thashë unë i kam qitur në tavolinë për ju.  
6 Ti merr e lër - s'e qet, e qet. Ti muj mos me e prek hiç. Kanë  
7 mujt të gjithë që t'i lënë q'aty.

8 Në asnjë send s'kishim bërë më, veç e kishim pritur  
9 Prokurorinë tonë, deri të kishte ardhur t'i merrte policia.  
10 Prandaj ka qenë me rëndësi vetëm për transparencë me tregue  
11 çka na ka ardhur. Ne s'kemi dashur të mbajmë të fshehtë, zoti  
12 Prokuror. Pse po bëni sikur nuk po e kuptoni kur njëqind herë  
13 po e shpjegoj. Nuk kam dashur ta mbajmë të fshehur. Se ai që  
14 ka mundur të na i sjelli ne q'aty ai ka mujt me i çue  
15 gjithkund. Unë [e pakuptueshme] që këtu prej gazetarëve, meqë  
16 ra fjala, kësi debatesh, ku më thonë "Ndoshta ty ti ka prurë  
17 një muaj më përpara". Se ishin duke supozuar, duke u munduar  
18 që të na ngarkojnë, të na ngarkojnë përgjegjësinë që më vonë  
19 ndoshta e kanë parë ata që kanë gabuar.

20 Unë s'po them, se ata janë profesionistët. Unë edhe sot  
21 po them, nuk e ndjej veten fajtor, pse i kam marrë një  
22 material që më ka ardhur dhe e kam marrë prej kësaj tavoline  
23 dhe 16 metra një kat më lart brenda zyrave të mia. S'kemi dalë  
24 jashtë zyrave, dhe i kemi lënë mbi tavolinë dhe i kemi treguar  
25 se këto letra, këto sende na kanë ardhur. Asnjë send më. Pjesa

1 tjetër aty, starton përgjegjësia e krejt tjetër kujt. Për këtë  
2 përgjegjësi po të them, edhe e mbaj, edhe nuk pendohem.

3 Po të doja, mund t'i kisha bërë dhe ka gazetarë që u kam  
4 thënë "Po të doja i kisha bërë unë". S'e kam bërë, se edhe nuk  
5 jam profesionist i atij lëmi dhe nuk kam qenë gazetar edhe nuk  
6 ka qenë çështja ime. E imja ka qenë të mos na sjelli dikush  
7 diçka, të mos na montojë dikush diçka, me na shti e me thënë -  
8 - shumë më keq do më kishe këqyrë ti mua sikur të kisha thënë  
9 "i kam mbajtur tre javë, a katër javë". Apo keni pasur dëshirë  
10 ju ndoshta që ne q'ashtu të bënim ne. S'e kemi bërë. Duke ju  
11 frikësu q'kësaj. Thjeshtë na ka ardh, kemi tregu çka na kanë  
12 ardh. Kanë pasur mundësi asnjë fletë të mos merrnin. Kurrkush  
13 kurrgjë s'do u kishte thënë. Asnjë fletë s'kanë qenë të  
14 detyruar të merrnin. Kishin pasur mundësi ta bënë sikur  
15 Halili dhe Zekerija, si thoj ka ditur s'kam shkuar më. Kanë  
16 mujt edhe ata me mos me ardh tek unë. Kush i ka ndalur? Kush i  
17 ka prurë me zor?

18 Py. Zoti Haradinaj, në fund të kësaj pjese që pamë ju pyet  
19 gazetari:

20 "Besoj se jeni në dijeni se çfarë mund të publikohet e  
21 çfarë nuk mund të publikohet, sa i takon dokumenteve sensitive  
22 dhe se cilat janë penaltetet për këtë gjë" dhe ju  
23 përgjigjeni: "Po . Pra ne jemi të padhembshmit".

24 Çfarë keni dashur të thoni me këtë?

25 Pë. Më fal - Pikërisht kjo është që unë po ua shpjegoj, zoti



1 Prokuror dhe të falënderoj që ma kujtove këtë, se kjo është  
2 esenciale. Prandaj i them: "Po, pra. Domethënë ne i kërkojmë  
3 ata që u dashkan të sakrifikohen". Se ky po kërkon që ne duhet  
4 t'i bëjmë ato. Dhe ne jemi të padhembshmit. Kjo është për t'i  
5 treguar atij që "Ti ne dashke të na sakrifikosh. Domethënë, ne  
6 jemi ata të padhembshmit. Ne jemi ata që s'ka dert me shkue  
7 dëm". Se në fakt edhe kam qenë shënjestër e mediave, e disa  
8 mediave, dorën në zemër - ka media korrekte. Por për shembull,  
9 të atij jaranit tuaj, Zekirjasi, që s'ishte, që po shihet. Po.  
10 Pse jo. Po unë e kuptoj, kryejnë detyrën e vet.

11 Kjo është esenca e "të padhembshmit", që ata duan të na  
12 bëjnë ne viktimën, siç po doni edhe ju sot.

13 Z. HALLING: [Përkthim]

14 Py. Zoti Haradinaj, në përgjigje të një pyetjeje, sa i takon  
15 publikimit të dokumenteve, në këtë rast përgjigja juaj që "Jo,  
16 nuk i publikuam por jemi ne ata që jemi ata që jemi pe zemër".  
17 Pse këtu nuk e keni thënë që nuk i keni publikuar dokumentet?  
18 Pë. Jo, nuk i kemi publikuar. Kur kemi "ne ata që paskan qenë  
19 pa zemër", domethënë "kemi qenë ne ata që s'kemi qenë njerëz".  
20 Kam qenë -- e kupton këtë, ne -- është edhe lloj alegorie ose  
21 metafore, që do të thotë: po, atëherë pra ne jemi ai objekti i  
22 sakrificës. Veteranët duhet të vdesin, veteranët duhen sharë,  
23 veteranët duhet të sulmohen. Sepse kjo luftë është bërë edhe  
24 nga ju atje. Edhe po bëhet edhe sot. Në këtë metaforë e kam  
25 thënë.

1 Py. Më herët në dëshminë tuaj sot po flisnit për këtë që nuk  
2 menduat se dokumentet që jua sollët ishin autentike apo  
3 origjinale, të vërteta. I mbaheni këtij qëndrimi?

4 Pë. Unë edhe sot nuk e kam të qartë të vërtetën. Të tregoj të  
5 vërtetën jam i interesuar ta di. Edhe sot jam i interesuar ta  
6 di. Edhe pse jam ulur unë këtu. Sepse asgjë nuk di. Më beso, e  
7 kam të paqartë.

8 Py. Në ndonjë moment nga muaji shtator 200 deri tani, a nuk  
9 erdhi ndonjë moment ku u bë e qartë për ju se çfarë ishin këto  
10 dokumente? Se të kujt ishin këto dokumente?

11 Pë. Konkretisht, kurrë, as nga oficerët tuaj, nuk na është  
12 thënë se janë dokumentet juaja. Kurrë. Veçse se e keni  
13 shfrytëzuar, mundësinë, forcën, se e keni. Qoftë politike,  
14 qoftë ekzekutive, dhe keni ardhur e i keni marrë. Ne s'i kemi  
15 kundërshtuar, ja u kemi dhënë. Përderisa një send nuk është i  
16 imi, logjikisht dhe ti thua "është i imi", dhe unë s'mund ta  
17 dokumentoj që është i tjetër kujt ose është i imi, unë ta jap  
18 ty. Kjo ka ndodhur saktë. Le të jetë në ndërgjegjen tuaj, a  
19 është i yti, a s'është yti.

20 Por unë do të jem transparent me popullin tim, me njerëz,  
21 me të tjerët që më lypin llogari që këtë detyrë -- kaq kam  
22 bërë. Dhe nesër e pasnesër, edhe ju po të doni që ta mbani të  
23 fshehtë, po të më pyeste ky, tash unë do të tregoja që ju i  
24 keni marrë. Kaq transparencë. S'kam më tepër më shumë.

25 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretares të nxjerrë

1 dokumentin P19, një video tjetër me vulë kohore 03:43 deri në  
2 04:04, me numër ERN 08197908, nga P19-ETRD. Është faqja 2, në  
3 transkriptimin në anglisht. Fillon me fjalët "I think that  
4 this is the mystery", pra "mendoj se ky është misteri" dhe  
5 mbaron me fjalët "compile such documents", pra "me përpilu  
6 dokumente të tilla".

7 Py. Zoti Haradinaj, besoj se është e qartë tani se çfarë do  
8 të ndodhë, por do presim sa të dalë transkriptimi në shqip dhe  
9 videoja.

10 [Luhet videoincizimi]

11 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Të sigurohemi që  
12 është përfshirë edhe faqja e fundit:

13 "Askush veç tyre nuk do të kishte ditur se si t'i  
14 përpilonte këto dokumente".

15 Py. Zoti Haradinaj, në video kur thoni që është e qartë që  
16 këto dokumente janë origjinale dhe të tyre", çfarë keni dashur  
17 të thoni me këtë?

18 Pë. Kam shpjeguar edhe më herët, po e shpjegoj edhe një herë  
19 se po e shoh që po insiston, ne jemi sulmuar shumë që këto  
20 dokumente i kemi mbaruar ne, jemi sulmuar shumë se këto  
21 dokumente na i kanë mbaruar serbët dhe na i kanë prurë aty,  
22 jemi sulmuar shumë se këto dokumente na i ka mbaruar qeveria,  
23 a Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Ramush Haradinaj, Fatmir Limaj,  
24 që ja u kanë prurë dhe ata na i kanë prurë ne aty. Na kanë  
25 quajtur vegla, herë të atij, herë të atij dhe këtu po mundohem

1 të sqaroj, përderisa -- domethënë kjo është hera e tretë --  
2 mbas herës së tretë, por ndoshta tre herë erdhën e morën një  
3 oficer juaji dhe doja të tregoja që të mos na akuzoni kot se  
4 nuk i kemi bërë ne. Nëse i ka bërë kush, e kanë bërë këta.  
5 Çfarë shkruhej aty, e kanë shkruar këta. Kështu që për mua --  
6 sepse unë çdo herë kam dyshuar -- mund të jetë që i ka mbaruar  
7 dikush krejt tjetër. Mund të mos jenë tuajat. Prandaj kam  
8 dashur të jem transparent, t'i qes që të shihen çka na ka  
9 ardhur.

10 Këtu është ajo esenca. Dyshimet që ne i kishim, ne kemi  
11 qenë në pikë të hallit me këto. Ne këto na kanë qit në hall.  
12 Ne këto na kanë krijuar probleme. Si veteranë na kanë krijuar  
13 probleme. Mediat janë shumë të kontrolluara dhe nuk japin  
14 asnjë llogari. Ata që kanë qenë në Kosovë e dinë mirë nëse e  
15 lexojnë. Edhe ti nëse do ta lexosh, e di mirë, por këto po i  
16 këput pjesë-pjesë ku ti po mendon se të konvenon.

17 Prandaj kjo është duke u munduar me sqaru që ne nuk i  
18 kemi mbaruar, në këtë kuptim e kam. Se ka kuptimin e  
19 rëndësisë, a janë top sekret, a s'janë top sekret. Që top  
20 sekret mund t'ja kishte shkruar kush të kishte qejf, për mua.  
21 Në Kosovë gjithë çka bëhet, në Bullgari, në Rumani, a në  
22 Serbi, besoj se edhe ju bëni çfarë të doni. Ç'të bëjmë ne. Nuk  
23 është në kompetencat tona. Këtu, kjo është esenca pse po e  
24 them dhe kështu e kam kuptuar. Aty ku kam dashur të jem i  
25 kujdesur, ku jam munduar të mos jem -- ku kam menduar që

1 ndoshta nuk është mirë, meqenëse e dëgjoja nëpër panele, ne  
2 kemi vendosur të mos merremi me to. De facto, zoti Prokuror,  
3 ne nuk jemi marrë me to për aq sa vetëm kur na i kanë sjellë,  
4 i kemi marrë, thashë edhe një herë, i kemi qitur vetëm brenda  
5 lokalit të mbyllur tonin. Ekskluziv lokali i joni, një shkallë  
6 më lart, në një dhomë tjetër dhe e kemi treguar çka na ka  
7 ardhur. Kjo është vepra ime, kësaj i qëndroj dhe nuk i  
8 pendohem. Është e tre - katërta herë që po ta përsëris.

9 Nëse është gabim, e pranoj gabimin, nëse është gabim e  
10 është dënueshme, po more. E kam bërë. E kam bërë duke menduar,  
11 edhe po mendoj që e kam bërë vetëm për hir të transparencës  
12 dhe të sinqeritetit ndaj çdokujt. Bile edhe ndaj jush. Që ta  
13 dini, nëse nuk e keni ditur, që ta dini çka po na vjen. Nëse  
14 s'e na i keni sjellë vetë, që ta dini se çka po vjen tek ne.  
15 Dhe mendoj që kjo është dashur që të na falënderoni ju.

16 Py. Zoti Haradinaj, a e dinit në momentin e kësaj interviste,  
17 që ka qenë më datë 17 shtator, të vitit 2020, që këto  
18 dokumente që ju po merrnit kishin lidhje me proceset përpara  
19 DHSK-së?

20 Pë. Mbase ma bëni më të qartë atë që po më pyesni? S'po e  
21 kuptoj mirë, përndryshe të përgjigjem edhe këtu.

22 Py. Në momentin e kësaj video, kur është bërë kjo video, të  
23 cilën sapo e pamë, a e dinit që dokumentet që ju po merrnit  
24 kishin lidhje me procedurat para Dhomave të Specializuara të  
25 Kosovës?

1 Pë. Në fakt, në fakt, kur u regjistrua q'kjo, s'po më  
2 kujtohet, s'e di saktë se në ç'kohë, çfarë datë është  
3 regjistruar, por është intervistë e imja dhe është në lokalet  
4 e Organizatës tonë dhe tash pyetja juaj është çka dija unë?  
5 Për përmbajtjet që treguan këto dokumente? Apo për këto  
6 dokumente. S'po e kuptoj, çka po më pyesni?

7 Py. A e dinit që dokumentet të cilat ju po merrnit kishin  
8 lidhje me procedurat e DHSK-së? Me "po" ose me "jo", mjafton  
9 një po ose një jo.

10 Pë. Isha i dyshimtë dhe më shumë ka "Jo".

11 Py. Kur thatë që "askush veç tyre nuk do të kishin ditur se  
12 si t'i përpilonin këto dokumente", kush janë "ata" në këtë  
13 fjali?

14 Pë. A po më kupton se këtu po përpiqem që të tregoj se po  
15 mundohej të na fajësonin kot, se nuk janë formuluar ne. Se  
16 kemi akuzuar edhe që i kemi formuluar ne. Ka pasur gazetarë që  
17 ka kanë thënë "ju vetë i keni shkruar".

18 Se a di se cila është e vërteta? E vërteta, të tregoj,  
19 zoti Prokuror, bash asnjë send të re nuk këto letra nuk ka  
20 qenë, që s'është ditur e s'është përfulur në opinion katër  
21 vjet përpara. Me përjashtim të aktakuzës, që ka ardhur brenda,  
22 që është folur dy muaj përpara, që vetë e keni qitur. Vetë e  
23 keni proklamuar zyrtarisht. Kështu që ju po mundoheni këtu në  
24 pupla me gjet diçka, po krejt këto de fakto ta tregoj tjetër -  
25 - për mua s'kanë qenë fort interesante se krejt çka është

1 ditur dhe është folur në opinion, q'aty e kemi parë. Kurr gjë  
2 tjetër.

3 Py. Zoti Haradinaj --

4 Pë. Nuk e di çfarë sekreti ka mundur të jetë ai. Ky ka qenë  
5 sekret publik. Këto që ju po i quani sekrete, këto janë  
6 sekrete publike, katër vjet pa na arrestuar ju ne. Me  
7 përjashtim që të thashë, të kësaj pjese të aktakuzës ku e  
8 proklamuat prapë ju vetë.

9 Py. Zoti Haradinaj, më intereson vetëm kuptimi i kësaj fjale:  
10 "askush veç këtyre nuk do të kishin ditur se si t'i përpilonin  
11 këto dokumente". Kush janë "këtyre", "këta"?

12 Pë. Këtu ka kuptimin profesional, do të thotë gjithkush mund  
13 -- kurrkush s'ka mujt këto t'i bëjë. Është fjala për të hequr  
14 përgjegjësinë që nuk i kemi mbaruar ne këto dokumente. Dhe  
15 nëse i ka mbaruar dikush, e i di këto të dhëna, i dinë njerëz  
16 që janë marrë me këtë punë. Prandaj këta janë ata që janë  
17 marrë me këtë punë. Domethënë dikush që i ka ditur këto punë.  
18 Tash, a jeni ju, a është ai koordinatori juaj, a është  
19 bashkëpunëtori juaj, a kush i ka shkruar, unë nuk e di. Po  
20 këto i keni ditur ju, dhe për ne, për ju sekret edhe sot, për  
21 ne po të them është krejt sekret publik. Të gjitha q'këtu i  
22 dinë, jo mbasi kanë ardhur këto letra te na, por pa ardhur  
23 këto letra te na.

24 Py. Zoti Haradinaj, thatë më herët në dëshminë tuaj se  
25 mbajtët kopje të dokumenteve në mënyrë që ZPS-ja ët

1 konfirmonte origjinalitetin e tyre. A është e saktë?  
2 Pë. Unë kopjet së pari i kam mbajtur për gjykatën tonë të  
3 Kosovës. Kur më është bërë një pyetje nga gazetarëve "e  
4 Prokuroria Speciale nëse vjen, a i merr?" unë kam thënë "Po".  
5 I kam thënë, mundet të vijnë edhe ata t'i marrin. E ke  
6 publikisht. Mendimi im në fillim ku ka qenë, të jem i  
7 singertë, s'ka qenë për ju fare. Ka qenë për gjykatat e mia,  
8 se unë e njoh vendin tim, dhe ty s'të njoh hiç. Dhe me ty po  
9 bisedoj këtu tani se ti ke thënë "jam i Kosovës". Se s'kam  
10 nevojë të të njoh. Se s'jam përgjegjës ndaj teje unë. Unë jam  
11 përgjegjës ndaj vendit tim. Dhe në se në shtetin tënd, bëj  
12 diçka tjetër. Meqenëse ti thua "jam i Kosovës" dhe kjo Gjykatë  
13 që po besoj që tamam ka për të qenë e drejtë -- unë për hir të  
14 Gjykatës bisedoj me ty. Se po të mos ishe i Kosovës s'kisha  
15 për të biseduar fare. Prandaj po e them këtë, ne -- i singertë  
16 jam -- unë kam dashur dhe kam pritur dhe jam llafosur dhe sot  
17 po llafosem jo pse s'kanë ardhur që t'i marrin ato. Se në fund  
18 të fundit le të vijë kush të dojë materialin e vet, po pse  
19 shteti im është -- hiç s'është shtet, se s'guxon të ndihet  
20 prej jush. Se më kanë thënë - se tash po më kujtohet,  
21 Dëshmitari nr. 1 që e ke këtu, ka thënë "S'guxojnë, s'guxojnë  
22 të vijnë e t'i marrin". Dhe kjo është fyese për mua, është  
23 fyese për shtetin tim, është fyese për lirinë, dhe është fyese  
24 për pavarësinë e shtetit tim. Nëse dikush s'guxon prej jush që  
25 të vijnë e t'i marrin, ata -- prokuroria e vendit tim, policia



1 e vendit tim, hetuesit e vendit tim. Këtu e kam unë  
2 problemin.

3 Py. Videon tjetër do të dua që ta shohim duke pasur parasysh  
4 këtë përgjigje, është P35.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Por i nderuar Gjykatës, duke pasur  
6 parasysh edhe kohën që po afron ora e pushimit, mendoj do të  
7 ishte më shpejtë të lexonim transkriptimin.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë  
9 kundërshtim?

10 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, kam kundërshtim sepse zoti  
11 Haradinaj ka të drejtë që ta dëgjojë videon.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet ta  
13 dëgjojmë videon.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Në rregull, s'ka problem.

15 Atëherë ERN 08213601, P35-ETRED në transkriptimin  
16 anglisht në faqen 7. Fillon ku gazetari thotë "when you will  
17 hand over these files", "a do t'i dorëzoni këto dosje" dhe  
18 mbaron me fjalët në anglisht "authentic or not", "origjinale  
19 apo jo". Është nga konferenca e tretë për shtyp, e datës 22  
20 shtator e vitit 2020.

21 [Luhet videoincizimi]

22 Z. HALLING: [Përkthim]

23 Py. Zoti Haradinaj, në veçanti fjalët "vetëm për ata që të  
24 konfirmojnë autenticitetin, origjinalitetin, siç bënë me dy të  
25 tjerat, që të mos kenë spekulime. Janë apo jo". Pra do të

1 thotë që për dy të tjerat, do të thotë që ishin autentike?  
2 Kështu mendoni?  
3 Pë. Përkundrazi. E sheh si po e keqkupton? Dua të them, sikur  
4 ato dy të tjerat, që kurrë s'e kanë komentuar, a janë a s'janë  
5 autentike, kështu që kanë pritur që do të veprojnë edhe më  
6 këto të tretat sikur me dy të tjerat. Pra të pakonfirmuara a  
7 janë as janë. Sepse ne asnjëherë nuk e kemi marrë konfirmim,  
8 as deri sot, e as nga ti këtu s'ndjeva që janë apo s'janë. Ne  
9 s'e dimë, a e konfirmoni. Që tash unë tash e marr vesh, s'e di  
10 që janë sekrete. Ti as qe tash s'je duke e konfirmuar.

11 Kështu që këtu është fjala. Do na konfirmojnë sikur dy të  
12 tjerat. Dy tjerat, ta kam përsëritur edhe dje, edhe sot po ta  
13 përsëris: kurrë as e para, as e dyta. Edhe e treta, saktë,  
14 bashkëpunëtorë si dy të tjerat është, se s'është konfirmuar  
15 hiç. Edhe në është konfirmuar me fletë-arrestin, me urdhrin  
16 këtu për arrest, atëherë ju e dini. S'na është konfirmuar  
17 kurrë që është material sekret. Në është konfirmuar që është  
18 material i ndjeshëm, e po e marrim. Është i vlefshëm -- disa  
19 thoshin s'janë. Kanë qenë me mëdyshje edhe vetë. Kanë qenë  
20 shumë me mëdyshje që t'i marrin, ose kanë luajtur rol, zoti  
21 Prokuror. Ata e dinë pse e kanë bërë ashtu. Ne na kanë lënë  
22 kuptimin që ata janë me mëdyshje që t'i marrin. S'janë as edhe  
23 aq të zellshëm. Po të kishin qenë të zellshëm që t'i merrnin  
24 këto materiale, o zoti Prokuror, o zoti Gjykatës, ore kanë  
25 mund me i nxënë kurë të donin. O duhet të gjenden që t'i linin

1 aty, kanë mundur t'i nxënë kur të donin. S'keni dashur.  
2 Prandaj dyshoj që është kurth. Tuk s'keni dashur. Të para, ka  
3 pasur mundësi t'ju befasojë edhe ju edhe ne. Edhe pse ai  
4 premtoi që do të sjellë. Shumë mirë.  
5 Pse s'erdhët që t'i nxorrët? Sa na përcillnin rrugëve,  
6 përpjetë e teposhtë. Pse nuk e përcillnit ndërtesën? Nuk keni  
7 pasur nevojë kurrë, e kemi deklaruar këtu, kurrë s'keni pasur  
8 nevojë ne që të na përcillni, e po them kurrë s'keni për të  
9 pasur nevojë Organizatën e Veteranëve që ta përcillni se janë  
10 transparentë. Kurrë s'keni për të pasur probleme me Organizata  
11 e Veteranëve nëse ju nuk i sulmoni, ngacmoni të parët. Kurrë.  
12 As tash, e mbas. Pulën me i nguc, me e provoku, kaq e keni  
13 vetë, nuk pranon. Të paktën. Tash, me na fyer, s'pranon  
14 kurrkush. Keni dashur të na fyeni. Dhe jeni duke fyer një  
15 popull me këtë lloj qasje, që e keni selektive. Thjesht vetë  
16 momenti që ju nuk doni të gjitha krime në Kosovë që kanë  
17 ndodhur që t'i jetoni, fyerje është. Fyerje dhe besoj, fyerje  
18 dhe mbulesë e krimit. Ne jemi që të zbulohen të gjitha krimet,  
19 zoti Prokuror, po të them edhe një herë, nuk ke problem me  
20 veteranët. Ju, as kurrkush. Nuk keni problem me veteranët. Nuk  
21 keni pengesë nga veteranët. Kini kërkesa nga veteranët ta  
22 shtoni volumin e punës. Kjo është kërkesa jonë. Ta zgjeroni.  
23 Po ju e keni rrethuar, e keni ngushtuar, ju s'doni të dilni  
24 prej asaj llupës ku ju e keni menduar të qëllimshme. Që  
25 pastaj, për mua po e them edhe sot, është politika. Keni

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 44

1 qëllim. Ende pa na prurë këtu ju keni qëllim. Ky është mendimi  
2 im për ju, edhe i veteranëve, dhe i shumicës. Këtë opinion  
3 jeni duke treguar në Kosovë. Ndoshta nuk doni, por sjelljet  
4 tuaja këtë opinion, këtë opinion -- kjo flitet në Kosovë nga  
5 çdokush.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund të bëjmë  
7 pushimin tani. Do bëjmë ndërprerjen deri në orën 11.30.

8 --- Pauza fillon në orën 11.00

9 --- Seanca rifillon në orën 11.30

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Bowden,  
11 doni t'i drejtoheni Trupit Gjykses në emër të zoti Gucati?

12 Z. BOWDEN: [Përkthim] Po. Sikurse e shikoni nuk është i  
13 pranishëm zoti Gucati. Në fillim të seancës sot më është vënë  
14 në vëmendje gjendja e tij. Ai nuk është në gjendje të mirë  
15 shëndetësore, ka marrë ilaçe kundër dhimbjeve mbrëmë. E ka një  
16 takim me mjekun në orën 06:00 sot.

17 Ai u përpoq që të qëndronte në sallë gjatë vazhimit të  
18 procedurës sot, mirëpo dhimbjet vazhdojnë, nuk është në  
19 gjendje të mirë fizike për të qenë i pranishëm. Nuk kam një  
20 diagnozë mjekësore por besoj që do të kemi sonte dhe do të ju  
21 jap udhëzime sesi do të vazhdojmë.

22 E di që vështirësitë dalin nga interpretimi i rregullit  
23 68. Edhe pse ky rregull mundëson ndjekjen e procedurave prej  
24 tij, rregulli 68(4)(c) mundëson vazhdimin e procesit edhe pa  
25 praninë e tij fizike.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Fakti që  
2 dhatë gjendjen e tij shëndetësore, mundëson që ai mund të  
3 ndjekë procedurën nga larg dhe kjo është ajo që është më me  
4 rëndësi.

5 Z. BOWDEN: [Përkthim] Nëse ky është interpretimi që bën  
6 Trupi Gjykes, atëherë le të jetë ashtu. Gjithsesi, në këto  
7 rrethana të jashtëzakonshme dhe duke qenë se kjo ndodhi gjatë  
8 vetë procesit, mospjesëmarrja e tij del nga gjendja e tij e  
9 ligë fizike dhe shëndetësore dhe mbi këtë bazë mund të  
10 veprojmë në përputhje me nenet 68(4)(c) dhe (d) në qoftë se  
11 Trupi Gjykes i interpreton ashtu ato dispozita ligjore, duke  
12 marrë parasysh se vlerësimi i gjendjes shëndetësore të zoti  
13 Gucati do të bëhet nesër ose ne do të kemi rezultatin e asaj  
14 nesër.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ju  
16 kuptova. A nuk doni që ai të ndjekë procedurën prej larg?

17 Z. BOWDEN: [Përkthim] Jo. Për shkak të gjendjes së tij,  
18 ai në mënyrë të jovullnetare heq të drejtën e vet për të qenë  
19 i pranishëm në seancën e sotme.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk kemi  
21 problem në qoftë se ai nuk është i pranishëm në sallë por  
22 thjesht duam që të ketë mundësinë që t'i ndjekë procedurat nga  
23 larg dhe do t'i bëjmë përgatitjet e nevojshme. Në këtë drejtim  
24 nuk e marrim këtë në asnjë mënyrë ndryshe sepse e dimë që ai  
25 ndjek procedurat rregullisht. Atëherë do të bëjmë pushim tani.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Ne kishim ndërmend që të  
2 përfundojmë sot me pyetjet tona më së largëti nesër në seancën  
3 e mëngjesit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë --  
5 [Trupi Gjykes dhe juristi këshillohen]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për hir të  
7 procesit për ditën e sotme dhe duke marrë parasysh se  
8 vlerësimi mjekësor do të bëhet sot dhe rrethanat do të vlejné  
9 rrethanat përkatëse do të vlejné pas atij vlerësimi që do të  
10 bëjnë mjeku, mund të mbahet parasysh rregulli 68(6) për sa i  
11 përket ditës së nesërme.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Në qoftë se i akuzuari e ndjek  
13 seancën nga larg atëherë vlen rregulli 68(6), atëherë në qoftë  
14 se i akuzuari nuk është i pranishëm dhe nuk ndjek procedurat,  
15 atëherë vlen rregulli 68(4).

16 Ne mund të themi se rregulli 68(4)(c) thotë se "i  
17 akuzuari në mënyrë vullnetare ka heq dorë nga e drejta e tij  
18 për të qenë i pranishëm". Dhe kjo duhet të regjistrohet në  
19 mënyrë zyrtare.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të  
21 merrni një dokument me shkrim se ai heq dorë prej kësaj të  
22 drejte?

23 Z. BOWDEN: [Përkthim] Po, mundemi. Por ndoshta jo brenda  
24 ditës së sotme, duke qenë se vazhdojmë procedurat.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë mund

1 ta bëni këtë për nesër.

2 Sipas rregullit 68(4), i akuzuari në mënyrë vullnetare  
3 dhe në konsultim me avokatin e tij dhe duke mbajtur parasysh  
4 se do të japë pëlqimin e tij me shkrim, heq dorë nga e drejta  
5 e tij për të qenë i pranishëm sot.

6 Ne e vlerësojmë bashkëpunimin e avokatëve.

7 Zoti Cadman, ju keni koment lidhur me këtë?

8 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo. Unë e pashë edhe vetë zotin  
9 Gucati sot në mëngjes dhe e di se në çfarë gjendje është.

10 Z. BOWDEN: [Përkthim] Vetëm një gjë, të nderuar Gjykatës.  
11 E kam të qartë nga komunikimi i Zyrës Administrative se  
12 konferenca me Zoom do të jetë e disponueshme prej orës 9.00 në  
13 mëngjes. Për këtë qëllim do të na duhet kohë që të japim  
14 Trupit Gjykses dokumentin me shkrim, pëlqimin me shkrim.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne do të  
16 mbështesim mendimin tuaj dhe do t'i japim udhëzimet e duhura  
17 Zyrës Administrative me pëlqimin tonë.

18 Z. BOWDEN: [Përkthim] Faleminderit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
20 vazhdoni.

21 Z. HALLING: [Përkthim]

22 Py. Do ta hapim këtë seancë zoti Haradinaj me një video.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Është prova P1. Është konferenca e  
24 parë për shtyp. Koha prej minutës 03:16 deri në 04:10. Në  
25 transkriptin në anglisht është dokumenti me numër P1-ETRED.

1 Faqja 2. Kurse numri ERN i provës është 08134401. Dhe  
2 fragmenti fillon "Ajo që më keq" dhe përfundon me fjalët "Atë  
3 që e kanë thënë më parë".

4 Py. Dhe Zoti Haradinaj, mbasi ta shikojmë këtë video do  
5 t'ju bëj disa pyetje në lidhje me të.

6 [Luhet videoincizimi]

7 Z. HALLING: [Përkthim]

8 Py. Zoti Haradinaj, ju e keni ditur që ka pasur emra  
9 dëshmitarësh në materialet që i keni pasur para jush në atë  
10 kohë; a është kjo e saktë?

11 Pë. Po. I pashë aty. I pashë edhe ku i keni marrë në pyetje.  
12 I pashë edhe si i keni marrë në pyetje. I pashë edhe me kënd  
13 bashkëpunut. I pashë edhe kush i ka marrë në pyetje, do të  
14 thotë, njerëz që kanë marrë në pyetje prej 1981, gjatë kohës  
15 së luftës. Dhe rezoni edhe prapë po të pyes, cili ishte  
16 rezoni? Çka ishte ajo që i prutë? Është thanë se Gjykata po  
17 bohet për hir se mundet në Kosovë me bo abdikim me hetu  
18 dëshmitarët, mos me hetu dëshmitarët. Të gjitha ato u panë  
19 aty. Emra, mbiemra, pava kam pa aktgjykime që në kohën e 1981  
20 të gjykatave serbe. Kjo është ajo që më shqetësoi mu.

21 Dhe prapë po të them edhe sot: Cili është rezoni, zoti  
22 Prokuror, që ja çunin një dokument të juajin pa marrë parasysh  
23 nëse e quani, nëse po e pranoni? Cili rezon i juve e keni  
24 sekret dhe prej Holande mbërrijnë në zyrat e mia? Cili është  
25 qëllimi? Kush është ai që ma sjelli? Për çka ma sjelli? Prapë



1 po të pyes, cili është?

2 Komplet kësaj, veç po ta përsëriti edhe njëherë, që me  
3 kanë e qartë për të gjithë të tjerët. Unë s'e kuptoj as sot.  
4 Py. Në atë kohë, a e keni kuptu se ata dëshmitarë janë nën  
5 një farë mbrojtjeje; a është kjo e saktë?

6 Pë. Po ta përsëris dhe po të them edhe njëherë, harxhoni kot  
7 fjalë me thënë që ka dëshmitarë të mbrojtjes dhe pesë vjet pa  
8 ardhë që këto sende. Këta emra janë përsërit dhe po përsëriten  
9 në Kosovë. Këta emra i kanë qitë në kohën e Salustros.  
10 inFokusi, që ky inFokus, ko incidencë po pa të tregoj. Pronari  
11 i këtij inFokusi është i njëjti person që mundet në 1981 si  
12 fëmijë më ka dalë dëshmitar që më ka pa nëpër shkollë të  
13 gjimnazit tue e organizu protestën. Dhe një prej dëshmitarëve  
14 është ky që unë jam dënu. Flas investitorin e inFokusit.

15 Tash mu kujtu. 40 mbas u përsërit rasti këtu. Zoti  
16 Prokuror, dashje pa dashje për mua ko incidencë që të gjitha po  
17 më dalin sikur në 1981. Në 1981 e kam pranë dhe po them jam ka  
18 e pranoj edhe këtu çka kam bo me vetëdije se nuk i iki asaj  
19 çka kam bo. Vetëdija jeme çka kam bo dhe s'po iki është: Më ka  
20 sjellë një i huaj, një i panjofshëm, që mund të jetë gjithçka,  
21 diçka e kam marrë e qit një kat ma nalt kam tregu çka asht  
22 ardh. Të kam ndihmu edhe ty nëse a kanë për ty. A dash me më  
23 falenderu, jo me më ul ti mu këtu me më fajësu mu për probleme  
24 tuaja që i ke atje mbrenda zyrave tuaja nëse i ke, nëse janë  
25 tuat. Prapë po them, unë as sot s'e kam të qartë.

1 Në Kosovë, inFokusi ka qit përgjimet e hetuesve hala pa  
2 dalë gjyqi. Ka qitë përgjimet e hetuesve nëpër gazeta. Kurrë  
3 s'u dënu. Tjetra, me pat ndodhë në Kosovë, zoti Prokuror, me  
4 pat ndodhë në Kosovë me e marrë Gjykatat e Kosovës një  
5 gazetar, dëshmitar që më deklaroi që më kanë marrë dhunshëm,  
6 shoqatat e tyre, gazetarë e gazetaruca ishin bo tmerru Kosovën  
7 e Gjykatën tana i kishin. Prej jush s'e ndin as zënin s'e  
8 bënë. Dhe kjo nuk a krejt, nuk a krejt rastësisht.  
9 Py. Zoti Haradinaj, përgjigja që po jepni tani, nuk i  
10 përgjigjet pyetjes që bëna unë. Pyetja ime është, a e keni  
11 ditur gjatë atij momenti se dëshmitarët që përmendeshin aty  
12 ishin të mbrojtur? A mund, të lutem, të përgjigjesh me "po"  
13 ose "jo".

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]. Komplet mor deklaratat, ka njerëz mor, ka njerëz

1 qetu që po i lexoj, ka njerëz që i kanë deklaratat e veta mor.  
2 Kanë deklaruar vetë. Nuk është që është që u bo na një zbulim.  
3 Çka? Çka po e boni diçka që dihet 5 vjet? Ju po doni tash me i  
4 prezantu si diçka të msheftë. Po thjesht nëse ty të duhet një  
5 viktimë, shiqo, për ty s'jam në gjendje me u viktimizu asnjë  
6 send. Për vendin tem jam. Po du drejtësi.

7 Thashë përgjegjësia jemi është dhe po kërkoj, nëse është  
8 e dënueshme këta që kam bo, po e pranoj fajin. Kam marrë letër  
9 që më ka pru dikush, që ti s'po e pranon që ma ke pru, që unë  
10 dyshoj që ma ke pru me këto sjelljet që po i bon ndaj meje dhe  
11 kam thënë më ka pru dikush kët top letra dhe e kam qit një kat  
12 ma nalt dhe e kam lënë këtu. A e marrin a s'e marrin, a e  
13 qesin a s'e qesin. Këtu te mas nuk ka qenë përgjegjësia jeme.  
14 Dhe as jam mundu me ndiku, as me inponu. Kur janë mundu mu me  
15 ma inponu, unë kam thënë se deri këtu është detyra jeme për  
16 transparencë dhe hir të interesit publik. Kaq. Nuk ka ma  
17 shumë. Nëse kjo është e dënueshme, e pranoj këtë gabim, e  
18 pranoj këtë faj. E kam bo. Po e kam bo gjithmonë në hir dhe  
19 për interes të transparencës dhe asaj qe a publike.

20 Por nëse ju thoni që ka dalë qetu diçka, për q'aq sa kam  
21 shfletu unë, që nuk a fol tri deri në katër vjet më përpara,  
22 me përjashtim të Paketës 3, që u fol dy muaj ma përpara e që  
23 vetë e keni qit. Unë lypi dënimin kapital maksimal nëse nuk a  
24 kështu që po them. Kjo a lehtë me u vërtetu. Sa ke hup kohën  
25 nëpër Facebook-a, tanë, ke mujt lehtë me i vërtetu. Po unë e

1 di që i ke të vërtetune, po ty s'po të konvenojnë me i qit  
2 ato.

3 Prandaj, të lutem, luftomë me armë të barabarta. Unë e  
4 kuptoj se ti ki forcën, tana je ka i shfrytëzon ato. Po edhe  
5 unë e kam forcën morale që guxoj dhe kam guximin qytetar timin  
6 dhe mendimin tim të lirë me fol atë çka them dhe po du me  
7 mbajt përgjegjësi për këto çka po i them. Nuk jam tuj ti ik  
8 përgjegjesisë për çka i kam bo.

9 Edhe njëherë po të them, përgjegjësia jeme është një  
10 dokument që ma ka pru dikush, na ka vendos pa marrëveshjen  
11 tonë dhe unë e kam thirrë median dhe i kam thënë këqyre ka  
12 ardh që kjo. Edhe i kam lënë aty. Kaq. Që kjo a përgjegjësia  
13 jeme. Këtë përgjegjësi e mbaj dhe këta e kam bo.

14 Nëse është e gjatë përgjigja, kjo është. Këta emra edhe  
15 njëherë mos u mundo me i paraqit sikur dolën për herë të parë  
16 këtu. Janë emra që janë përmend dhe janë laku në opinion mbi  
17 pesë vite ose për hatër tënd po e zvogëlojnë katër vite, tri  
18 vite.

19 Të vetmit emra edhe emrat -- të vetmit emra që janë laku  
20 mbasandaj janë laku edhe përpara se do të bohet kështu do të  
21 bohet por këta që kanë ardhë dokumentat e tretë, po dokumenti  
22 i tretë i qiti këta emra që u përfolke. Kurr gjë tjetër.  
23 Njerëzit janë thirrë dhe me kompetencat që i din kënd ka me  
24 thirr Gjykatën. Urdnno këqyre shtypin kosovar i dëgjon  
25 gazetarët, i dëgjon analistë tuj, kush ma shumë din me folë

1 për Gjykatën.

2 Py. Zoti Haradinaj, jo vetëm që dhatë njoftim që i keni pasur  
3 këto dërgesat. Ju këto jua bëtë të ditur njerëzve sepse nuk  
4 donit që të akuzoheshit për fabrikimin apo falsifikimin e  
5 këtyre dokumenteve; është ky qëndrimi juaj? Në qoftë se doni  
6 do ta përsëris edhe njëherë pyetjen.

7 Pë. Po. Qëndrimi jonë a kanë për me e tregu se na kanë ardh  
8 vetëm me tregu që këto dokument nuk janë tonët dhe asgjë  
9 tjetër. Dhe dikush na i ka sjellë. Kjo ka qenë. Po. Vetëm kaq.  
10 Jo ma tej. Vetëm kaq.

11 Py. Po as keni mund që ta provoni këtë fakt që  
12 dokumentet nuk janë të juajat duke bërë redaktime, shlyerje të  
13 emrave të dëshmitarëve në vet dokumentet, a s'keni mund ta  
14 provoni këtë në këtë mënyrë?

15 Pë. Po unë s'kam qit kurrfarë dokumenti që shihet asnjë emër,  
16 as një shkrim. Çka kam redaktu unë? Dhe çka di unë me redaktu?  
17 Ja kam ngarkon me kompetenca që i ke ti këtu me i bo ato  
18 redaktime dhe mu po ma ngarkon me kompetenca tua, që është  
19 kompetencë e jotja, me i rujt dokumentin tënd. Unë nuk kam  
20 pasë nevojë me redaktu asnjë send se nuk kam publiku as te një  
21 send. As një faqe unë s'e kam publiku. Çka me redaktu kur  
22 s'kam publiku. Dhe s'kam dashtë me i hi asaj pune. S'a kanë  
23 punë e jemja.

24 Ata që kam mendu, që dinë dhe janë më profesionalist edhe  
25 duhet çka me bo unë ja kam dorëzu. Ashtu i kam mendu që janë

1 profesionale. Unë s'e kam ditë që janë tarrakopa e turli farë  
2 asi hori. E vërteta është ata që kam dashtë me bo unë e kam  
3 bo. Kam tregu çka na ka ardhë. Kurr gjë tjetër.

4 Py. Dhe përgjigja juaj që dhatë tani në të thatë:

5 "Çfarë të redaktoj kur s'kam publiku asnjë gjë? Edhe as  
6 që kam dash me e bo një gjë të tillë"

7 Nuk keni dashë t'i redaktoni emrat, këto doni të thoni?

8 Pë. Zoti Prokuror, po më vjen keq që duhet me t'u drejtu me  
9 këto fjalë. Mos e luaj rolin e budallit s'kishe, s'po e din  
10 çka thashë. Ose edhe njëherë po të them, kërkoj le të

11 ndërrohen përkthyesit se nuk je ka kupton çka jem ka them.

12 Thashë, nuk kam pasë nevojë as me redaktu, as me mos me  
13 redaktu, as me u marrë me këto se s'ka qenë as detyrë e jemja,  
14 as qëllimi jem me i publiku. Qëllimi jem ka qenë me dëshmu çka  
15 më ka ardhë. Ti mendo shka të dush në kokën tënde. Mendimi jem  
16 është që ky. Dhe unë të kuptoj edhe ty për mendimin tënd të  
17 lirë. Po mendimi jem a që ky. Këtij unë i qëndroj.

18 Py. Zoti Haradinaj, pyetja ime është, a keni dashtë me i  
19 redaktu emrat? A mund të lutem t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje.

20 Pë. S'kam dashtë me u marrë hiç. S'kam mendu për atë punë as  
21 me i redaktu, as mos me i redaktu. Nuk kam shku në atë proces  
22 unë, s'kam mbërri atje për me vendos a po i redaktoj, a s'po i  
23 redaktoj. Se s'kam mendu hiç unë me i publiku vetë. Edhe po  
24 t'i kisha redaktu unë, çka di unë? Ça po më ngarkon mu me atë  
25 përgjegjësi? Çka di unë? Unë kam tregu çka më ka ardhë. Ka

1 qenë detyra e atyne që janë profesionalista, thirri këtë  
2 persona të bojnë ato ose mos ta bojnë. Ça po më ngarkon me një  
3 detyrë që as kam mendu me e bo? S'kam mendu me e bo. Kështu që  
4 diçka që s'mendon me e bo, nuk mundesh me e mendu shka ke me  
5 bo.

6 Nuk kam mendu me i shpërnda. Nuk kam mendu me i publiku.  
7 Nëse ti ma quan publikim këta që po i shpjegoj që 100 herë  
8 edhe tjetër përgjigje prej meje s'merr edhe 3.000 herë në  
9 pyetsh. Nëse që kjo është publikim që kam marrë prej këtu i  
10 kam çu deri këtu, kët publikim po ta pranoj nëse është  
11 publikim. Po as kam shpërnda, as i kam imponu kujt me i qitë.  
12 As i kam thënë shly, as mos i shly. Edhe ato ku i kem përsërit  
13 "Mos përsëritni emra". I kem thënë si opinion që i kem marrë  
14 pas opinionistëve nëpër debate ku jam shku, kanë thënë që a  
15 mirë, njerëz profesional, i kam thënë dhe na e ke përsërit.  
16 Edhe ato janë mendime të marruna nga njerëzitt, tuj i llogarit  
17 unë, që janë më profesional se unë.

18 Përndryshe, po të kisha vendos unë me i redaktu a mos me  
19 i redaktu, atëherë çfarë kuptimi ka pasur me i ja jap tjerëve  
20 e bo ata çka dojnë? I kisha bo vetë. S'e kam pasë qëllim hiç  
21 me shpërnda. Kështu që s'ka ardhë në shprehje pyetja: Shka me  
22 bo a me i redaktu a mos me i redaktu? Se diçka që nuk e  
23 publikon, s'ke nevojë me redaku as mos me redaktu. E nëse ju  
24 këta ma quani publikim, -- po, zoti Gjykatës, po e pranoj para  
25 jush. Nëse kjo pjesë a publikim me e marrë prej brenda

1 objektit tënd këtu e mos me çu ma larg se këtu prapë brenda  
2 objektit tënd, këtë e kam bo. Deri këtu. Kam marrë prej kësaj  
3 tavoline e kam qitë në këtë tavolinë. Kem thirrë një  
4 konferencë dhe kam tregu për hir të transparencës dhe  
5 interesit publik se çka na ka ndodhë ne në zyrë. Këtu  
6 përfundon puna jeme dhe vepra nëse është e jeme. Këtë e  
7 pranoj.

8 Përgjigjem, jam i gatshëm me pranë edhe me u përgjigj për  
9 ta dhe e marr përgjegjësi. Po, e kam bo. Tuj mendu, gjithmonë,  
10 se është transparencë në interes publik dhe në interes të  
11 organizatës tonë. Sepse e keni bo monstër Organizatën e  
12 Veteranëve. Zoti Prokuror, sa përpara dijeni Organizata e  
13 Veteranëve nuk është ajo çka ju mendoni. Organizata e  
14 Veteranëve nëse don me kuptu thjesht, se unë e di kam jetu në  
15 Evropë, është sindikatë. S'ka kurrë me ushtarake, s'ka  
16 kurrë me agresivitet. Është sindikatë. Dhe sindikata,  
17 kryetari i sindikatës derisa ata e shohin, e kanë një  
18 udhëheqësi për mbrojtjen e interesave të tyre.

19 Nuk jemi na qysh jeni ka na paraqit ju. Na jemi kanë  
20 njerëz që kem marrë pjesë në luftë, detyrueshëm, në kuptimin  
21 në një luftë të imponume. Kemi kry misionin tonë. Do na kanë  
22 vdekur, do janë plagosur, do janë ka vdesin përditë. Kështu që  
23 edhe si specie, po ju them në mënyrë biologjike, jemi në  
24 zhdukje e sipër. Dhashtë Zoti kurrë më s'ka më veteranë të rij  
25 në shtetin tim as të kurrkuj. Kjo a dëshira jeme, si veteran



1 po ta them. Se nuk asht e mirë, se a vuajtje, se a tmerr.

2 Prandaj mos e paraqitni gogol veteranët. E Organizata e  
3 Veteranëve, për me jua sqaru ju, është sindikatë. Organizatë  
4 jo-qeveritare e regjistrueme brenda ligjeve të Kosovës sikur  
5 çdo organizatë tjetër.

6 Prandaj, kemi kry detyrën e një udhëheqësi të një  
7 sindikate, siç bëjnë gjithë sindikalistët.

8 Py. Zoti Haradinaj, kjo është shumë përtej pyetjes që ua  
9 bëna. Kam një pyetje tjetër. Në qoftë se mediat kishin  
10 shqetësimin se do ta shkelnin ligjin duke publikuar dokumentet  
11 që ju ua dhatë, ju vetë do ta kishit bë këtë gjithsesi; a  
12 është kjo e saktë?

13 Pë. Shumë e pasaktë. Ky a konkludim i yti.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Kërkoj nga Sekretarja që të  
15 vendosë dokumentin P6. Me numrin e provës 08135502. Vula  
16 kohore 35:33 deri 35:55. Kjo është faqja P6-ET, 15 e  
17 transkriptit në anglisht. Fillon me fjalët "Atëherë hajde e  
18 puno me ne" dhe përfundon me fjalët "Është puna juaj vëlla",  
19 "Është puna jote vëlla".

20 [Luhet videoincizimi]

21 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

22 Py. Po e lexoj fjalinë e fundit.

23 "Zoti Haradinaj: Unë e kam bo atë që dua atë që e kam  
24 ditë. Ja ku i keni tani është puna jote vëlla".

25 Zoti Haradinaj, Zoti Shabani kur ju tha që do ta shkelni

1 ligjin në qoftë se i publikoni dokumentet. Ju, në fakt, nuk u  
2 pajtuat me atë mendim të tij; a është kjo e saktë?

3 Pë. Zoti Prokuror, për besë, jam ka mendoj për të fatit tim  
4 në këtë Gjykatë dhe në këtë Prokurori. Nëse keni -- e kuptoni  
5 kështu shqipen, qysh po e transmeton çka u ka thotë këtu, të  
6 mjerët ata që kanë me u ballafaqu me ty e me ju. Po them edhe  
7 njëherë, le të jetë vërejtje për të gjithë. Ose je ka ndërron  
8 ti mendimin ose nuk është i përkthyn esenca ça.

9 Këtu po e shpjegoj se çka ka fol edhe të gjitha fjalët po  
10 i përsëriti. Edhe njëherë po e them. Është punë e tyre. Unë e  
11 kam bo shka kam bo. Do të thotë, çka kam bo? E kam marrë ja  
12 kam qitë përpara. Ai insistojke, e me siguri, tash po bindna  
13 me insistimin tënd ose të shokëve tu që unë me i publiku. Unë  
14 i kam thënë kjo është punë e jotja a i publikon a s'i  
15 publikon. Unë po them edhe njëherë, unë e kam bo punën teme.  
16 Dhe po e pranoj këtu. E kam marrë prej këtuajt ku ma pru  
17 dikush e kam qit një shkallë ma nalt dhe kam tregu shka më ka  
18 ardhë. Këtu përfundon puna jeme. Dhe prandaj, unë edhe ty po  
19 të them zoti Prokuror, unë e kam bo punën time dhe po ta  
20 pranoj dhe po tregoj cila a puna jeme.

21 Ndërsa me ma imponu ai mu i qit unë, se ai lypke me i qit  
22 unë, e ndjekësisht t'u më qit unë, t'u ma fut ashtu sin ai e  
23 din se është penale, ajo s'vlejke për mu sepse nuk kisha  
24 proklamun unë. A dashtë ai me ditë. Ose kur e ka marrë ai vesh,  
25 nëse me të vërtetë a kanë i paistruktum nga ju, a kanë vonë.

1 Le të bohet burrë ta pranon përgjegjësinë e vet. Unë po e  
2 pranoj. Ai a ardhë i ka marrë se i kam thirrë. I ka gjetë aty.  
3 Unë s'i kam shpërnda. Prandaj, zoti Prokuror, po të them edhe  
4 njëherë. Unë e kam bo punën ti që kam mendu që është në  
5 interes për transparencë dhe interes publik dhe për të mirën  
6 së parë të organizatës tanë që mos me na montu diçka.

7 Pra kjo indirekt, mbase s'po don direkt, a kanë edhe në  
8 të mirën e juj. E keni ditë se çka ka ndodhë diçka. Dhe tash  
9 ata që në një farë mënyre -- unë për këtë punë e kam bo. Ti  
10 ndërroja drejtimin qysh dush. Dhe po ta përsëris edhe njëherë,  
11 po, unë e kam bo punën teme o vlla. Ai kërkoi unë me i qit  
12 dhe vazhdu me i qit, mbasi ia kishit pa ndalë ju. Tash po e  
13 kuptoj. Kur ke këtu dëshmitari. Ai viktimë aktive.

14 Dhe inFokusi tregova, e mendova mirë, inFokusi këtë  
15 qëndrim kanë pasë çdo herë ndaj nesh e Organizatës së  
16 Veteranëve. Këtë qëndrim. Dhe po të them shumë mirë ju  
17 përfaqëson. Që tash po më përputhet mendimet tua me mendimet e  
18 tij. Edhe unë po të them, ky u mundu me ma montu. Ti nuk po e  
19 lëshon ma larg ky mundet me ma montu. Unë ja kam pranë edhe  
20 këtij sikur po pranoj ty, po, unë e kam bo punën time. Puna  
21 pra, është e kam marrë i kam qitë, kam thirrë, kam thënë që  
22 çka më ka ardhë. Aty anej, ka qenë punë e tyne, përgjegjësi e  
23 tyne. Nuk jem ka du me u shfajësu as që po i trembna asaj  
24 pune. Po ta kisha bo nuk ke pasë nevojë ti me më pyet e me më  
25 shoshit se të kisha thënë e kam bo. Unë krejt veprën time në

1 1981 çka e kam bo kundra Jugosllavisë e kam pranë dhe mburrje.

2 Diçka që e bëj, unë ja pranoj. Nëse a keq di edhe me  
3 kërku falje. Nëse a mirë dhe mendoj që a mirë, rezistoj dhe e  
4 mbroj kudo qoftë ajo në gjyq e kudo qoftë. Prandaj këto që e  
5 kam bo, po them e kam bo. Këtë që s'e kam bo, jam ka thënë që  
6 s'e kam bo. Bile po më vjen mirë që as ky që e keni porosit ju  
7 me më shti me i bo s'ka mbërri, s'ka mujt me i bo. Dhe shumë  
8 mirë që s'bëra ndikim. Se me pat dashtë me i bo, unë s'i kisha  
9 thirrë këta, as kisha kallëzu hiç, a kisha mësuf, a u kisha  
10 thirre jua. Ju kam thirrë edhe ju, indirekt ju kam thirrë edhe  
11 ju se ju kam përmend në televizion. Le të vijnë t'i marrin.

12 Ju kam tregu edhe ju që, ai që ka pru ka thanë bie apet.  
13 Si kam besu as unë. E s'e keni besu ndoshta as ju. Po kur u  
14 përsërit pse s'i besut? Dhe më keni arrestu se unë po mendoj  
15 që ai njeri tri herë që ka thënë ju bi dhe kam me ju pru apet.  
16 Unë apet besoj që ai ka dhe i kisha pru pi kuni atje. Ose ju i  
17 keni tërhek mbrapa tash. E keni kry misionin e juve me që kaq  
18 edhe i runi për dikënd tjetër. Po më duhet me spjegu gatë se  
19 po don me montu diçka që s'e kam bo.

20 Zoti Prokuror, jam ka e pranoj çka kam bo. Kam marrë, kam  
21 kallëzu ça më ka ardhë. Fund.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni,  
23 zoti Cadman.

24 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk është kundërshtim. Nuk dua që  
25 të ndërpres. Unë e kuptoj që përkthyesit mezi po e kapin

1 ritmin e zotit Haradinaj. Do t'ju lutesha zotit Haradinaj, që  
2 të fliste më ngadalë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti  
4 Haradinaj, e dëgjuat këtë. Avokati juaj ju kërkon që të  
5 ngadalësoni. Unë ju kam kërkuar që të ngadalësoni. Ju lutem,  
6 ngadalësoni.

7 I AKUZUARI HARADINAJ: Ju kuptoj edhe ju edhe avokatin nuk  
8 hidhnona. Është e metë e jemja pak. Po kërkoj falje për ju  
9 edhe për ata.

10 E përsëriti edhe njëherë pra? Shkurt. Ta them shkurt si  
11 pyetje që ma boni se këta e sqarova pse po them. Jo. Dhe pse  
12 kam thënë kështu. Të njëjta jam gati të përsëriti edhe këtu.  
13 Po në kët prizëm, pra, e kam bo punën teme o vlla. Jam ka i  
14 drejtojna këtij me i thënë në një farë mënyre a merr vesh a  
15 s'merr vesh? Pjesa tjetër është e jotja dhe nuk i boj unë.  
16 Kaq. Puna jeme pra është qa ajo. Kam tregu që më ka ardhë  
17 diçka. Përfundon.

18 Z. HALLING: [Përkthim]  
19 Py. Në video ju i keni thënë gazetarit që nuk i thirrët se e  
20 dinit që nuk do t'i publikonit; a është kështu?

21 Pë. Si ju kam thënë gazetarëve? Përsërite, të lutem dhe  
22 njëherë.

23 Py. Do ta bëj:

24 "Zoti Shabani thotë: Jo, unë e bëj sepse kjo është  
25 shkelje e ligjit.

1 "Zoti Haradinaj thotë: Ne e dimë këtë, prandaj nuk ju  
2 thirrëm de e dimë që nuk kishit me i publiku".

3 A është një reflektim i saktë i asaj që keni thënë?

4 Pë. Pra, s'po e shoh këtu të -- prandaj po ti po më kërkon  
5 mua. Ti më kërkon mua. Unë ty edhe shumë kam me të kërku se ti  
6 je media -- po nëse po ta kërkon neve --

7 Py. Është në aty ku thotë 35:35 deri në 35:38 është sipër në  
8 pjesën e sipërme të faqes në shqip.

9 Pë. Unë e kam 35 deri në 36.

10 Py. Po në pjesën e poshtme kur është numri 35:35 në faqen 14.  
11 35 minuta e 35 sekonda në faqen 14.

12 Pë. 35:33. 35:35.

13 Py. Është vula kohore 35:35. Që vazhdon pastaj në faqen  
14 tjetër, është ky dialogu që unë jua lexova.

15 Pë. Nuk e kam atë faqe, më fal. Nuk e kam atë faqe, zoti  
16 Prokuror. Që tash dul. 30 e sa? 35 apo 38?

17 Py. 35:35 është ajo që ka thënë zoti Shabani. 35:38 është ajo  
18 që keni thënë ju.

19 Pë. Ngritni faqen. 35:38 faqja. E dimë, e pava. Po, po. E  
20 dimë. Po ne as të marrim sepse e dimë që ti s'i qetë ato.

21 Py. Po më ndiqni tani?

22 Pë. Po. A është e saktë që në këtë fjali ju po i thoni zotit  
23 Shabani se nuk ju pëlqente që ai nuk po i publikonte  
24 dokumentet?

25 Pë. Jo. zoti -- o zoti Prokuror, besoj që i ke lexu dhe këta

1 rreshtat poshtë ti? Shiqo mirë këtu se çfarë debati është? Ai  
2 ka insiston unë me i qitë. Po ti po më kërkon mu. Ti po më  
3 kërkon mu. Unë ty edhe ma shumë të kam kërku si je media. Ti  
4 je media. Ti e din ai i qet a s'i qet.

5 E kam thënë edhe këtu këtë mendim. E kam -- i kam tregu  
6 atyne që janë më profesionalist se na. S'kem përgjegjësi ma.  
7 Ky, shiqo, ky ose mbasi e keni tut ju ose mbasi është i  
8 porositun si ju. Ky i din problemet e veta. Ky ka ardhë me na  
9 sulmu atë ditë. Atë ditë më ka sulmu ky. Atë ditë më ka akuzu  
10 më shumë se ti. Dhe më ka akuzu me të padrejtë çka unë s'kam  
11 bo. Unë jam tuj e pranë këtu.

12 Py. Ju nuk mendonit se ai nuk -- pra, ju mendonit që ai nuk e  
13 kishte guximin me i publiku këto?

14 Pë. Jo, ka pasë guxim. A ke pa si i ka qitun. Prej këtij i  
15 kanë marrë shumë. Mos me pasë guximin s'i kish qit. Ai a tregu  
16 shumë i guximshëm. Po tash guximi i tij a ka zgjatë deri keni  
17 thënë ju, a me të vërtetë ja keni ndalë ju? Kjo a çështje që e  
18 dini ju ma mirë. Ky i ka qit ky ka pasë guxim. Nëse ky a  
19 guxim, ky ka vendos për këtë guxim. Nuk i kam qit unë.

20 Py. Po kjo është një intervistë e datës 17 shtator 2020 dhe  
21 në këtë kohë ju mendonit që ai nuk e kishte guximin që t'i  
22 publikonte apo jo?

23 Pë. Po, e ka more. A nuk je ka dëgjon këtu? A je ka më lexon  
24 vetëm mua? Këqyrë çka tha. Përkundra asaj që i ka publiku erdh  
25 më këqyri debati a në mbrëmje. A e pe që a në mbrëmje? E tha

1 vetë, nuk e thashë unë. Unë nuk e di a ka guxu as ka guxu. E  
2 tha vetë. E më tha "Bone ti". Thashë ""në s'e boj, ti je  
3 gazetar". S'jam kompetent me i vlerësu unë ato. S'e kam atë  
4 kompetencë. S'e di. S'është detyrë e jemja.  
5 Py. Mbase mund t'jua rifreskojmë kujtesën.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Të shohim të njëjtën video, ju  
7 lutem, me vulën kohore 32:08 deri në 32:026. Fillon, pra,  
8 është në faqen 11 në transkriptin anglisht dhe thotë në fillim  
9 pra, "po ti" dhe mbaron me "i publiku ato - jo më falni- "ju i  
10 morët ato para nesh".

11 I AKUZUARI HARADINAJ: Po pra. Atë mendim e kam edhe sot.  
12 Që janë shumë që kanë marrë para nesh. Derisa ai person ka  
13 mujt me na sjellë ne, s'ka mujt me i sjellë dikuj tjetër a?  
14 Po, zoti Prokuror. Po flas kadalë, më fal. Po, zoti Prokuror.

15 Z. HALLING: [Përkthim]  
16 Py. Zoti Haradinaj, po nuk e kam bërë pyetjen ende. Nuk e  
17 kam bërë pyetjen. Të dëgjojmë njëherë videon.

18 Pë. I kam thënë se ju edhe mendoj edhe sot, që ju i keni  
19 marrë para nesh. E kanë pasë mundësinë a mendimi jem i lirë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [E  
21 padëgjueshme].

22 I AKUZUARI HARADINAJ: Pyeta. Unë në përgjigje po. Po, i  
23 kam thënë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
25 prisni t'ju bëhet pyetja.



1 I AKUZUARI HARADINAJ: Një pyetje. Urno.

2 [Luhet videoincizimi]

3 Z. HALLING: [Përkthim]

4 Py. Ajo që kemi në anglisht është:

5 "Një sprovë po ju nuk e kishit guximin për t'i  
6 publikuar".

7 Zoti Haradinaj, doni ta ndryshoni përgjigjen që dhatë  
8 pyetjes së mëparshme?

9 Pë. Nuk është du me ndryshu po s' du me e këput këtu ku e  
10 këpute ti deklaratën time. Është gjysmake kjo deklaratë.

11 Thashë, se unë tash jam ka preudikoj, ju e keni pasë këtu edhe  
12 më përpara se dyshoj në ta edhe po dyshoj edhe sot. Por pritet  
13 e kuptimin e ka këtu, këtu pritet deri të vijnë te na me i  
14 qit, pastaj me i publiku ju. Qysh edhe e bon. Edhe sot po  
15 mendoj. Ai person që na i ka pru edhe sot e kam këtë mendim.

16 Ai person që na i ka pru ne këto ka mujtë me pasë, kur ka  
17 dal po thoj, na i ka pru ne kur ka dashtë ai. Pse s'jua ka çu  
18 atyne? Pse qenë të zellshëm kur na i qitëm me i publiku  
19 atëherë pra? Ndoshta e ka pru vetë ZKA-ja. Prandaj kam thënë  
20 në replika që isitojke që unë me -- ky ka insistu, i vetmi që  
21 ka insistu që na me i shpërnda si organizatë dhe, shiqo  
22 tekstin, shiqo mirë deklaratat e tij, ka qenë vetëm ky.

23 Ka qenë edhe një tjetër që më ka pyet i kam thënë "Nuk  
24 jam media". Prandaj meqë se insistoj kështu dhe u sillke sikur  
25 pronar i tyre, që po i din komplet, që ka mujt me i ditë edhe

1 mbasi i ka marrë prej neve, po ka mujt me i ditë edhe më  
2 përpara. Prandaj unë e pata si sugjestion, që ti i ke pasë  
3 këtu edhe më përpara. Prite me na viktimizu ne e me i qit.  
4 Mbasi se ke kan qashtu. Kaq.

5 Py. Zoti Haradinaj, a i thatë këtij gazetari që nuk e kishte  
6 guximin me i publiku dokumentet? Me "po" ose me "jo" mund të  
7 përgjigjeni.

8 Pë. Përsërite edhe njëherë pyetjen, të lutem.

9 Py. A i thatë këtij gazetari që nuk e kishte guximin t'i  
10 publikonte dokumentet?

11 Pë. Jo. Edhe pse ti beson nuk kupton sepse ky e ka pasë  
12 guximin, ky i ka publiku.

13 Py. Po pse i thatë që nuk e kishte atëherë?

14 Pë. I thashë në momentin ku ai tentoi tash me vazhdu unë me i  
15 publiku. Dhe prandaj i thashë, ti tash s'e ke guximin, njëherë  
16 e pat. Tashti dashti guximin e tij me ma dhënë mu trimninë e  
17 tij. Trimnia e tij mu nuk më bien në themër të komës. Po  
18 dinakëria e tij mundet me kanë më e madhe se e jemja.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Ajo të tregoj një tjetër video.

20 I AKUZUARI HARADINAJ: Më falni. Zoti Prokuror, a kuptuat  
21 çka thashë? Ku ai u mundu me ma jep këtë trimni mu e me thënë  
22 vetë unë nuk guxoj, i thashë po ti nuk guxon s'e ke guximin  
23 sepse isistojke unë me i qit. Prandaj këtë kuptim e ka ajo ti  
24 nuk e ke guximin. Sepse ai e ka qit.

25 Z. HALLING: [Përkthim] E kuptova interpretimin tuaj.

1 I AKUZUARI HARADINAJ: Ju faleminderit.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Dua t'ju tregoj një video tjetër.

3 Është P35, 08213601, me vulë kohore 12:58 deri në 13:23. Është  
4 faqja 5 në transkriptin anglisht. Fillon me fjalët "po e bëjmë  
5 për median" dhe përfundon "pra edhe po jua tregojmë këtu  
6 juve".

7 [Luhet videoincizimi]

8 Z. HALLING: [Përkthim]

9 Py. Zoti Haradinaj, pse gazetarët që nuk i publikojnë  
10 dokumentet janë të dobët?

11 Pë. Jo, jo. Ky a mendim i yti. Unë saktësisht krejt çka kam  
12 thënë po e pranoj. Se kam thënë dhe e sheh këtu po i them po  
13 mundohemi -- këtu është insistimi i gazetarëve ku insistonin  
14 na me i publiku. Në këtë prizëm. Dhe për me i publiku, me pat  
15 dashtë na me i publiku me e pasë atë aftësi ndoshta dhe e  
16 kishim bo. Mediat janë forca e katërt e një shteti dhe unë i  
17 respektoj sikur respektoj shtetin tim, çdo shtyllë. Kaq besoj  
18 që e din edhe ti. Dhe ka qenë në dorën e tyre çka, sa, tek.  
19 Dhe këta insistun me i qit na. Dhe për këtë i them. Unë me pat  
20 dashtë me i publiku i kisha publiku. Do të thotë, kjo  
21 domethënë, s'ka s'po du me i publiku unë. Ti je forca e katër  
22 e shtetit, ti vendos. Kaq.

23 Py. A po e mohoni që i keni quajtur të dobët, të pafuqishëm  
24 këta gazetarë që nuk i publikojnë dokumentet?

25 Pë. Për mua, çdo gazetar që e ka një përgjegjësi të interesit

1 publik dhe nuk a një gjendje me dit çka duhet me publiku e çka  
2 s'duhet me u publiku e me ju drejtu një organizate të  
3 veteranëve që ata me i bo, për mua është i dobët, i paaftë ose  
4 është, s'po du me mendu që kanë me pasë atë mendim, qëllimkeq  
5 dhe kurthaxhi, me të shti në kurth. Mund të ketë edhe gazetarë  
6 të paaftë. Prandaj e kam mendu unë që janë të dobët në  
7 kuptimin që nuk janë të zotët për detyrën e tyre. S'ka këtu të  
8 bëj me guximin a me i qit a mos me i qit. Ka të bëjë me  
9 guximin e vlerësimit të punës vet.

10 Unë kam mujt me vlerësu, ndoshta gabimisht, që më ka bërë i  
11 mirë që e kam bërë për hir të transparencës dhe interesit  
12 publik, por e kam marrë një vlerësim temin dhe kam mendu dhe e  
13 kam vlerësu dhe e kam bërë qashtu. Dhe po i qëndroj asaj tash.  
14 Dhe nuk kam kërku unë me shku me ja shti tash dikuj tjetër le  
15 ti qet ai. S'a kanë pafytyrësi e jemja. Më kanë ardhë mu. I  
16 kam lajmëru unë. Aty anej, është guxim, aftësi, zgjuarsia,  
17 dijeni se çka bojnë ata me këto dokument. S'a kanë më  
18 kompetencë e jemja.

19 Py. Pra, kur media nuk i publikoj dokumentet që ishin venë në  
20 dispozicion s'po e bënin punën e tyre, këtë po doni të  
21 dëshmoni?

22 Pë. Jo. Do na dëshmonin -- doja të të dëshmonin se po na  
23 ngarkojnë ne me punën e tyre padrejtsisht. Jo. Nuk e kam  
24 thënë po e bojnë a s'po e bojnë punën e tyre. Se po ta dija  
25 cila është e cila s'a puna e tyre dhe po ta kisha atë aftësi

1 unë isha gazetar. S'është ashtu. E kam dëshmu që po dojnë me  
2 na imponu diçka ne çka ata po thojnë vetë s'bon. Keq. Dhe në  
3 bazë të këtij kuptimi, s'e kanë bo. Por jo me na akuzu ne e me  
4 na detyru neve pse s'me i bo. Unë në çështje dhe në  
5 kompetencat e plota të tyne, të vullnetit, dëshirës dhe dijes  
6 dhe kompetencave të tyne krejtësisht pas tregimit që ato janë  
7 këtu. Aty e tutje është përgjyesi kompetencë krejt e tyne. Nuk  
8 e kam me i ngarku, po është e vërtetë një realitet. Se e kanë  
9 zanatin për qat punë.

10 Py. Zoti Haradinaj, ju u përgjigjët edhe kështu edhe ashtu  
11 pyetjes. T'jua bëj edhe njëherë pyetjen dhe përgjigju me "po"  
12 ose me "jo". Kur mediat nuk i publikuan dokumentet që ju vunë  
13 në dispozicion, nuk po bënë punën; kështu doni të thoni?

14 Pë. Jo. S'e kam fjalën këtu që s'po e boni punën. Ata e kanë  
15 bo punën e tyne. Dhe s'kam unë kompetenca dhe nuk muj e  
16 vlerësoj apo e bojnë apo s'po e bojnë. Nuk e kam pasë atë  
17 kompetencë. Është gabim nëse unë e vlerësoj a kanë bo mirë  
18 punën a s'e bojnë mirë kur s'di kurrëgjë në gazetari. Me çfarë  
19 kompetence do t'u kisha drejtu unë? Duhet me kanë i çmendur me  
20 ju drejtu një profesionalisti një njeri që s'është që s'ka të  
21 bojë gjë me gazetari dhe me i kallzu unë atij a po e bën a  
22 s'po e bën punën. Ai e ka bo punën, sa e ka pa të arsyeshme  
23 dhe në rregull është. Edhe ta merr në përgjegjësi të vet nëse  
24 ka përgjegjësi.

25 Py. Konferencat për shtyp në të cilat OVL-ja thirri mediat.

1 OVL-ja i organizoi këto konferenca për shtyp me mendjen e vet  
2 apo jo? Me pëlqimin e vet.

3 Pë. Po.

4 Py. Dhe Organizata e Veteranëve të Luftës, përfshirë dhe ju  
5 vetë, ishin të kënaqur që i morën këto -- që iu erdhën këto  
6 dokumentet?

7 Pë. Organizata e Veteranëve të Luftës ishin të kënaqur që  
8 prezantun ato çka ju ka ardhë. Që hekën barrën e vet prej  
9 vetit. Aty e tutje s'ka pasë rëndësi për ne se çka bohet.  
10 Sepse ne nuk e kemi dit as çka do të bojnë gazetarët, as si do  
11 të reagojnë gazetarët. Për ne mision, qëllimi ynë kryesor ka  
12 qenë vetëm me tregu dhe me qenë transparent me të gjithë çka  
13 na ka ndodhë ne në organizatë. Kaq.

14 Py. Dhe thatë se do të mirëprisnit edhe herët e tjera kur t'i  
15 sillnin; kështu?

16 Pë. Kënd?

17 Py. A nuk thatë aso kohe, pra, gjatë shtatorit të vitit 2020  
18 nuk thatë që do të mirëprisnit edhe kur t'ju sillnin prapë,  
19 t'ju dorëzonin prapë; kështu?

20 Pë. Më kujtohet mirë kjo. E ke dhe me video dhe nëse e këqyrë  
21 mirë, prapë po them zoti Prokuror, ose je ka don me ja ndryshu  
22 mendimin fjalës time, se ajo ashtu është e thënë, por kjo  
23 është një drejtim publik personit qoka i bjen aty, që bin ai  
24 sa dush se na kemi qit qatu. Na kemi tregu këto. Ne këto e  
25 bëjmë. Prandaj, ne ka herë kur dikush thotë apo don me u

1 rrehë, po ta jap si shanc, ti s'don. [E pakuptueshme] i tha  
2 po, i thu po kur dush. Ne kemi mendu që ajo a tu na provoku.  
3 Ka mujt me ardhë edhe i pamaskum dhe kjo ka qenë drejtim me ju  
4 drejtua tinaj sepse ai me siguri edhe a kanë tuj e ngu, si na  
5 sa të bish i qesim. Do të thotë, nuk na dëmton neve. Kët  
6 kuptim e kam pasë. Nuk kërkon thirrje për me pru prapë. Po a  
7 kanë thirrje me i kallëzu si ti me këto ne s'na dëmton send.  
8 Bir sa dush edhe të mirëpresim.

9 Py. Thatë, kujtonit se nuk ju dëmtonte, pra, e dinit që nuk  
10 ishte kurth; kështu?

11 Pë. Jo. Përkundrazi. Ne dyshum që a kurth dhe i tham bjer sa  
12 të dush se ne nuk biem në kurthin tuaj. Në këtë kuptim e ka  
13 pasë ajo fjalë. Këtë kuptim e ka atë fjalë ku unë i drejtojna.  
14 Se kjo është drejtimi në mënyrë alegorike i dhënies së  
15 mesazhit që atij që me siguri ai kujna i ka pru edhe tuj i  
16 këqyrë shka ka bohet. Kështu, të bien sa don. Se unë s'muj i  
17 ndali, hiç. Nëse do dikush me i pru ashtu, ne s'po i ndalim.  
18 Ne nuk kem do roje askush që e run objektin tonë. As nuk ka  
19 nevojë në Organizatën e Veteranëve të Luftës me hi dikush me  
20 identifiku. Është e hapur për krejt popullin, për të gjithë.

21 Py. Kur mendonit që nuk ju dëmtonte, si mund të ishte kurth  
22 kjo?

23 Pë. Po insistimet e këtyre që me i qit na, nuk arritën te na.  
24 Prandaj s'i qitëm na. S'i shpërndam na. Se insistimi ka qenë  
25 pej vetë gazetarëve me i qit na. Më kanë thirr njerëz në

1 telefon, "A ma ki bre mo qasi se unë i qes". I kam thënë "Në  
2 ndaç me i marrë janë atje kur të vij në s'ka më". Unë s'kam.  
3 Nuk i mbaroj ato. Mundem me i ndëgjju ato në telefon temin ku i  
4 keni marrë dhe këqyrni, i shihni përgjigjet e mia te ata.  
5 Py. Zoti Haradinaj, gjatë dorëzimit të këtyre materialeve ju  
6 e kuptuat që nuk ishte kurth apo jo?

7 Pë. Unë hala s'e kam kuptu deri tash se a asht kurth a s'a  
8 kurth. Unë edhe tash e kam të paqartë. Bile për qat herë ma  
9 shumë jam ka binda që bash a kurth dhe pikërisht prej juve.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë a mund t'i kërkoj  
11 Sekretare që të vendos në ekran provën P17. Numri 08197905,  
12 pra, numri ERN i provës. Është vula kohore 11:44 deri 12:28.  
13 Në transkriptin në anglisht është dokumenti P17-ETRED, faqja  
14 5. Fragmenti fillon "Besoj që prisni edhe materiale tjera" dhe  
15 përfundon me fjalët "Është i mirëseardhur për ne".

16 [Luhet videoincizimi]

17 Z. HALLING: [Përkthim]

18 Py. Zoti Haradinaj, nuk ishte më kurth, a nuk po e thoni këtë  
19 në këtë fragment?

20 Pë. Jo. Jam tuj e qit, jam tuj e mundu në aspektin tim me i  
21 qit unë ato në kurth. Ai që po i bien. Unë kam qenë kurioz.  
22 Jam kurioz edhe sot me i njoft. Prandaj po i them je i  
23 mirëseardhur. Po pres mos po vjen me mi dhënë. Bile e kam një  
24 intervistë, po më vjen keq që s'e paske marrë nëse të vyn, ku  
25 i them i bëj thirrje të më thirrë në telefon dal e ia marrë.



1 Po ta jap edhe këtë shembull ty se ndoshta të ka ik me i marr  
2 ti. Arsyeja ka qenë me e njoft kush a. S'ka këtu të bëj  
3 kurrëgjë me atë.

4 Dhe qe sa mirë dul këtu letra, që më para e diskutova, ku  
5 ma bien Fatoni, qatë letër që ti pak ma qite ma vonë. E sheh?  
6 Qe ku ma dha. Që u pa këtu në fund. Atë letër që më thoshe jo  
7 autorizim, jo pa autorizim.

8 Py. Kurthi për të cilin ju po shqetësoni këtë dokument ishte  
9 kurthi se këto dokumente nuk ishin origjinale, autentike; a  
10 është kjo e saktë?

11 Pë. Të lutem, përsëritma edhe njëherë se nuk e ndëgjova mirë.

12 Py. Kurthi për të cilin bëni fjalë në këtë video, për të  
13 cilin jeni të shqetësuar ishte kurthi se këto dokumente nuk  
14 ishin autentike; a është kjo e saktë?

15 Pë. Këtu e thashë qartë edhe njëherë që ai njerit s'u kam  
16 besu në fillim. Dhe pastaj, e ceka, që na detyroj, fillim me i  
17 besu se ku thojke i bi, i pruni. Kështu që unë tash atij i  
18 bëj, me mendjen time, dua t'ia bëj publik një kurth që të vijë  
19 ai i mirëpritun vetëm për me e njoftë kush ashtë. Dhe këtu kam  
20 luajte me fjalët herë origjinal, herë paorigjinal se nuk e kam  
21 dit si i konvenon atij që me ja fitu besimin. Kështu që s'ka  
22 kurrëgjë këtu tjetër. Këto i kam thënë. Ky a qëllimi që i kam  
23 thënë. Dhe unë po të them ende jam i interesun me e njoftë,  
24 për kuriozitet.

25 Py. Pra, kur thoni se doli që është origjinal atëherë po luni

1 me fjalë këtu?

2 Pë. Jam tuj lujt me fjalë për dërguesin. Se nuk e e dijsa  
3 qysh i konvenon. Dojsa me i fitu besimin e tij edhe po e them  
4 me të vërtetë kam pasë qejf me më thirrë unë i isha dalë vetë  
5 e me i njoftë kush është.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Videoja që do ta luajmë tani është  
7 me numër P18, 08197907, vula kohore 30:29 deri në 31:01. Dhe  
8 është faqja 6 deri në faqen 7 e dokumentit P18-ETRED në  
9 anglisht. Fragmenti fillon me fjalën "Gjatë kohës që punoja  
10 atje dhe munda t'i merrja" dhe përfundon me fjalët "Është  
11 materiali e tyre".

12 Py. Zoti Haradinaj, mbasi ta shikojmë videon do t'ju bëj një  
13 pyetje.

14 [Luhet videoincizimi]

15 Z. HALLING: [Përkthim] Ndoshta është një problem me vulat  
16 kohore si janë të vendosura në transkript.

17 Py. Pra, këtë desha t'jua parashtroj ju:

18 "Pse unë punova aty me i marrë këto. Unë më vjen keq dhe  
19 kërkoj falje publikisht nëse kam nxjerrë diçka që nuk ka qenë  
20 aty sepse është e mundur. Shiko, kur i kemi bërë dorëzimin e  
21 parë kemi menduar dy-tre orë, tre-katër apo më shumë. Menduam.  
22 Pse? Jemi frigu mos na i ka pru dikush me na mashtruar me  
23 thënë ky është material i Hagës dhe disa letra me u bo horr,  
24 siç ma bënë, s'po du me përmend, po jo është materiali i tyre.  
25 Është materiali i tyre".

1           Zoti Haradinaj, edhe këtu është luajtje me fjalë edhe kjo  
2 pjesë?

3 Pë. Asnjë luajtje me fjalë këtu s'është. Këtu është saktë çka  
4 u a thanë edhe ju deri tash. Do të thotë, po kallëzoj që jam  
5 kanë i sulmun që ne jam tue bo materialin. Po kallëzoj që janë  
6 mundu me na bo horr, do të thotë, është horr, fjala horr  
7 domethënë me turpnu. Po të kallëzoj që kët material unë s'e  
8 kam marrë në Hagë. S'a përgjesi e jemja. Kështu që send s'ka  
9 të bëj me ne kjo punë. Këtë qet fjalë qat kam folë qetu sesi  
10 ti don me i kuptu tjetër gjë. Unë qetu jam ka i përsëriti pej  
11 djeshit edhe jo prej djeshit po prej si kam dalë në Panel.  
12 S'kam unë përgjesi.

13           Se këtu nëse ndjek ma i hollë e shihet. Dun me më fajësu  
14 mua për ardhjen e atyre dokumenteve. Po, nëse kam faj unë, kam  
15 faj që ata çka po thotë që e kam bo qat veprim që e kam marrë  
16 prej qaty qaty. Nëse ajo a faj, po e paskam bo faj. Pranoj.  
17 Unë kam dashtë mos me ardhë diçka në organizatën tonë që  
18 pastaj me u kumentu e mos me komentu ato.

19           E dyta, unë them nuk di çka ka pasë aty. As ai s'e di. S'e  
20 di unë se çka ka pasë aty brenda. E ki aty po thotë. Nuk e  
21 dimë. Edhe këtu e tregoj pasigurinë ndaj asaj sende. Këtu po  
22 shihet që jam i pasigurt. Jemi të pasigurt. Ka qenë, kupto  
23 zoti Prokuror, ka qenë një presion ose ti e din presion se  
24 mund ta keni bo vetë ose po ju përgëzoj nëse keni pasë ju me i  
25 bo presion që keni bo mjaft. Mjaft keni bo presion. Na keni

1 lodh me skandale që na i keni iniciu i keni bo.

2 Py. Keni pasë frikë se dikush mund t'ju sjellë material që do  
3 të mund t'ju mashtrojë dhe pastaj thoni po ky është material i  
4 tyne. Atëherë, pse thoni ky është material i tyne në përgjigje  
5 të frikës që keni pasë?

6 Pë. E shpjegova dhe njëherë, ne jemi sulmu prej mediave  
7 publikisht që e ke maru vetë. Fjala "e tyne" është emër i  
8 përgjithshëm, është shumë. "I tyne" i bien sikur me thonë i  
9 çdokujt, i kujdo, vetëm i joni nuk ka qenë. Ne na kanë akuzu,  
10 po them, ne na kanë akuzu që ke shku e ke marrë në Serbi. Ka  
11 thënë media në publik. Nuk më kanë thënë çka kanë mendu  
12 njerëz. Çka kanë deklaruar. Politika na ka çmend. Secila parti  
13 për vete, qysh i konvenojke.

14 Nëse dikuj njënës parti i konvenojke që jemi na kanë  
15 quajtur argatë të Thaçit. Nëse dikujt tjetër i ka konvenu  
16 argatë të Rugovës. Tjetrit i ka konvenu politikisht argatë të  
17 Ramush Haradinut. Tjetrit i ka konvenu politikisht argatë të  
18 Hashim Thaçit. Kështu na jemi kanë të sulmun mediakisht,  
19 mediatikisht dhe publikisht. I vetmi target në Kosovë mbas që  
20 na i keni prurë qeto, jemi kanë na, nga të gjithë edhe nga  
21 politika.

22 Py. Ju sapo thatë: "Na akuzuan që shkojmë në Serbi për t'i  
23 marrë ato dokumente". Po sikur të kishit shkuar në Serbi për  
24 t'i marrë ato dokumente, a do të ish kjo gabim, diçka e  
25 gabueshme?

1 Pë. Unë ma së pari nuk kam nevojë me shku edhe me punu me  
2 organe serbe e me njerëz të cilët po shihet këtu kanë qas  
3 Serbi të cilët kanë ekzistuar, kanë vra, kanë [e pakuptueshme]  
4 të popullit tim. Në asnjë mënyrë. Asnjë interes. Sepse do  
5 tregoj diçka. Kurrë ata s'do kishin pranuar me pasë besim në mu.  
6 Ata besoj që kanë të njëjtin besim në mu, sikur e kam unë në  
7 ta. Pra, mosbesim reciprok kemi. Edhe kem arsye me pas  
8 mosbesim reciprok, sepse i konsideroj armiq këtë pjesë dhe  
9 këta emna që i ke ti këtu, edhe të mitë edhe të popullit tim.  
10 E besoj që në fund kanë me përfunduar edhe armiq të juve, sepse  
11 kanë me ju shti me ku i marrësh që shënime, nuk ke me mujt  
12 para një gjykate nëse a drejtë me i dëshmuar qeto shka ai ka  
13 thu.

14 Kështu që unë nuk bashkëpunoj me serbë për këto sende dhe  
15 nuk a kjo lami që unë u du me bashkëpunu. Po të isha unë  
16 koordinator i juve, po të isha, që ju koordinator s'keni  
17 kurrgjë, unë do të kisha koordinuar me ju e jo me ata. Por kisha  
18 kërkua që ju me kanë të haptë e transparent me tregu me kënd po  
19 bashkëpunoni, jo pasandaj me dalë. Dhe ky bashkëpunim i juvi  
20 me serbët nuk ka dalë për juve, u ka dalë vetëm njënjën e keni  
21 përmendur Vukçeviçin, ka dalë prej vetë këtyne njerëzve bre.  
22 Prej vetë këtyne bre, që i kishit tu që janë të shkrunë. Vetë  
23 bre kanë deklaruar. Edhe hin mirë, e kanë deklaruar tri-katër vjet  
24 pa ndodhë që kjo. I kanë paraprirë që saj. Dhe unë i ngjoh  
25 meqenëse janë njerëz të juv, unë i llogaritë që është punë e

1 juja.

2 Py. Bashkëpunimi me Serbinë do të jetë çdo herë i gabuar  
3 sepse ata janë armiqtë e juj. A është kjo ajo që besoni ju?

4 Pë. Jo. Ky është mendimi i yti, që ti po e formulon. Unë,  
5 nëse ju kujtohet mirë, nxerre procesverbalin, e thashë populli  
6 serbo nuk mund të jetë popull armik i imi. Vukçeviçi dhe  
7 shokët e tij që kanë kry vrasje, që kanë vra, që kanë urdhru  
8 këta janë armiqtë e mi. Jo populli serb. Dhe nëse doni me kanë  
9 të singertë, po dhe Gjykata, hiç ma larg se dje jua kam thënë  
10 që dje ju kam thënë të njëjtat këto. Nuk fajësoj një popull.  
11 Fajësoj politikën, regjimin e Millosheviçit dhe njerëzit e  
12 Millosheviçit me të cilët ju i keni bashkëpunëtorët kryesor  
13 dhe e pranon vetë që i keni. Dhe koordinator. Kaq.

14 Po. Dyshi. Armik i jemi i popullit tim. Edhe rend hijnu  
15 këtyne. Çka i njoh kësi si emra se tash gjithë tjerët. Po. Po  
16 armik i popullit tim ka qenë edhe ky shqiptari këtu që i ka  
17 vra shqiptarët. Së bashku a mobilizu e ka vra kojshinë e vet.  
18 Se nuk e ka vra për kojshi e ka vra për hir të serbëve që i  
19 kanë dhënë urdhër dhe me u tregu që është i besushëm i tyne.

20 Prandaj, mos ma inpononi që unë mendoj dhe që unë e  
21 kuptoj lufta ka qenë, ka përfundu. Ne duhet me vazhdu  
22 fqinjësisë e mirë por duhet me ndryshu qëndrimi i Serbisë.

23 Dhe fatkeqësisht, qëndrimi i Serbisë dhe qeverisë serbe  
24 sot për sot dhe njerëzve me të cilët ju i keni falenderu dhe  
25 mburrni që kanë bonë punë të mirë për ju, mendojnë ende si

1 Millosheviçi. Nuk e kanë ndryshu mendjen. Këta janë armiku i  
2 popullit tim dhe çdokush që është armiku i popullit tim është  
3 edhe armiku im. Këtë ne e kemi betim familjar, nuk jam veç  
4 unë. Pesë breza e kem kështu.

5 Py. Dhe derisa Serbia ta ndryshojë qëndrimin e vet  
6 bashkëpunimi me qeverinë e Serbisë do të ishte i gabuar; a  
7 është e saktë? Ky është qëndrimi juaj?

8 Pë. Jo. Nëse e ndërron qëndrimin ndaj Kosovës bashkëpunimi  
9 pse mos me kanë. Ne jemi fqinjë. Ne duhet me jetu bashkë. Unë  
10 e kuptoj paqen. Pas çdo lufte vjen paqja. Normale është.  
11 Serbia, thashë, nuk ka ndërru qëndrim as sot. E ki haptas. E  
12 ki publikisht. Po ka i kërcënon marrëveshjet, ka i mohon  
13 masakrat që janë cilësu nga bota jo nga ne për me arsytu  
14 pastaj ata me thënë armiqt tanë. Dhe qata njerëz që i kanë bo  
15 qito masakra, qata njerëz që kanë ende qët qëndrim që kanë  
16 qenë nxënës të Millosheviçit, që kanë qenë urdhërzbatues të  
17 Millosheviçit, ju i keni koordinator dhe e keni falenderu për  
18 punën e zellshme që ka bo. Dhe ky s'ka qenë një ka -- nuk po e  
19 fajësoj veç pse ka qenë, ky ende e mban qët qëndrim kundaj  
20 nesh.

21 Në moment që Serbia e kupton që njerëzit duhet të jetojnë  
22 të lirë, unë mendoj që ajo ma së pari i ndihmon vetes dhe ju  
23 ndihmon edhe fqinjëve. Dhe çka ka këtu. Ne kemi lufta 100-  
24 vjeçare gjermano-franzeze-suedeze si edhe paqja duhet të  
25 mbërrij. Edhe luftat bëhen njëna palë e bon për aspektin e

1 paqes, lirisë, tjetra e bën për aspektin e uzurpimit,  
2 nënshtrimit. Prandaj luftërat kur kanë një përfundim siç e  
3 kanë pasë lufta e Kosovës që është mbështetë nga 100 e ca  
4 shtete, asht shpall një pavarësi, unë e mendoj se duhet me  
5 reflektu të dy qeveritë e pasi paqe. Pse jo? Populli don paqe.  
6 Populli don liri. Nga dhuna askush s'ka përfitu. S'kemi  
7 përfitu as na në luftë, po ka qenë e imponueshme.  
8 Py. Zoti Haradinaj, dërgesat që mbërrijnë në zyrat e OVL UÇK-  
9 së a e vëndun në rrezik OVL UÇK-në?  
10 Pë. Po ti shkon vitit 1981 deri në fillimet e luftës ose deri  
11 në krymjen e luftës --  
12 Py. Zoti Haradinaj, nuk dua të kthehem në vitet 1981. Dua  
13 vetëm të di në qoftë se këto dërgesa ju vendosën në një  
14 rrezik?  
15 Pë. Ani ti mos u kthe në 1981, unë po i kallëzoj arsyet qysh  
16 e vlerësoj. Po të kishte ndodhë kjo në viti 1981 dhe deri jemi  
17 çliru, kisha kuptu që mundet me kanë e mirë sepse ka qenë  
18 ilegalja dhe u punu tinëz organeve serbe. Ndërsa në një shtet  
19 të pavarur, s'di sa vjet, me demokraci të hapur, në çdo gjë të  
20 hapun të vjen diçka ilegale për mu është e dyshimtë për të  
21 keq. Prandaj për mu gjithmonë ka qenë e dyshimtë kjo. Pse në  
22 këtë kohë duhet me ardhë diçka ilegalisht?  
23 Thashë, prandaj ta përmenda 1981 po të kish ndodhë prej  
24 asaj kohe deri në atë kohë kisha mendu që duhet të na vij. Në  
25 shtet të çlirun, demokratik, pse me na ardhë ilegale? Pse?



1 Pra, dhe prandaj dhe për mu ka qenë e dyshimtë pej formës së  
2 dërgesës.

3 Py. Në qoftë se e keni ditë që e keni marrë në mënyrë  
4 ilegale, atëherë pse nuk e thirrët policinë dhe t'ia kthenit  
5 policisë t'ia jepnit policisë?

6 Pë. Ku e bëne ti këtë konstatim se s'e kam thirrë policinë?  
7 Unë kët 16 muaj që u kam mban ti këtu, unë jam ka të kallëzoj  
8 që e kam thirrë policinë. Trego ti pse e ke ndalë policinë ose  
9 të ma shpjegon dëshmitari yt 1 pse më ka thënë nuk guxojnë ata  
10 me ardhë hiç? Që unë e kam ndi për ofendim ndaj shtetit tem që  
11 ma ka bo.

12 Py. Dhomat e Specializuara të Kosovës janë Gjykata e Kosovës,  
13 atëherë pse nuk i keni kontakti punonjësit e ZPS-së apo  
14 policinë e ZPS-së për t'ua kthy, dhënë ato dokumente atyne?

15 Pë. Kush janë Gjykatë e Kosovës?

16 Py. Gjykata para të cilës je duke qëndruar.

17 Pë. Unë po shpresoj që Gjykata të jetë, po Prokuroria dhe  
18 Prokurori Special me asnjë send s'ka dëshmu që e ka me të  
19 vërtetë për ime punën. Po ka punon për një pjesë të Kosovës,  
20 po jo për të gjithë. Për Gjykatë po shpresoj edhe uroj që të  
21 jetë. Dhe s'kam dyshim sepse s'besoj që këta juristë do të  
22 vijnë në këtë nivel nëse nuk kanë imponim. Ne ju kemi afru.  
23 Nuk keni dashtë me punu me ne. S'na keni lënë qasje me pasë  
24 drejtë na ju me ju thirrë. Nuk ke ardhë me bisedu me ne  
25 asnjëherë. Ose vetëm desh me ma coll njëherë, që ju keni kërku

1 me bisedu me ne dhe ne ju kemi refuzu. Nëse veç njëherë ka  
2 ndodhë, tash po flasë për pjesën sa unë kam qenë këtu ose mu  
3 personalisht. Të lirë jeni kanë me ardhë.

4 Jeni ardhë tri herë, kur ju ka dashtë jeni ardhë tri herë  
5 përfaqësusi juve. E kam pritë mirë, i kam qit kafe, ndejtë  
6 mirë, s'ka ofendu kërrkush kërrkënd. Ka marrë punën e vet e ka  
7 kry, ka shku. Pa marrë parasysh mendimet që na i kemi pasë se  
8 çka duhet me u përmirësu. Kështu që këtu është faji i juj dhe  
9 nëse vazhdoni kështu, kështu keni -- kësi marrëdhëniesh ju i  
10 keni ndërto, nuk i kem ndërto na. Ju e keni ndërto këtë  
11 relacion.

12 Py. Zoti Haradinaj, do ta luaj edhe një video përpara  
13 pushimit. Është në lidhje me atë që ju e përshkruani se çfarë  
14 ju tha ZPS-ja me 22 shtator 2020.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Është prova P30, 08210603, 09:06  
16 vula kohore 09:36, P30-ET në anglisht, faqja 9. Dhe fragmenti  
17 fillon me "Ne kemi folur me avokatin" dhe përfundon me fjalët  
18 "Ka rrjedhur nga Dhomat".

19 [Luhet videoincizimi]

20 Z. HALLING: [Përkthim] Ju faleminderit përkthyesve.

21 Py. Zoti Haradinaj, ZPS-ja ka thënë që duhet të jenë të parët  
22 që duhet të njoftohen dhe këtë po e thoni ju në këtë fragment;  
23 a nuk është kështu?

24 Pë. Këtë çështje e kam dikutu edhe dje. Dhe kam thënë, krejt  
25 çka na ka thënë oficeri juve ne kemi bo. Ai na ka thënë se

1 "Është mirë me na lajmëru ne ma së pari" dhe nuk po e mohoj.  
2 Unë i kam thënë atij "Ne jemi tuj u lajmëru përmes medias  
3 sukur po i lajmërojmë të gjithë". Ne asnjë medie s'e kemi  
4 thirrë me telefon. Dhe ju po e dini njëjtë ku po e dinë të  
5 gjithë e ty tash këtu po të them, ata kanë pasë kohë me ardhë  
6 një orë para mediave. Prej qendrës ku ata punojnë prej neve  
7 s'a larg e kanë ndërtesën ku na punojmë. Kaq. Që kaq. Ne kemi  
8 bo saktë ça na kanë thënë. Mos me i shpërnda, a fjala me i  
9 publiku na. Mos me i shtyp. Mos me i kopju. Mos me bo kopje.  
10 Asnjë si kem bo. Këta na i ka thënë oficeri juv. Këta e kemi  
11 zbatu edhe pse s'i kem premtu hiç, po e kemi zbatu. Pse mos me  
12 i zbatu? Se e vërteta ishte as e kishim ndërmend me bo diçka  
13 tillë.  
14 Py. Por nuk e keni njoftu të parën, apo jo?  
15 Pë. Po nuk keni dashtë me bo ju relacione me ne që na me ju  
16 njoftu ju? Ju na keni neglizhu, ju na keni injoru edhe ne edhe  
17 veteranët edhe popullin tonë. S'ke dashë zotni. Nuk ke pasë  
18 interes me neve me fol. Derën e ke pasë çel. Pse s'ke urdhnu?  
19 Unë s'isha taku kurrë me ty qosheve e maleve e skutave qysh je  
20 mësu me i marrë disa tjerë që kanë lajmëru veteranët që të kam  
21 tregu këtu. Por zyrtarisht edhe sot je i mirëseardhur në zyrë  
22 të re, qysh shkon në Organizata e Veteranëve të presin.  
23 Bisedojnë me ty.

24 Normal, nëse kanë pakënaqësitë e veta që mendojnë kanë me  
25 ti thënë, po ajo asht njerëzore dhe unë mendoj që është shumë

1 njerëzore. Ai t'i thotë pakënaqësitë e veta. Ti i merr ose s'i  
2 merr në konsideratë. Ti s'e ke provu këtë. Askush nga  
3 oficerëve tu s'e ka provu këtë. Prandaj, këto veshnja vetit.  
4 Këtë meritë ose mosmeritë është e jotja. Kur them e jotja jam  
5 ka mendojnë krejt kolegët tuj, shefin tënd e krejt çka i ki.  
6 Py. Zoti Haradinaj, ju nuk e njoftuat ZPS-në [për] të parën  
7 sepse deshët që këto dokumente t'ia vendonit në dispozicion  
8 mediave përpara që ato t'i merrte ZPS-ja; a është kjo e saktë?  
9 Pë. S'është e saktë. Shumë e pavërtetë. Bile është spekulim i  
10 yti.

11 Py. Deshët që të provoni se ZPS-ja nuk mund t'i mbronte  
12 dëshmitarët; a është kjo e saktë?

13 Pë. Shumë e pasaktë. Mendimi i yti.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Mund ta marrim tash pushimin e  
15 drekës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta marrim  
17 pushimin.

18 Zoti Cadman, a keni diçka për të ngritur?

19 Z. CADMAN: [Përkthim] Një çështje të shkurtër që duhet ta  
20 bëjmë sot pasdite dhe kërkojmë udhëzimin tuaj në lidhje me  
21 dëshmitarin, që varësisht nga se kur do të përfundojmë me zoti  
22 Haradinaj, duhet të vijë nesër. Duhet të bëhen disa ndryshime  
23 të deklaratës. Ne mund ta ndryshojmë deklaratën në bazë të  
24 udhëzimeve të dëshmitarit dhe pastaj të bëjmë dorëzimin e  
25 deklaratës apo ta lëmë ashtu sikurse është e dorëzuar në

1 sistem dhe ndryshimet t'ua bëjmë të njohura me email.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'ju  
3 njoftojmë më vonë për vendimin tonë.

4 Tani e mbyllim deri në orën 14:30.

5 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.01

6 --- Seanca rifillon në orën 14.30 pasdite

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për  
8 procesverbalin, në përputhje me rregullin 68(4) të Rregullores  
9 e zhvillojmë këtë seancë në mungesë të zotit Gucati dhe i  
10 cili, përmes avokatit të tij, ka hequr dorë në mënyrë të qartë  
11 dhe vullnetare nga e drejta për të qenë i pranishëm në proces.  
12 Zoti Gucati përfaqësohet nga avokati i tij në sallë.

13 Zoti Cadman, lidhur me pyetjen tuaj sa i takon deklaratës  
14 së Dëshmitarit me numër 1246. Trupi Gjykues dëshiron që ju të  
15 përgatisni një shtojcë, ku renditen ndryshimet dhe t'i kërkon  
16 dëshmitarit ta nënshkruajë këtë shtojcë dhe kur dëshmitari të  
17 jetë këtu mund ta pyesni për deklaratën dhe për ndryshimet.  
18 Është e njëjta procedurë që kemi ndjekur me Dëshmitarin 4841.

19 Keni diçka për të përmendur? Besoj keni ndonjë  
20 kundërshtim?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtimi ynë do të jetë për  
22 paragrafët nga 20 deri në 22.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 20 deri në 22  
24 përfshirë dhe 22?

25 Z. HALLING: [Përkthim] Po, këto tre paragrafë.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Pasi kemi diskutuar çështjen me  
2 zonjën Bolici dhe zotin Halling, ne kemi kundërshtim për këto  
3 tre paragrafë 20-22, me përjashtim të fjalisë së fundit të  
4 paragrafit 22.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [E  
6 padëgjueshme].

7 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
9 Zoti Halling, mund të vazhdoni.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.  
11 Py. Zoti Haradinaj, dua të sqaroj diçka për të cilën po  
12 diskutonim nga fundi i sesionit të fundit, përmendët që e  
13 thirrët policinë kosovare pasi u dorëzuan dokumentet në OVL.  
14 Ju e thirrët policinë para apo pas konferencave për shtyp?  
15 Pë. Zoti Prokuror, as Policia e Kosovës, sa mediat dhe as ju,  
16 si Gjykatë, nuk keni kanë të anashkaluar. Të gjithë jeni  
17 thirrë në të njëjtën mënyrë. Kështu që ashtu qysh kam bo për  
18 policinë që e kam konsideru të vendin tim edhe për ju, ju kam  
19 njoftu vetëm me anë të mediave. Ne te Policia e Kosovës kemi  
20 kërku me na mbrojt me shkrim. Ndërsa thirrjet për Policinë e  
21 Kosovës dhe Gjykatën e Kosovës, që unë po i mendoj ato që janë  
22 vendore, ka qenë thirrja e njëjtë sikur ka qenë për ju, përmes  
23 mediave. Nuk ka pasë ata ndonjë beneficion ma tepër se ju. Të  
24 njëjtë.

25 Py. Dua që t'ju drejtoj tek diçka që keni thënë në

1 konferencën e tretë për shtyp.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Është materiali P35. Faqja 3. Me  
3 vulë kohore 07:51 deri në 08:20. Kjo pjesë në veçanti, të  
4 nderuar Gjykatës, përmban informacion konfidencial. Një prej  
5 personave në listën e emrave përmendet aty, kështu që propozoj  
6 që ta lexoj këtë për procesverbalin dhe mos ta dëgjojmë  
7 transmetimin dhe ndërkohë që e lexoj ta zëvendësoj emrin me  
8 numrin që është në fletën të cilën e ka zoti Haradinaj.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kërkoj  
10 ndjesë.

11 Duke qenë se s'ka kundërshtim, mund të veproni kështu.

12 Z. HALLING: [Përkthim]

13 Py. Zoti Haradinaj, kjo është diçka që ju keni thënë në  
14 konferencën e tretë për shtyp. Dhe kur të vij tek emri, do ta  
15 zëvendësoj emrin me numrin që keni ju në fletën tuaj.

16 "Këtu përmenden të dhënat e shumë personave. Emri i  
17 personit 29 përmendet ashtu sikurse përmendet dhe emrat e  
18 shumë e shumë personave të tjerë. Kështu që ja ku janë emrat  
19 që ata i kanë rrjedhur që kanë dalë prej tyre. Pra, nga ky  
20 moment i keni në dispozicion. Mendohuni, shikojini, është  
21 detyra juaj. Ligjin e dini, të drejtat e tuaja i dini. Ju  
22 falënderojmë që jeni aktivë. Ju falënderojmë që na  
23 përgjigjeni. Besojmë se së bashku duhet që të kryejmë një  
24 detyrë".

25 Zoti Haradinaj, pa e përmendur emrin e personit 29,

1 personi 29, a është person shqiptar?

2 Pë. [E padëgjueshme].

3 Py. Ju kërkoj ndjesë, e keni mikrofonin e fikur.

4 Pë. Zoti Prokuror, po, është shqiptar. I vetdeklaruar si  
5 dëshmitar, për çdo ditë shkrun. Edhe sot besoj, unë s'e di se  
6 s'e përcjelli shtypin, besoj që edhe sot e ka shkru. Kështu që  
7 ky për ju është sekret. Për ne 20 vjet ky gati nuk është  
8 sekret. Edhe para jush ky nuk është sekret. As ky tjetri, 30  
9 këtu. As numri 30 s'a sekret. Dhe nëse nuk a kështu, unë e  
10 pranoj dënimin pa më pyet hiç. Çfarë sekreti ky? Këtij s'muj  
11 ja ndalni gojën as ju. Nëse nuk a i porositun me fol qashtu.

12 Py. A bëtë ndonjë përpjekje për të verifikuar vërtetësinë apo  
13 a ishin të vërteta apo jo ato që thoshte personi 29?

14 Pë. Unë nuk e kam këqyrë dokumentin aty se çka ka thënë. Mua  
15 më ka ra në sy veç si emër. Të kam thanë edhe njëherë, nuk i  
16 kemi lexu, nuk i kam lexu që me e ditë taman. Unë kam shfletu  
17 dokumentet. Po si emër është njoftun edhe për një fëmijë që ka  
18 lind në 2000-shin, do të thotë se ky ja ka nis prej 2003-shit  
19 me fol. Vetë haptaz shkruan. Vetë shkruan artikuj nëpër gazeta  
20 të ndryshme. Ky është i njohtun për çdo njeri. Ky është, bile-  
21 bile, ky e imponon opinionin me e njoftë. Ndërsa 30, ky ka bo,  
22 ka thirrë mbledhje mediat i ka thirrë vetë privatisht. Ata që  
23 kanë qenë gjyqtarë në Kosovë, që kanë qenë ndonjëherë atje,  
24 është e pamundshme mos me ditë qita. Për të dytë.

25 Py. Nëse personi 29 ishte i ditur që më parë, siç thoni ju,



1 si, ku ishte interesi publik atëherë që t'i përmendej emri  
2 këtu?

3 Pë. Ishte interesi publik të dihej se cilët janë, çfarë janë,  
4 kush janë. Se a kanë shumë interesant puna e tij. Se unë  
5 s'kisha besu kurrë që ky do të ishte si dëshmitar për ju. Unë  
6 kam mendu se ky a një i çmendun që don me i bë vetes  
7 popullaritet dhe asgjë tjetër. Kështu që beso, më ka befasu ku  
8 ky është si i besueshëm për ju ose dëshmitar i mundshëm. E mos  
9 të flasim për të dhënat që jep ky njeri e që fol.

10 Py. Në fakt, zoti Haradinaj, ju mendonit se, konsideronit,  
11 pra, shumë dëshmitarë të cilët ju erdhët në dijeni nuk e  
12 thoshin të vërtetën?

13 Pë. Jo, unë nuk konstatova për shumë dëshmitarë, as për kënd.  
14 E konstatova personin që për mu është i lujtun, për mu. Mendim  
15 i jemi. Sepse një dëshmitar, nëse don me dëshmu, nuk bën  
16 kështu. Edhe unë apat s'muj e besoj që ky do të jetë  
17 dëshmitar. Ça ka me dëshmu ky? Po edhe nëse a dëshmitar, shumë  
18 mirë a haptas. Në rregull.

19 Py. Pra, me përjashtim të këtij një personi të vetëm, nuk  
20 keni asnjë ide nëse informacioni që përmbajnë këto dokumente  
21 është i vërtetë apo i rremë; kështu?

22 Pë. Jo. As tash s'kam idenë.

23 Py. Pra, e kuptoj që ju nuk e dini nëse ky informacion është  
24 i vërtetë apo jo?

25 Pë. Jo, jo. Për ato çka i thotë ai, unë nuk e di a është e

1 vërtetë a s'a e vërtetë. Po që fol vazhdimisht që krijon  
2 ngjarje që ky është që 20 vjet, do të thotë, atij nuk i kanë  
3 shtirr ngjarjet e reja. Asht shumë relaksus, kur dun njerëz me  
4 u relaksu e marrin e lexojnë, për me kesh. Thjeshtë.

5 Py. Kur thoni që nuk mendoni kurrë se personi 29 do të  
6 kishte do të ishte dëshmitar, ju po zbuloni diçka që emri i  
7 këtij personi ka dalë, ishte, pra, në paketën e tretë  
8 materiale, apo jo?

9 Pë. Po jam çudit, sikur u çuditsha për materiale. Jam çudit  
10 që edhe ky emër mund të jetë aty. Kjo ka qenë. Kurrëgjë tjetër.  
11 Dhe bile, kjo ku ka përmendet, ka qenë e emocionu dhe me  
12 kallëzu që s'keka diçka me rëndësi, s'keka më rëndësi. S'paska  
13 vlerë. Derisa ky person llogaritet si vlerë për çfarëdo qoftë,  
14 për mu i pa vlerë është. E aq ma shumë, zoti Prokuror, po  
15 them, po të dijet emri i tij të gjithë do të qeshin. Edhe sot  
16 t'i thuhet këtij dëshmitar i mbrojtur apo i msheftë që s'e din  
17 kush kush a. E vërteta është veç diçka, që s'ua ka marrë  
18 mendja kurrëgjë që është dëshmitar, po.

19 Py. Pra, kur po flisni për personin 29, në konferencën e  
20 tretë për shtyp, kjo s'ka të bëjë më me bashkëpunimin me  
21 Serbinë; apo jo?

22 Pë. Unë personalisht këtë njeri as nuk e njoh, as e kam pa  
23 kurrë. Më ka ra në sy si emër që është imponu nëpër gazeta, a  
24 imponu vetë nëpër gazeta. Nuk ka lënë kënd pa marrë nëpër  
25 gojë. Kështu që send -- mu ky veç këtë përshtypje më ka lanë

1 mu personalisht nëse më pyet. E në përgjithësi gati si e ka  
2 qit opinion për të gjithë. Kam lexu prej tij -- çka kam lexu  
3 pej tij as bestseller romanet që i kam lexu ngjarjet tij s'kam  
4 lexu.

5 Py. Në fakt kishte shumë shqiptarë në paketën e tretë të  
6 materialeve që u dorëzuan Organizatës së Veteranëve të Luftës,  
7 apo jo?

8 Pë. Unë nuk e di sa shumë ka pasë. Atë e dini ju. Unë s'e di.  
9 Unë s'e di as sot sa shqiptarë a ka shumë, a ka pak. Unë këta  
10 që i kam cek dhe që i keni qit këtu disa, se s'janë tanë, këta  
11 janë që kanë bë përshtypje se kanë qenë njerëz zyrtarë, dhe  
12 njëherë po them, zbatues dhe urdhërdhënës të krimeve. Vetë  
13 kanë ekzekutu edhe ma e vogla është kanë dhënë urdhër.

14 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretares së Gjykatës, të  
15 kaloj në faqen 13 të transkriptit në anglisht të këtij  
16 materiali. Për shqipen është faqja që ka vulën kohore 25:40.

17 Py. Ku thotë 25:40 në faqen në ekran, zoti Gucati thotë:

18 "Ka edhe shqiptarë. 80 për qind e personave që kanë dhënë  
19 dëshmi aty janë shqiptarë".

20 Pra, a është kjo që ka thënë zoti Gucati këtu a është e  
21 saktë?

22 Pë. Ky s'është konstatim i imi edhe unë nuk e di a është e  
23 saktë. Singërisht nuk e di, s'e nuk kam këqyrë për me e  
24 përcaktu. Se për me e përcaktu këtë u dashtë me i lexu. Unë  
25 s'kam qejf me fol diçka që spekuloj. Dhe jam shumë i bindur që

1 zoti Gucati këtë e ka thënë kishe po du me dit, me tregu  
2 diçka, se nuk është se s'ka lexu, se s'ka mujt me lexu. Mos  
3 harroni për me i lexu këto, janë kanë mbi 1.200 faqe. Kështu  
4 që edhe me dashtë s'ka mujt me i lexu. Kërrkush. Asnjëri. Të  
5 vetmit që kanë mujt me lexu janë ZKA-ja, ata që i kanë marrë  
6 komplet i kanë pasë atje në zyrat e veta. Unë s'muj të  
7 kontaktoj për Hysninë. E keni pasë këtu. E keni pyt. Po më  
8 duket se ia ka fut paushall, për mu. Ky a mendimi jem. Mbase  
9 po don opinion temin për tjetër kënd, ky a mendimi jem. Ja ka  
10 fut paushall. Se s'i din. As me dash s'i din as ai, as unë.

11 Z. CADMAN: [Përkthim] Kundërshtim. Zoti Haradinaj nuk  
12 mund të përgjigjet se çfarë ka thënë zoti Gucati dhe çfarë ka  
13 menduar zoti Gucati. E kemi ngritur edhe dje të njëjtin  
14 kundërshtim për postimin në FaceBook.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po,  
16 përgjigjen e dha për pyetjen.

17 Z. CADMAN: [Përkthim] E kuptoj, por unë u ngrita në këmbë  
18 me këtë kundërshtim nëse vazhdojnë këto lloj pyetjesh.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Pyetja tjetër ka të bëjë  
20 drejtpërdrejtë me zotin Haradinaj.

21 Py. Zoti Haradinaj, a është dhe kjo shifra juaj paushall sesa  
22 shqiptar ishin në këto materiale?

23 Pë. Jo. S'është shifër e jemja hiç.

24 Py. Po sa është shifra juaj?

25 Pë. Tregomë, po të tregoj.

1 Py. Nuk është -- nuk bëhet kështu. Pyetja ime është kjo.

2 Shifra juaj cila është?

3 Z. CADMAN: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Kundërshtim. Është  
4 bërë pyetja ka mare përgjigje.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E  
6 kundërshtojmë. E rrëzojmë.

7 Z. CADMAN: [Përkthim] E ka përgjigjen më sipër.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti  
9 Haradinaj, mund t'i përgjigjeni pyetjes. Përgjigjuni.

10 I AKUZUARI HARADINAJ: Nuk e kam idenë. Nuk di.

11 Z. HALLING: [Përkthim]

12 Py. I keni parë dokumentet në paketën e parë me zotin Gucati  
13 përpara konferencës për shtyp; apo jo?

14 Pë. Jo. s'i kem parë. I kemi shfletu për një moment shumë të  
15 shkurt.

16 Py. Në fakt, në momentin e konferencës për shtyp ju ishit më  
17 të familjarizuar me dokumentet se ç'ishte zoti Gucati, apo jo?

18 Pë. Në ç'kuptim po mendon "të familjarizum"?

19 Py. Mbase ta them me një citim.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Po të shkojmë në faqen 2 të  
21 transkriptit të kësaj video në anglisht. Ndërsa për shqipen  
22 është vula kohore 05:52 deri në 06:03.

23 Py. Është aty ku para se zoti Gucati t'ju japi fjalën. Zoti  
24 Gucati thotë:

25 "Unë nuk do vazhdoj më shumë se Nasimi -- ja të pres sa

1 të dali në ekran.

2 "Pra, unë nuk do të vijoj më shumë Nasimi do të vazhdojë,  
3 ai di më shumë se unë se ai i ka lexuar dokumentet diçka më  
4 shumë. Nasimi do ju tregojë më shumë për këto dosje".

5 A i kishit lexuar ju dokumentet më shumë sesa zoti Gucati  
6 përpara konferencës për shtyp?

7 Pë. Ka mundësi me ma qit në video? Se është shumë interesant  
8 se e di saktë këtë çështje. Dhe e ka menjëherë përgjigjen  
9 kryetari sapo i ka thënë këto fjalë nga unë. Nëse e keni, nëse  
10 s'e keni po e shpjegoj.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo pjesë e videos nuk ka  
12 informacion konfidencial, i nderuar Gjykatës. Meqenëse  
13 dëshmitar kërkon mund ta dëgjojmë videon.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, ta  
15 dëgjojmë.

16 [Luhet videoincizimi]

17 Z. HALLING: [Përkthim] Zoti --

18 I AKUZUARI HARADINAJ: A ka mundësi me vazhdu vetëm edhe  
19 pak, se është përgjigja ime drejtë për kryetarin.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Të dëgjojmë edhe 10 sekonda të  
21 tjera në mënyrë që zoti Haradinaj ta ketë fillimin e  
22 përgjigjes.

23 [Luhet videoincizimi]

24 I AKUZUARI HARADINAJ: E shef? Se thotë edhe thotë jo që  
25 din ma shumë se unë. E vërteta a kanë, e vërtetë a kanë që pat

1 porosit bukën, se a kanë e paplanifikune, e i ka pat mbet buka  
2 poshtë. Dhe ky është i sëmurë, ka problem me sëmurdjen e  
3 sheqerit, siç e dini zyrtarisht dhe kur i bien sheqeri ky  
4 duhet me hangër patjetër. Nuk është që a gurman, po i duhet  
5 patjetër me hangër diçka. E u duhet me u çu dhe tha qashtu.

6 E dyta, unë në seancë i them, ma vonë nëse këqyret, unë i  
7 them "Kryetar unë sa ma shumë se ti s'di, po s'ka problem".  
8 Mirëpo dhe e dyta, është detyra jeme mandej si zëdhënës me  
9 marr punën edhe me bisedu.

10 Kështu që nuk është asnjë send që unë jam ma i  
11 familjarizum. Se unë s'e di sa i këqyrë ai. Kështu që krejt  
12 koha për të gjithë i ke pasë [në] disponim qashtu. 20, nëse  
13 janë të parat, nëse a fjala për të parat, 20-30 minuta. Nuk  
14 janë bo 30 minuta. Mi tuj shfletu vetëm sa ke këqyrë a janë të  
15 njëjtat. Nëse është qetu për dosjet e para. E unë mendoj që  
16 është për të parat. Këqyrne kohën. Këqyrne datën. Mendoj, s'po  
17 hi të sigurt.

18 Py. Zoti Haradinaj, t'jua kujtoj. Kjo është nga konferenca e  
19 tretë për shtyp më datë 22 shtator. A janë këto dokumentet që  
20 ju i patë për 30-40 minuta?

21 Pë. Nëse është konferenca e tretë nuk ka 30, 20-30 minuta ka  
22 llogarit kohën pi poshtit që janë ardhë e deri kem ngjit nalt.  
23 Se ne s'e llogaritet ashtu koha, zoti Prokuror, të parat na  
24 kanë ra diku 3 orë, 4 orë me kanë prej si kanë ardhë deri a u  
25 kry mbledhja e gazetarëve. Zoti Gucati e ka diku dhe një

1 deklarimin. Unë atë ditë ka deklarua tha nja katër orë a  
2 dikush. Katër orë po. Po katër orë ka ndodhë krejt procesi.  
3 Prej si kanë ardhë deri a kry mbledhja për mediat. Ndërsa  
4 mbledhje tjera nuk kanë zgjatë as ka 20-30 minuta. Kështu që  
5 krejt proceset në tjerat ka zgjatë një orë mundet me zgjatë  
6 krejt. Shihet aty asht e regjitrune.

7 Py. Pra, kur thatë në pyetjet që bëri avokati juaj që është  
8 faqe 2785 të transkriptit që ju i patë paketën e tretë të  
9 materialeve për rreth 3 minuta, në fakt, është pak a shumë 30  
10 minuta, kështu?

11 Pë. Jo, 3 minuta është që i kam këqyrë atje poshtë. Asht edhe  
12 një orë e gjysë e dy orë nëse këqyret deri [kur] ka përfundu  
13 mbledhja e gazetarëve. Kështu që unë s'kam nejt gjithë kohën  
14 tuj i këqyrë ato. Kam ndejt tuj organizu sallën, tuj përgatit  
15 sallën sepse salla duhet me u përgatit, duhet me u fshi. Na  
16 vetë i fshijmë, vetë i pastrojmë, vetë i rregullojmë karrigat.  
17 Na nuk kemi punëtorë aty. Një pastruese e kemi që e kryen aty  
18 pjesën e zyrave dhe ne të gjitha i bëjmë vetë në mënyrë  
19 vullnetare.

20 Py. Sa kohë kaluat, pra, për sa kohë i patë dokumentet  
21 përpara konferencës për shtyp 3 minuta apo 30 minuta?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
23 përcaktoni për të cilën mbledhje, për cilin takim.

24 Z. HALLING: [Përkthim]

25 Py. Në total nga momenti që u dorëzuan deri në konferencën



1 për shtyp?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për cilën  
3 konferencë për shtyp e keni fjalën?

4 Z. HALLING: [Përkthim] Të gjitha këto pyetje po i bëj për  
5 konferencën e tretë për shtyp 22 shtator.

6 I AKUZUARI HARADINAJ: 3 minuta edhe a shumë. Se e kem  
7 këqyrë faqen, se a kanë e qartë faqja e parë që u duk si  
8 aktakuzë dhe u lexun derisa u lexu emni -- si e kam lexu emnin  
9 që u [e pakuptueshme] përpara që e keni çu ju një aktakuzë për  
10 ta, si e kam lexu emnin Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Rexhep  
11 Selimi e Kadri Veseli për mu a kanë e qartë edhe më s'kam pasë  
12 nevojë me lexu send se a kanë në anglisht. Edhe me pat nejt  
13 une me i lexu edhe katër orë edhe nëntë orë unë s'e kisha  
14 kuptu. Unë e kam kuptu në bazë të emnave. Kështu që as tre  
15 minuta, as tre. Po, po i lëjmë tre.

16 Py. Pra, kur zoti Gucati tha se i kishit lexuar për diçka më  
17 shumë se 30 minuta ju nuk e korrigjuat, apo jo?

18 Pë. Kur me e korrigju? Atëherë?

19 Py. Po.

20 Pë. Unë e kam korrigju apo e sheh. I thashë "Të ka marrë uja  
21 e s'je ka dit çka je ka folë". Të ka marrë uria. Për qëta  
22 lypa me i lëshu qëta mbrapa.

23 Py. Dhe kur Zoti Gucati tha që 80 për qind e dëshmitarëve në  
24 atë paketë ishin shqiptarë, ju as për këtë nuk e korrigjuat,  
25 apo jo?

1 Pë. Unë nuk e di që ka pasë aty shqiptarë, paketë të tretë a  
2 çka ka pasë. *De facto* tregoj në paketën e tretë unë po qita  
3 emra që i kam pa dhe as shfletu atë punë s'e kam. As këqyrë më  
4 s'e kam. Se s'e kisha kuptu është anglisht krejt. Ka qenë në  
5 anglisht.

6 Py. Nga momenti që mbërriti paketa e tretë deri në  
7 konferencën për shtyp nga Organizata e Veteranëve të Luftës së  
8 UÇK-së kush po e shihte këtë paketë?

9 Pë. Të tretën e kanë shikue KFOR-i. Ma shumë ka ndejtë KFOR-i  
10 aty se unë. Ne s'kem ndejtë hiç. E kam spjegu edhe dje. Unë  
11 kam dalë jam marrë me Taiben. Unë si kam pa dalë jam marrë me  
12 Taiben edhe nuk -- në fakt, aty me këqyrë unë s'di kush ka  
13 ndej mbrend. Po e di që KFOR-i më kanë ardhë mbrapa edhe kur  
14 kanë dalë ka -- ku më kanë gjet te Taibja, di që më thanë po e  
15 shohim që jeni të zanë e po shkojmë, ditën e mirë, e s'po muj  
16 e mbajmë takimin. Kështu që unë s'jam kanë.

17 Nëse më pyet sa kam ndejtë në ndërtesë? Po, kam ndejt në  
18 ndërtesë edhe pa ardhë këtu aty. Nëse më pyet sa ka zgjatë  
19 krejt procedura pej që kanë ardhë e deri u kry mediat, kjo  
20 është ndër konferencat më të shkutna që ka ndodhë dhe ma të  
21 shpejtat që i kam thirrë.

22 Py. Faleminderit. Zoti Haradinaj, nuk ju kërkoj të spekuloni.  
23 Thjesht dua që të më thoni se kush janë ata njerëz që ju e  
24 dini që i kanë parë dokumentet. Pra, ju kuptoj, pra, është  
25 zoti Gucati ju vetë dhe KFOR-i. Po tjetër veç këtyre?

1 Pë. Zoti Gucati, Fatoni ka qenë aty edhe unë ku kam dalë prej  
2 mbledhje, edhe KFOR-i. Këta i mbaj mend, tash për tash po më  
3 kujtohen. Nuk e di Çelë Gashi a i ka pa. Ka qenë aty. Nuk jam  
4 i sigurt. Po qëta që po i them jam i sigurt.

5 Py. Pra, askush tjetër, nuk është askush tjetër veç zoti  
6 Gucati, Faton Klinakut dhe ju vetë dhe KFOR-it, për të cilin  
7 ju e dini se i kanë parë dokumentet? Kjo është lista e  
8 personave?

9 Pë. Këto që më kujtohet që kjo është. Sa më kujtohet që kjo  
10 është.

11 Py. Paketa e tretë mbërriti diku midis orës 10.00 dhe 11.11  
12 të datës 22 shtator, kështu?

13 Pë. Po. Po këtë muj e kujtoj ma saktë kohën sepse 11.00 e kam  
14 pasë kohën e caktun me KFOR-in gjerman me e nis takimin, me  
15 fillu takimin.

16 Py. Dhe konferenca për shtyp ishte rreth orës 13.00, kështu?

17 Pë. Nuk e di a thirr në 13.00 a u thirr në 12.00. Nuk e di  
18 saktë. A ka përfundu në ora 13.00. Nuk e di të sigurtë tash.  
19 Po e di që menjëherë e kem thirr. Menjëherë. Do të thotë 3  
20 minuta sa e kem pa. Veç sa u ka vonu me i thirr, me ja çu  
21 ftesat sekretari.

22 Py. Zoti Haradinaj, gjatë pyetjeve që jua bëri avokati, folët  
23 për një grua me emrin Elmedina. A është gazetare kjo Elmedina  
24 Ballazi që ka dhënë dëshmi këtu në sallë?

25 Pë. Po. Ajo është.

1 Py. Dhe ajo erdhi dhe foli me ju menjëherë pas dorëzimit të  
2 paketës së dytë të materialeve, kështu?

3 Pë. Po diku nja 20 minuta. Ndoshta dhe 30. Por, po. Gazetare  
4 në një mënyrë që na u duk se erdh shumë shpjet se gazetarët --  
5 erdh shumë shpejt. Këtu na ka bo përshtypje.

6 Py. Dhe ju thatë një moment se ajo ishte si këta të CIA-s  
7 edhe se deshët që ajo të largoheshte prej zyrës, a është kjo e  
8 saktë?

9 Pë. I thashë "Largohu. Mos e më pyetke. 'Shka ju ka ardhë?  
10 Shka ju ka ardhë?" E përderisa ne e kishim qit lajmin për  
11 media, unë s'i kam spjegu kurrherë mediave në lajm as na, as  
12 sekretari, as kërrkush se çka ardhë. Vetëm kam thirr mbledhje  
13 për media edhe kurrgjë tjetër. I kena spjegu kur kanë ardhë.  
14 Kërrkush s'ju ka spjegu. S'besoj që ka spjegu dikush. Ajo më  
15 boni përshtypje se pyetke në atë mënyrë sikur po e din që ka  
16 ardhë diçka. Se ajo nuk ka qenë në dhomë. Ne dokumentet çdo  
17 herë i kemi marrë, i kemi çu në zyrë të kryetarit e ke mëshel  
18 derën dhe nuk i ka pa kërrkush tjetër pos unë, Fatoni, zyra --  
19 do të thotë kryesia e ngushtë që jemi aty. As vetë ajo  
20 punëtorja që punon në reception, Taibia, kurrë nuk ka pasë  
21 mundësi me i pa. As ka tentu, se a kanë e distrahune krejt a  
22 kanë, po edhe pat dash nuk e kishim lënë më beso. Se s'është  
23 organi i kryesisë së ngushtë.

24 Py. Po kjo grua a ishte e mirëseardhur në zyrat e OVL UÇK-së  
25 pas këtij shkëmbimi?

1 Pë. Sikur të gjithë gazetarët tjerë. Nëse më pyet mu, mendimi  
2 jem, unë bilës s'kam pasë qejf hiç me i pa. Si i fortë [u]  
3 mbajke. Shumë e interesune. Këtë person unë e njoh mbasi ja  
4 kam dhënë intervistën dhe mbasi i ka bo qeto sjellje. Unë kam  
5 edhe numër të saj të telefonit. Pastaj, si gazetare e njoh.  
6 Kaq. Po nuk e kam njohë përpara hiç. Se nuk është gazetare e  
7 ndonjë media të madhe publike. Më duket është e portaleve.  
8 Edhe s'kam pasë intervista me të unë deri qat ditë që më pat  
9 lodhë. O dot me ja dhanë -- më lodh, bile, jam tue mbajt  
10 mbledhjen ku vjen e më thotë "Apo ma jep intervistë? Apo ma  
11 jep intervistë dy minuta, dy minuta a të lutem dy minuta". E  
12 me e hek qafe i thashë "Po".

13 Pastaj meqë i thashë sa u kry mbledhja, fill sa u kry,  
14 jam shku poshtë ja kam dhënë edhe unë s'besoj që ka intervistë  
15 ma të gjatë as në zyra, as aty se katër e pesë minuta me mu.  
16 S'kam dhënë kurrë intervista tek kjo më përpara. Kurrë.

17 Py. Zoti Haradinaj, Në këtë moment dua t'ju tregoj dhe një  
18 video. Do të jetë pak i ndryshëm prej të tjerëve që kemi parë.  
19 Është një incizim prej kamerave CCTV të zyrave të OVL UÇK-së  
20 më datën 22 shtator 2020.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Janë dy incizime më të gjata.  
22 Njëri është prej orës 10.00 deri në 11.00 të mëngjesit dhe i  
23 dyti prej orës 11.00 deri në 12.00. Dua që të vendosim në  
24 video atë me numrin 104414-01. Nuk ka transkript meqë nuk ka  
25 edhe zë. Mendoj që prova ka klasifikim konfidencial, por kjo

1 pjesa që do ta luajmë tani mund të luhet publikisht. Ju lutem,  
2 shkoni tek vula kohore 10:35 në mëngjes, domethënë 10:35:00.  
3 Dhe këtë e shihni në krye të faqes nga ana e djathtë. Duhet të  
4 shkoni pak më përpara për nja dhjetë sekonda. Këtu është në  
5 rregull. Faleminderit.

6 Py. Zoti Haradinaj, përpara se ta luajmë videon kjo është  
7 zyra e OVL UÇK-së, a është e saktë? E shoh se që bëni po me  
8 kokë.

9 Pë. Po, shumë e saktë.

10 Py. Ka pak një përshpejtim në krahasim me kohën reale me këtë  
11 incizim të CCTV-së, por një moment do të thërrasë sekretaren  
12 që të luaj atë pjesën e kohës prej 10:35 deri në 10:36:10 dhe  
13 unë do t'ju bëj aty pyetje.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem, ndaloni në atë moment  
15 kohor kur të mbërrij incizimi.

16 [Luhet videoincizimi]

17 Z. HALLING: [Përkthim]

18 Py. Zoti Haradinaj, ky është materiali paketa e tretë duke hy  
19 në zyrën e kryetarit, ashtu sikurse thatë edhe ju, a është e  
20 saktë?

21 Pë. Po, kështu po duket.

22 Py. Dhe kjo është dhoma ku ata për të parë, domethënë,  
23 dokumentet u shiquan dhe ku këta të KFOR-it i shiquan  
24 dokumentet; a është kjo e saktë?

25 Pë. Dhoma ku shkun, se ajo në të majtë në fund është dhoma e

1 kryetarit. Fill ngjitas me të është dhoma ime. Ndërsa këtu në  
2 fillim në [të] djathtë hymja është kjo, ne i thojmë si sektari  
3 edhe pse kjo është recepsioni. Dhe kjo dera në të djathtë, që  
4 po shihet e çelun, këtu është ku jam kanë unë tuj e bajt  
5 mbledhjen zyra e nënkryetarit Migjen Shala.

6 Py. Domethënë, derën që e shohim dikund nga pjesa e majtë e  
7 fotografisë aty kanë shku dokumentet edhe aty janë shiqu  
8 dokumentet përpara se t'i nxirrnin në konferencën për shtyp, a  
9 është kjo e saktë?

10 Pë. Çdo herë a vepru qashtu.

11 Py. Pyetja ime me radhë --

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendoj që  
13 këto i kemi përdorur edhe më herët këto incizime ndoshta duhet  
14 t'i paraqitni si provë materiale.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo pjesë është nxjerrë nga një  
16 provë që tashmë është pranë si e tillë. Mbulon edhe disa gjëra  
17 tjera që dalin jashtë provës mirëpo në qoftë se është e  
18 nevojshme atëherë mund ta paraqes edhe tani si provë materiale  
19 por edhe në fund të kundërpyetjeve.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta bëjmë  
21 këtë tani.

22 A ka dikush ndonjë kundërshtim në lidhje me paraqitjen e  
23 këtij materiali si provë? Është prova me numrin ERN 104414-01.

24 Z. BOWDEN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ka pasur edhe  
25 mocione të drejtpërdrejtë në sallë të gjyqit në lidhje me

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 104

1 provat e CCTV-së. Kohëzgjatja e këtyre klipeve është më e  
2 shkurtër, mirëpo, nuk kemi kundërshtim që të pranohet edhe një  
3 klip me kohëzgjatje më të gjatë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

5 Atëherë mund t'i caktoni një numër kësaj prove, e nderuar  
6 Sekretare.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
8 104414-01 do të marrë numrin e provës P163.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prova P163  
10 pranohet si e tillë pa kundërshtime.

11 Vazhdoni, Prokuror.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

13 Tani do të bëj pyetje në lidhje me pjesën që është në  
14 kohën 10:55:30. Ndoshta është më mirë që ta luajmë këtë pjesë  
15 në mënyrë që ta shikojmë pikërisht atë pikë. Mund ta luajmë  
16 pak më shpejt, në mënyrë që të arrijmë më shpejt në atë vulën  
17 kohore që na duhet për këtë pjesë të pyetjes.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë nuk kam  
19 kundërshtim për këtë. Mund të vazhdoni.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Ju faleminderit. Dhe ju lutem  
21 zonja Sekretare, ndaloni tek vula kohore 10:51:30.

22 [Luhet videoincizimi]

23 Z. HALLING: [Përkthim]

24 Py. Pra, zoti Haradinaj, tani do ta luajmë këtë pjesë prej  
25 këtij minutazhi me shpejtësi normale dhe, ju lutem,



1 përqendroni në personin që është në objektiv. Ju lutem, pra,  
2 përqendrohuni në atë pjesë me atë minutazh.

3 [Luhet videoincizimi]

4 Z. HALLING: [Përkthim]

5 Py. Zoti Haradinaj, kjo është Elmedina Ballazhi - nuk e di si  
6 e shqipton Prokurori mbiemrin, kërkoj falje -

7 Pë. E ka një emën që as unë s'ia mbaj mend, veç me ja lexu.

8 Py. Domethënë, kjo është Elmedina, atëherë do ta përdori  
9 vetëm emrin, që paraqitet në zyrat e OVL UÇK-së më pak se 30  
10 minuta pas ardhjes së Paketës 3 në atë zyrë. A ju kujtohet ta  
11 keni pa Elmedinën aty?

12 Pë. Jo, jo. Ka qenë -- atë ditë ka pasë edhe mysafirë shumë.

13 Ka qenë edhe shumë -- edhe qysh po i shoh keka ardh, keka ul.

14 Nuk më kujtohet. Thjeshtë s'po më kujtohet. Diçka unë me

15 mendjen time jam i sigurt -- po më shtini me mendu pse kjo orë

16 10:58. Shiqoni, mos është ndërrimi i kohës, se gjithë më duket

17 se ka qenë në ora 11:00 mbledhja. Shiqo, mos është ndërrimi i

18 orës gabim këtu, se tani s'dinë kush me i ndërru këto hiç.

19 Rastësisht, ju jeni ekspert. Ju e dini. A mos a dashtë me a

20 kanë 11:00 në vend të orës 10:00. Ndoshta dhe është kështu.

21 Unë të gjithë më kujtohet që -- se zakonisht i kam lënë në

22 11:00. Ka mundësi me pat kanë edhe në 10:00. Nuk -- me këtë

23 numër këtu po më bën me dyshu në vetvete ka mundësi me pat

24 kanë edhe ju kam referu si 11:00 kohës, po kam mundësi me pat

25 kanë edhe 10:00. Po këtu po më koicidon me kohën 10:00, 10:30

1 qysh po e flas unë. Nëse e lëshon më përpara i sheh edhe kur  
2 kanë ardhë në mbledhje.

3 Besa mundesh me i pa edhe kur kem dalë në ballkon me  
4 KFOR-in. Krejt çka i kam spjegu janë këtu.  
5 Py. Do ta luajmë pak edhe ma gjatë.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Dua që t'i luajmë me shpejtësinë  
7 normale tre minutat në vijim, domethënë, deri në 11:01. Dhe  
8 pastaj do të kalohet në videon e dytë që është me numrin  
9 104414-02.

10 Pra, ta luajmë njëherë këtë pjesën e mbetur të këtij  
11 incizimi dhe pastaj të kalojmë te incizimi i dytë dhe pastaj  
12 ndalojmë.

13 [Luhet videoincizimi]

14 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Mund ta luajmë  
15 incizimin tjetër.

16 [Luhet videoincizimi]

17 Z. HALLING: [Përkthim]

18 Py. Zoti Haradinaj, pse e futën Elmedinën në dhomën ku ishte  
19 Paketa numër 3?

20 Pë. Singerisht s'po më kujtohet. Ky fakt as po më kujtohet që  
21 ka qenë kështu. Ka mujt dhe me kanë. Sepse janë edhe gjermanët  
22 mbrenda. Unë s'besoj që ju ka servu kësaj diçka me pa aty. Ajo  
23 e din ma mirë. Filmi po shihet qështu. Mu s'po më kujtohet si  
24 fakt kjo. Nuk po du as me mohu as me këtu. Nuk po e di. E  
25 keqja është, që unë po mendoj, që ish kanë të mirën time është

1 sukur të ish kanë edhe zëni edhe atëherë ishte bo shumë mirë  
2 me u ndih edhe pse jo. Pse s'ka diçka që me mbajt mësheftë.  
3 Sepse më dhomë ka hini edhe ai tjetri që është kamerier, por  
4 nuk i ka pa ato. Sendet muj hin kushdo, muj hin me folë në  
5 zyrat tona janë, po unë nuk besoj që asaj iu ka servu diçka me  
6 u pa. Ndoshta, nëse ajo i ka pa -- unë nuk besoj. Nuk besoj. E  
7 di që vetë nuk i kam dhënë. S'ka teori sepse se kam privilegju  
8 asnjë gazetar.

9 Py. Ajo duket se është e mirëseardhur prej jush, të paktën  
10 prej këtij incizimi dhe unë mendoj që ju thatë se nuk ishte e  
11 mirëseardhur, për mendimin tuaj?

12 Pë. Çdo gazetar, shiqo, kjo është tash pozita ku ashtë mbas  
13 mbledhjes së dytë. Ku unë e njoh pak si gazetare. Çdo gazetar  
14 ka qenë i mirëseardhun në zyrat tona. Na nuk i kemi zyrat e  
15 mëshelme. Vetëm nëse kem takime me tjetërkënd përpara. Nuk  
16 është veç kjo.

17 Py. Dhe ajo nuk ka pasë qasje speciale në zyrat e OVL UÇK-së  
18 edhe pse e shikojmë këtu se ajo po sillet aty në dhomë brenda  
19 30 minutave prej kur ka arrit Paketa numër 3?

20 Pë. Shiqo, ju natyrën e gazetarit e dini mirë dhe po e shoh,  
21 gazetarët gjithmonë mundohen me i shfrytëzu situatat, me i  
22 shfrytëzu mundësitë. Kjo dhe e paska shfrytëzu në këtë  
23 kuptimin ku ne jemi kanë të gjithë deri në një farë mënyre, se  
24 çka me bo, ende pa kën të qartë ça po bëjmë. Kështu që në këtë  
25 formë kjo dhe, normal që e ka shfrytëzu, ndoshta e shfrytëzon.

1 Por jo qysh po e transmetoni ju, si e privilegjuar ose si e  
2 veçantë ose diçka. Jo. Në asnjë mënyrë.

3 Py. Mendoj që duhet të shofim se çfarë ndodhë më pas në  
4 video.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Këtë pjesë mund ta luajmë me katër  
6 herë më shpejt, pra, me atë shpejtësi dhe ta luajmë prej  
7 minutës 11:01 deri në 11:25:30.

8 [Luhet videoincizimi]

9 Z. HALLING: [Përkthim] [Nuk ka mikrofon] A mund t'i luani  
10 30 minutat në vijim me shpejtësi normale.

11 [Luhet videoincizimi]

12 Z. HALLING: [Përkthim]

13 Py. Pra, me sa duket ajo ka kalu rreth 25 minuta në atë  
14 dhomë; a është kjo e saktë?

15 Pë. Kështu po shihet që ka kalu. Ka mujt me kalu edhe ma gat,  
16 në kuptimin si gazetar ka mujt me ndejt sa ka dasht. Ne nuk e  
17 bo -- ne jemi kanë tuj marrë me punët tona. Ti më pave kur  
18 dola këtu. E, në fakt, qetash po më kujtohet ku e pava veten  
19 kur dola pej zyrës. Thjeshtë na s'jem ka dojnë me mëshef as  
20 një send. Me pat dashtë me mëshef, ti s'e kishe gjet këtë  
21 kamerë. S'iu kishim thënë këqyrne. Nuk po dojmë me mëshef  
22 asnjë send. Krejt çka është këqyrni. Jemi transparent. Edhe ti  
23 tash nëse don me çka bën a -- nuk muj më kujtohet shumë as mu  
24 kjo.

25 S'mu kish kujtu ndoshta as ditën e katër e të pestë, le

1 më tash. E di si ngjarje. E kanë spjegu si ngjarje brenda  
2 mundësive sa mu më kujtohet. Kaq. Jua kam ofro këtu edhe ma  
3 herët. I keni marrë. Këqyrni. Asnjë send s'po e kontestoj.  
4 Vetëm ora po më duket ende edhe pse mundet me kanë e vërtetë,  
5 ende vetëm në orë, s'di qysh mu ka tek si, po më duket se  
6 është ora një orë ma mbrapa. Apo e shty një orë ma pas nuk po  
7 koincidon -- ndoshta dhe ka qenë 10:00. Se zakonisht unë  
8 përtojsha me i lanë në ora 10.00 dhe mu dukke me u çu ma herët  
9 pej shpie. Po ndoshta. Mirëpo orari jem zakonisht i mbërritjes  
10 ka qenë 9.00, 9.30, 10.00. Kështu që ka mujt me i lënë edhe  
11 10.00 derisa atyne iu ka dashtë në 10.00.  
12 Py. Dhe në incizim shiheni ju duke hy e duke dalë prej dhomës  
13 ma shumë herë edhe ju vazhdoni të dëshmoni tani se nuk e dini  
14 në qoftë se ajo i ka pa apo jo dokumentet e Paketës numër 3; a  
15 është dëshmia juaj?  
16 Pë. Po nuk e di se ai i ka shët telefonat. Ai i ka shën nuk e  
17 di në tash unë. Nuk mundesh me më shti -- unë nuk po muj me  
18 mbaj mend diçka ma tepër. Unë çka po i mbaj mend jam tuj  
19 bisedu. Nuk jam ka e kontestoj çka po i fol, po i kontestoj  
20 qysh po i ti po i transmeton me mendimin tuj pa këtë  
21 fotografi. Edhe unë nëse -- unë nuk pajtojna me kët konstatim  
22 që po thu ti. Unë thjeshtë është i incizun s'kem pasë interes  
23 me mbajt msheftë. E keni pa qaty. E keni këqyrë. Krejt ça ka  
24 ndodhë, ka ndodhë. E vërteta a kjo që po jua them unë. Se çka  
25 ju ndërtoni mbi këto fotografi është e drejtë e juaj dhe e

1 drejtë dhe e gjykatësit pastaj me i këqyrë dhe me vendosë. Pse  
2 jo?

3 Por na s'kemi pasë diçka me e mëshefë. Një diçka është,  
4 me pat dashtë me e mëshefë na kem mujt veç me hek kabllin mos  
5 me incizu hiç. S'kemi qenë të interesum me i mëshef. Jem konë  
6 të të interesum me konë transparentë. Unë lëvizjet nuk i kam  
7 të kontrollune kërkund.

8 Edhe brenda burgut këtu ku më keni shti mu, unë lëvizjet  
9 sa munda unë me i bo qysh du unë i bëj. Nuk i bëj të  
10 kontrollune unë. As du me jetu nën kontroll, vetëm atëherë ku  
11 jam i detyrun me dhunë. Ju po më mbani këtu me dhunë, se sa  
12 herë të më kishit thirrur ju, kisha ardhë. Kurrë s'ju kish a  
13 refuzu edhe qetu në qeto gjyqe. E keni pa të arsyeshme me më  
14 mbajt, mbamëni. Përndryshe s'kam ça komentoj më. Diçka muj e  
15 komentoj me pat dashtë në botë diçka mësheftë nuk ish incizu  
16 që kjo kamerë.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Kërkoj nga Sekretarja që të  
18 vendosë në ekran dokumentin P25. Është koleksion i artikujve  
19 të gazetave.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i  
21 paraqisni këto si prova?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Do ta bëj këtë pasi t'i bëj  
23 pyetjet.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni si  
25 të doni atëherë.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Në dokumentin P125 ka një artikull  
2 që fillon me numrin ERN 081374.

3 Py. Zoti Haradinaj, e shikoni në ekran. Është një artikull në  
4 Arbëresh.info i 22 shtatorit 2020. A e shikoni në ekran?

5 Pë. Po.

6 Py. Dhe ka një faqe aty në mes ku flitet për të akuzuar  
7 potencial dhe shikohen aty fjalët "Përmbledhje ekzekutive" dhe  
8 disa emra. Persona që i keni përmendur ju gjatë konferencës së  
9 tretë për shtyp; a është kjo e sakë?

10 Pë. Po, janë disa prej tyre që i kam përmend.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Në qoftë se kalojmë në faqen  
12 tjetër me radhë.

13 Py. A mund të na shpjegoni sesi Arbëresh.info ka mund ta  
14 publikojë këtë artikull në orën 11:06 minuta që është  
15 pothuajse dy orë përpara konferencës së tretë për shtyp, si  
16 është kjo e mundur?

17 Pë. Zoti Prokuror, e sqarove edhe njëherë. Nuk kam pasë  
18 vëmendje dhe nuk e di. Unë sa më kujtohet mu, nuk e di në  
19 prezencë time ajo që i ka këqyrë këto. A i ka këqyrë ka i ka  
20 këqyrë KFOR-i a çka ka shfrytëzuar ajo që i kanë dredhit e veta  
21 gazetarët, unë nuk e di. Unë nuk e di. Tani unë s'jam ka  
22 kontestoj a ka qit a s'e ka qit, është qa ajo. Unë nuk e di.  
23 S'e më kujtohet në prezencë time. Pra, ka mujt, ka mujt edhe  
24 me i bo qaty unë s'e kam pasë vetëdijen ma aty. Për mu, ke  
25 proces i kryrë dhe kurrëgjë tjetër. Kaq. S'e di. Singërisht s'e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 112

1 di. S'ëm kujtohet nuk jam ka i bishtnoj pyetjes. S'ëm kujtohet  
2 dhe jam ka mundohna me e memorizu nuk po vjen ndërmend që kom  
3 pa tuj i bo ajo diçka. Ka mujt me kanë edhe në dhomë tuj  
4 bidedu krejt për tema tjera edhe mos me i pa. Nuk po i iki. Me  
5 e pat pa kisha thënë, po ai ke pa me KFOR-in. Nuk po i iki.  
6 S'e kam pa dhe s'më kujtohet që e kam pa.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani e  
8 paraqes këtë video të dytë me numrin 104414-02 për pranim si  
9 provë materiale.

10 Z. BOWDEN: [Përkthim] Kemi qëndrimin e njëjtë që ngremë  
11 lidhur me këtë dokument.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Cadman.

13 Z. CADMAN: [Përkthim] I njëjti qëndrim që e kemi bërë të  
14 ditur edhe më parë, i nderuar Gjykatës.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,  
16 caktoni një numër.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është prova materiale  
18 me numër P164.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prova me  
20 numër P164 pranohet si provë materiale.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

22 Py. Edhe një grup pyetjesh lidhur me dërgesën e tretë. Gjatë  
23 pyetjeve që jua bëri avokati juaj, ju thatë në një prej  
24 përgjigjeve, se ishit 90 për qind të sigurt që e kishit pa  
25 Zdenka Pumperin jashtë Organizatës së Veteranëve të luftës atë



1 ditë. A ju kujtohet që e thatë këtë gjatë dëshmisë suaj?

2 Pë. Këtë deklaratë e kam thënë, po e kam përsëritë edhe këtu  
3 më duket. Mbasi ka ardhë ajo këtu dhe si siluetë, ka mujt edhe  
4 mos me kanë, po m'u ka duk që ka qenë kjo. Ndoshta dhe pej tuj  
5 mundu unë me hetu mos ka qenë kjo. Po ka qenë një femër,  
6 bionde, e madhe në xhinsa, me maskë, çantë në shpinë edhe  
7 bejzboll. A ka qenë Zdenka Pumper a s'ka qenë Zdenka Pumper,  
8 unë nuk e di e saktë. Por mu nga trupi korpouloz, ku ke këtu  
9 mu nga, mendimi jemi që e kam -- mbasi e kam pa tuj dëshmu  
10 këtu. Dhe zoti avokat mundet me e dëshmu se kur ja kam thënë.  
11 Py. Gruaja që patë më datë 22 shtator 2020, a patë një grua  
12 apo patë një siluetë personi?

13 Pë. Unë, nuk a kanë natë me pa silueta, as i pirë s'jam kanë.  
14 Kam pa femën dhe nuk e di a është grua a çikë. Femër  
15 korpuloze, e zhvillune. Ka qenë te dera. Ka mujt edhe mos me  
16 kanë hiç ajo. Po ku ju ka drejtu kamera e KFOR-it, kanë ik  
17 këta persona. Këta më kanë bo përshtypje. Ju kanë bo  
18 përshtypje edhe KFOR-it. Kanë kesh me zë të madh sa u ndiz  
19 zani poshtë tuj kesh.

20 Py. Në atë moment më 22 shtator 2020, nuk ishit njoftuar  
21 ndonjëherë apo nuk e kishit parë ndonjëherë zonjën Pumper?

22 Pë. Jo, jo, jo. Ky a një konkludim në mendjen teme mbasi e  
23 kam pa këtu tuj e studiu edhe tuj e mendu a ka mujt kjo me  
24 qenë. Ka ndodhë ai rast, nëse i kujtohet zotit avokat, kur ma  
25 ka tregu njëherë një video gjatë bastisjes që e kam përmend

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 114

1 një emër. Shumë interesant që mu ka nga si ajo se ishte me  
2 mask. Që pastaj u pa që është e pamundshme me kanë ai person.  
3 Më beso kam dyshu thashë mos a që ai. Femër që kish pas qenë  
4 me -- se unë edhe ku kam pa që ka udhëheq, që u ka tregu atë  
5 pjesën që u ka udhëheq bastisjen, nuk më ka ngja që ajo që e  
6 kam pa deri atë ditë këtu. Edhe këta nuk po e them me siguri,  
7 po them, më duket. Ndoshta dhe pej asajt tu e mendu veten mos  
8 ka qenë kjo. Po nuk jam i sigurtë 100 për qind. Më duket, e  
9 kam thënë edhe dje po e them edhe tash, më duket. Mund edhe të  
10 mos ketë qenë. Por mendja ma thotë që e njëjshme me si e  
11 madhe, njais me mu -- nuk po e potencoj 100 për qind. Me e  
12 ditsha 100 për qind, kisha thënë po 100 për qind.

13 Py. Kur ZPS-ja e mori paketën e tretë të materialeve atë  
14 ditë, zonja Pumper nuk ishte me punonjësit e ZPS-së të cilët  
15 erdhët aty, apo jo?

16 Pë. Unë zonjën Pumper edhe me ditë kush është për herë të  
17 parë e kam pa kur ka ardhë me dëshmu. Nuk për sa kam pa  
18 oficerët e jujt, asnjëherë zonja Pumper nuk ka qenë me  
19 dëshmitarin 1. Dëshmitari 1 ka ardhë në të tri rastet me të  
20 njëjtit njerëz dhe s'ka qenë askush tjetër.

21 Py. Zoti Haradinaj, kjo femër që ju patë mbante maskë aso  
22 kohe; apo jo?

23 Pë. Maskat i ka mbajjt gjithë popullata. Ka qenë kohë COVID-i.

24 Py. Dhe thoni se e identifikuat këtë femër si zonja Pumper  
25 mbasi dëshmoi këtu, por nuk e identifikuat personin si zonja

1 Pumper në përmbledhjen tuaj paraprake të datës 2 dhjetor 2021  
2 apo në përmbledhjen e plotë të datës 3 dhjetor 2021. A mos  
3 është ky një detaj të cilin që ju është kujtuar pas këtyre  
4 përmbledhjeve?

5 Pë. Të lutem, mendimin që kam unë dhe e them aty, ka mund  
6 edhe m'u ka dukur, është një konstatim që në mendjen time më  
7 erdh mbasi erdh këtu. Nuk është konstatim i sigurtë i jemi,  
8 është një supozim i jemi. Nuk kam pa dhe nuk e kam njoftë. Dhe  
9 s'kam ditë kurrë as qysh e ka emnin, as nuk e njoh. Me kanë që  
10 e njof e them e njoh dhe e kam pa edhe atë ditë. Kurrë s'e kam  
11 pa.

12 Py. Pra, në fakt, nuk keni asnjë shpjegim pse ajo nuk  
13 identifikohet si Zdenka Pumper në përmbledhjen paraprake apo  
14 në përmbledhjen e plotë të juajën; kështu?

15 Pë. Unë çfarë shpjegimi ka, ta sqarova. Edhe të sqarove prej  
16 nga po konkludoj. Po dhe konkludimi jem nuk po them që a i  
17 saktë 100 për qind. Një mendim që pastaj më ka ardhë në mendje  
18 këtu. Edhe këta unë me dashtë kisha thënë e kam njoftë ose  
19 është e saktë ose -- se me ditë ashtu them po. Nuk e di. Më  
20 koiçidon me atë femën te dera bionde. Më koiçidon. Zdenka  
21 Pumper ka mujt ndoshta atëherë mos me i pasë flokët bionde  
22 hiç. Unë thashë më koiçidon, më ngjason. Kurrëgjë tjetër. Nuk  
23 ka më për Zdenka Pumper send s'di më. S'e kam taku kurrë. Për  
24 herë të parë që e kam pa në mënyrë vizuale, që e di që është  
25 ajo, është ku është ul qetu.

1 Py. Një gjë të fundit të shkurtër lidhur me personat e tjerë  
2 që pat ditën e konferencës së tretë për shtyp. Sa medie  
3 thirrët që të vinin në konferencën e tretë për shtyp?

4 Pë. Mediat të gjitha janë thirrë çdo herë njësoj. Regjistri  
5 që është për media, e kam spjegju atë ditë, shkon automat ku e  
6 çojnë emailin. Me email e ka sekretaria, do të thotë, e ka  
7 sekretari. Kështu që për me u thirr, unë besoj që kanë shku të  
8 gjitha, për me ardhë ka ardhë kush ka dashtë.

9 Py. Dhe të gjithë u thirrën, të gjithë janë ftuar, pra, është  
10 e njëjta edhe për konferencën e parë dhe të dytë për shtyp apo  
11 jo?

12 Pë. Mënyra e thirrjes, forma e thirrjes për të gjitha ka qenë  
13 e njëjtë. Është një adresar, sa di unë, se s'e kam bo kurrë  
14 vet, po a kanë një grup adresash -- sekretari ai ka përvojë se  
15 është prej fillimit sekretar aty edhe ai a marrë me thirrjet,  
16 me shkrimet e atyne, me vulojsjet, me protokolimet. Kështu që  
17 e njëjta thirrje është. S'ka qenë thirrje as e veçantë. Nuk  
18 besoj që ka qenë as ma e [e pakuptueshme]. I njëjti adresar që  
19 e ka pasë automatikisht qysh kanë shku të gjitha. Dhe ne  
20 s'kemi bo më kurrfarë thirrje.

21 Py. Organizata e Veteranëve të Luftës a u ka bërë ndonjë  
22 vlerësim të kualifikimeve të gazetarëve që janë ftuar janë  
23 thirrur të marrin pjesë në konferencat për shtyp?

24 Pë. Kurrë. Asnjëherë. Asnjëherë. Edhe kur nuk jemi përgjigj  
25 me përgjigje negative. Ndërsa mediat, me siguri se i kanë

1 seleksionu kur na kanë pa të arsyeshme me i thirrë ata, sipas  
2 moderatorit që ai e ka pa.

3 Py. Në ndonjërin prej tre konferencave për shtyp, a ju ndalua  
4 ndonjërit prej gazetarëve që të merrte pjesë?

5 Pë. Kam kërku me ju ndalu një emër. Një gazetarë. Unë e kam  
6 kërku dhe i kam thënë nuk e lë hiç me hi mbrenda. Po nuk ish  
7 pat qenë atë ditë, ndërsa media e asaj KTV, që quhet  
8 televizioni KTV, ka qenë. Ata as nuk do ta kisha lënë mbrenda  
9 në asnjë mënyrë.

10 Py. Pse nuk do ta kishit lënë brenda?

11 Pë. Sepse ajo më ka fy publikisht. Dhe kur ka hi gazetar në  
12 atë televizion e ka qit publikisht, KTV televizion free nga  
13 Nasim Haradini. Kështu qe më ka denoncu publikisht. Ka thënë,  
14 a deklaru si gazetarë, që do të jetë free, do të thotë, s'do  
15 të shihet fytyra e Nasim Haradinit në KTV. Edhe pse ku jam  
16 anku te ta, unë i kam pasë s'di sa intervista dhe më ka thënë  
17 që "Kjo është veç një gazetarë budallicë që ka dasht me e bo  
18 veten diçka". Dhe aty ka shkru për tre persona. Unë po e  
19 përmendi personin tim, emrin tim, s'po du me spekulu për emra  
20 tjerë. Lype, e gjen ankesën e ka. Edhe s'do ta kisha lënë,  
21 sepse kam dashtë me ia realizu dëshirën e saj. Derisa ka thënë  
22 televizioni im, ajo ka mendu për të vetin që është, që  
23 s'është, ka qenë gazetarë. Të paktën ka marrë përgjyesi për  
24 veten që me qenë free, do të thotë, me qenë i lirë pa kanë  
25 unë. Kështu që kam dashtë me ia realizu një dëshirë të saj që

1 mos me kanë. Por jo medias, asaj si gazetare. Kështu që KTV  
2 atë ditë ka qenë. Me pa ardhë ajo, po ta garantoj qetu, e din  
3 edhe ajo mirë, edhe kurrë sot a gazetare ajo asaj unë  
4 intervistë nuk i jap. Se ka kërku vetë dhe du me ja plotësu  
5 dëshirën. Kjo është e vetmja. Dhe është që e mbaj mend me më  
6 ra puna prapë kësaj kurrë nuk i jap.

7 Edhe pse ma vonë, vëllai i saj a ardhë e më ka kërku  
8 falje. Ka thënë që e ka shumë gabim sepse më ka linçu shumë  
9 keq pa arsye, pa më taku kurrë, pa më pa kurrë. Edhe ka thënë  
10 vallaj, te vëllai vet tuj arsyetu, "veç mu tek me e shkru  
11 qashtu". Vëllai i vet më ka kërku fajle. Eme in e ki aty. E din  
12 edhe ajo, e din edhe vet televizioni se kush është personi.  
13 Qysh a kanë nismë e saj që unë kam dashtë edhe dëshirë e saj,  
14 vullnet i saj dhe unë kam dashtë veç me ja realizu. Edhe pse  
15 ka kërku falje, më ka kërku vëllai i vet, nuk është ardhë vet,  
16 nuk ja mundësoj më kurrë. Unë s'di tash a është ajo gazetare  
17 aty a s'është. Edhe të jem i sigurtë edhe shefi i  
18 televizionit më ka kërku falje dhe më ka thënë që është bë pa  
19 dijen tonë dhe e di që mbas tri dite, katër dite e ka shly atë  
20 postim. Por ka mjaftu. Kjo është arsyeja, zoti Prokuror, dhe a  
21 mirë qepo i ndin edhe ajo tash.

22 Py. Përmendët gjatë kësaj përgjigjes së fundit se çfarë do të  
23 bëni në të ardhmen. Dhe dua t'ju bëj disa pyetje lidhur me  
24 këtë, pra, jo për këtë gazetare që ju ka ofenduar, po më në  
25 përgjithësi.

1           Zoti Haradinaj, a ndieni ndonjë keqardhje, pendesë, për  
2 atë që çfarë keni bërë me dokumentet që janë dorëzuar  
3 Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së?  
4 Pë. Për atë të cilën unë e pranova, jo çka ti po pretendon,  
5 asnjë grimë nuk ndihna i pendum. Sepse e kam bo me vetëdijen  
6 time dhe thellë i bindur se është në dobi të transparencës dhe  
7 interesit publik. Dhe kështu që e kam kry vetëm një obligim,  
8 që unë kam mendu, që më është dashtë ta kryejmë. Asnjë send ma  
9 tepër. Dhe ajo është marrja prej atit, qitja deri aty, mbrenda  
10 të njëjtit lokal.

11           Për deri këtu asnjë send s'pendohem. Nuk pendohem as për  
12 ata që janë mundu me më konfizu, me më bo asi që ja kam thënë  
13 fjalët, i pranova dhe këto. Jo s'pendohem unë, sepse s'kam bo  
14 diçka. Për kjo e kam ditë që interes po të them edhe njëherë  
15 jam kanë thellë i bindun, jam kanë thellë i bindun që është në  
16 interesin publik dhe është për hir të transparencës publike,  
17 transparent dhe interes publik. Për këtë arsye e kom bo dhe  
18 kam mendu që edhe është detyrë, jo veç e jemja, po e çdo  
19 qytetari në një shtet demokratik dhe të pavarur.

20           Shprehja e mendimit të lirë, sepse edhe shprehjet që kam  
21 shpreh mendimet e mia si mendime të lira, mu nuk muj mi ndalon  
22 kërrkush dhe s'besoj që ndalohet shprehja e mendimit. Veprimin  
23 që e kam bo, që kam tregu pse kanë ardhë do dokumente, vetëm  
24 kam tregu se na kanë ardhë qeto dokumente jo më tutje, e  
25 pranoj dhe nuk pendohna.

1 Py. Nëse të njëjtat lloj -- i njëjti lloj dokumentesh do t'i  
2 dorëzoheshin prapë Organizatës së Veteranëve të Luftës dhe  
3 nëse do ta kishit ju në dorë për ta bërë një konferencë tjetër  
4 për shtyp, a do ta bënit?

5 Pë. Pse e keni prapë plan me na përcjellë?

6 Py. Ju lutem, përqendrohuni tek pyetja ime.

7 Pë. Përqëndrojna jam. Se ti e ka bon pyetje spekulative nëse  
8 ndodhë diçka. Unë së pari nuk e di a jam gjallë edhe dy  
9 minuta. Kështu që unë nuk muj jep përgjigje se çka ka me  
10 ndodhë. Prandaj nëse ti po i dike, shpjegomë a kanë me ardhë?

11 Z. HALLING: [Përkthim] Pse të mos shohim tani një video.  
12 Është materiali P35, me vulë kohore 24:44 deri në 24:56. Kjo  
13 pjesë e konferencës për shtyp është publike gjendet me numrin  
14 P35-ETRED në faqen 13. Me numrin ERN 08213601. Pjesa fillon me  
15 fjalët "Po të punoja unë në media" dhe mbaron me "Nga gjithë  
16 kryesia".

17 [Luhet videoincizimi]

18 I AKUZUARI HARADINAJ: Shumë saktë, zoti Prokuror. Sepse  
19 këtu më thotë ai "Pse unë s'po guxoj" Se më thotë "Qitni ju".  
20 Thashë "Jo, unë s'po i qes". Tha "na s'po guxojm". Thashë  
21 "Shtjeni më [e pakuptueshme]". Ky është perceptimi jem po të  
22 isha gazetar. Unë nuk e di tash po të isha gazetar a do të  
23 kisha mendu ndryshe që mendoj që tash që s'jam gazetar. Kështu  
24 që mu më lejohet mendimi tash edhe me boksi me dikënd. Mendoj  
25 që munda me një boksier profesionalist. Mendimi. Kështu që unë



1 mendoj po të isha gazetar, ideja jeme a kone, që ata duhet me  
2 guxu ose a çështje e tij prandaj unë nuk e di tash. Unë hala  
3 s'jam bo gazetar për me ditë. Nuk e di. Perceptimi jem i  
4 gazetarit është një nivel ma i lartë në kuptimin e  
5 seleksionimit të këtij materiali ma profesionalist.

6 Prandaj e kam thanë. Se ai më thotë "Qiti ti. Pse s'po  
7 guxon ti? Pse po tutesh". Është provokim i gazetarit nëse e  
8 dëgjon ma herët është qështu. Dhe normal, në këtë stres kështu  
9 i them. Po dhe tash po them. Ndoshta po të isha gazetar e bëj.  
10 Kisha guxu.

11 Veç po të tregoj diçka, zoti Prokuror, ti me i ditë edhe  
12 të gjithë. Nëse diçka mua ma merr mendje që a qashtu,  
13 përderisa nuk krijohet bindje tjetër dhe bindjet zakonisht nuk  
14 pranoj me mu imponu, prandaj mo më thoni me u bind. Unë kam  
15 guxim gjithmonë për bindjet e mia me i shpreh çfarëdo qofshin  
16 ato, qofshin edhe të gabune, po me mendimin tem janë të  
17 drejta. Dhe nëse më bind dikush që janë të gabune unë di me  
18 kërkua falje dhe di me marrë edhe përgjesi.

19 Py. Pra, do ta kishit bërë atë që bëtë, do ta kishit bërë  
20 prapë po t'ju vinin edhe të tjera dokumente; a nuk është  
21 kështu?

22 Pë. Zoti Prokuror, do me më shti me kërkua prej gjyqit mos me  
23 më qit kurrë prej burgit deri në kryet Gjykata se e paske plan  
24 me na pru apet. Unë s'muj jam fajtor kujdestar sikur në Serbi  
25 çka ndodhë në Kosovë mu marr une.

1 Py. Dua vetëm të përgjigjeni --

2 Pë. Unë nuk di çka ka me u bë dhe dy minuta. Ti po e din që  
3 kanë me ardhë. E ke plan me na i pru?

4 Py. Zoti Haradinaj, nuk ju përgjigjët pyetjes sime. Do ta bëj  
5 edhe njëherë.

6 Pë. Hiç mos e bëni.

7 Py. Pra, do ta --

8 Pë. Hiç mos e bëni, unë po të përgjigjna. Po qe se i bien, të  
9 njëjtë do të veproj se hala kam mendimin e njëjtë. Për q'aq sa  
10 kam vepru që kam bo drejtë dhe kam bo në interes të  
11 transparencës dhe informimit publik. Hiç mos e bë. Përderisa  
12 mendoj kështu, vetëm kaq hiç ma shumë as ma pak sepse bindja  
13 jeme që është dashtë. Ndoshta, nëse më pyet për këtë material,  
14 ky material për mu s'ka dhe vleftë më. Dhe s'di sa a mot se  
15 tash nuk e di gjendjen sesa asht interes publik kjo më. Se  
16 edhe atëherë, thjesht, po jua them edhe Trupit Gjykues edhe  
17 ju, as atëherë nuk u duk që kaq që kaq tragjike ose do e  
18 mësheftë sa ju po e mundoni me trasmetu këtu, ku po them të  
19 gjitha këto janë ditë dy, tri, katër e deri pesë vjet më  
20 përpara.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po zoti  
22 Cadman.

23 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk doja të ngrihesha, por unë kam  
24 kundërshtim për këto lloj pyetjesh. Janë tejet spekulative.  
25 Janë të padrejta për zotin Haradinaj. Ai nuk mund të prite

1 prej tij që t'i përgjigjet pyetjeve të tilla.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet  
3 kundërshtimi. Këto janë kundërpjetjet.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi më pyetje të tjera, i  
5 nderuar Gjykatës.

6 I AKUZUARI HARADINAJ: Zoti Prokuror, ju falënderoj. Mi  
7 sqarut disa bindje të mia taman u bo të jen ma të qarta. Ju  
8 falënderoj për punën, për të gjitha.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mos lëvizni.  
10 Ka pyetje plotësuese?

11 Z. CADMAN: [Përkthim] Po. Po dua që t'i bëjmë nesër  
12 paradite është ora katër pa tetë minuta.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa kohë do ju  
14 duhet?

15 Z. CADMAN: [Përkthim] 15, 20 minuta maksimumi.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju zoti  
17 Bowden, do keni pyetje tjera?

18 Z. BOWDEN: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Unë kaq kam. Unë nuk e di nëse  
20 Trupi Gjykses do të ketë pyetje të tjera por mund edhe ta --  
21 ne kaq kishim. Nuk e di nëse mund ta zgjasni.

22 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo, unë kërkoj që ta bëj këtë nesër  
23 në mëngjes.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
25 Do ta bëjmë nesër në mëngjes. Do ta vazhdojmë në mëngjes.

1           Zoti Haradinaj, do të rishihemi po në të njëjtin vend  
2 nesër në mëngjes.

3           Do ta ndërpresim seancën këtu. Do të rifillojmë nesër në  
4 orën 9.30 minuta, si zakonisht.

5           Ju lutem, i thoni zotit Çelaj që të jetë i gatshëm të  
6 dëshmojë nesër.

7           Z. CADMAN: [Përkthim] Një sqarim para se ta mbyllim. Mesa  
8 kuptova unë nuk na është kërkuar që ta ndryshojmë deklaratën,  
9 po t'i vendosim një shtojcë dhe t'i dorëzojmë të dyja.

10          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, kjo  
11 ishte. Po. Po e thashë pa mikrofonin. Nuk e kisha ndezur.

12          Falënderoj përkthyesit, teknikët audiovizivë, stenografët  
13 dhe të gjithë të tjerët. Shihemi nesër.

14                               --- Seanca përfundon në orën 15:53

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25